



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
USTAVNI SUD
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 31 korrik 2024
Nr. ref.: AGJ 2508/24

AKTGJYKIM

në

rastin nr. KO158/23

parashtrues

Besnik Tahiri dhe nëntë (9) deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës

Vlerësim i kushtetutshmërisë Ligjit nr. 08/L-142 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjeve që Përcaktojnë Shumën e Beneficionit në Lartësi të Pagës Minimale dhe Shkallët Tatimore në të ardhurat Personale Vjetore

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar
Enver Peci, gjyqtar, dhe
Jeton Bytyqi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

- Kërkesa është dorëzuar nga dhjetë (10) deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kuvendi), përkatësisht: Besnik Tahiri, Ramush Haradinaj, Pal Lekaj, Albana Bytyçi, Shemsedin Dreshaj, Time Kadrijaj, Bekë Berisha, Fatmir Humolli, Albena Reshitaj dhe Haki Abazi (në tekstin e mëtejme: parashtruesit e kërkesës), të cilët i përfaqëson Besnik Tahiri.

Ligji i kontestuar

2. Parashtruesit e kërkesës e kontestojnë kushtetutshmërinë e Ligjit nr. 08/L-142 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjeve që Përcaktojnë Shumën e Beneficionit në Lartësi të Pagës Minimale dhe Shkallët Tatimore në të Ardhurat Personale Vjetore, dispozitat e të cilit ndryshojnë dhe e plotësojnë (i) Ligjin nr. 04/L-261 për Veteranët e Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 05/L-141; (ii) Ligjin nr. 04/L-092 për Personat e Verbër; (iii) Ligjin nr. 05/L-067 për Statusin dhe të Drejtat e Personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik; dhe (iii) Ligjin nr. 03/L-212 e Punës (në tekstin e mëtejme: Ligji i kontestuar) miratuar me Vendimin [nr. 08-V-589] e 13 korrikut 2023 të Kuvendit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kuvendi).

Objekti i çështjes

3. Objekti i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Ligjit të kontestuar, me pretendimin se dispozita të caktuara të tij nuk janë në përputhshmëri (i) me “*barazinë para ligjit*” të garantuar me nenin 24 [Barazia para Ligjit]; (ii) “*të drejtën në pronë*”, përkatësisht “*pritshtëritë legjitime*” të garantuar me nenin 46 [Mbrojtja e Pronës]; dhe (iii) “*barazinë sociale dhe mbrojtjen sociale*” të garantuar me nenet 7 [Vlerat] dhe 51 [Mbrojtja Shëndetësore dhe Sociale] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), në ndërlidhje me nenin 14 [Ndalimi i diskriminimit] dhe nenin 1 (Ndalimi i përgjithshëm i diskriminimit) të Protokollit nr. 12, si dhe nenin 1 (Mbrojtja e pronës) të Protokollit nr. 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).
4. Parashtruesit e kërkesës në mënyrë specifike kontestojnë kushtetutshmërinë e dispozitave të Ligjit të kontestuar, si në vijim: (i) nenin 2 (Ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit nr. 04/L-261 për Veteranët e Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 05/L-141), me të cilin ndryshohet paragrafi 3.1 i paragrafit 3 të nenit 16A të Ligjit nr. 04/L-261 për Veteranët e Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 05/L-141; (ii) nenin 3 (Ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit nr. 04/L - 092 për Personat e Verbër) me të cilin ndryshohet paragrafi 2 i nenit 7 të Ligjit nr. 04/L - 092 për Personat e Verbër; (iii) nenin 4 (Ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit nr. 05/L - 067 për Statusin dhe të Drejtat e Personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik), me të cilin ndryshohet paragrafi 1 i nenit 7 të Ligjit nr. 05/L -067 për Statusin dhe të Drejtat e Personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik; dhe (iv) nenin 6 (Ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës), me të cilin ndryshohet paragrafi 1 i nenit 57 (Paga Minimale) i Ligjit nr. 03/L-212 të Punës.

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafin 5 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] dhe paragrafin 2 të nenit 116 [Efekti i Vendimeve] të Kushtetutës, në nenet 22 (Procedimi i kërkesës), 27 (Masat e përkohshme), 42 (Saktësimi i kërkesës) dhe 43 (Afatet) të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji), dhe rregullat 25 (Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve) dhe 72 (Kërkesa në pajtim me nenin 113.5 të Kushtetutës dhe neneve 42 dhe 43 të Ligjit) të Rregullores së punës së Gjykatës, nr. 01/2023 (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 21 korrik 2023, parashtruesit e kërkesës e dorëzuan kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).

7. Më 26 korrik 2023, Kryetarja e Gjykatës, me Vendimin [GJR. KO158/23], caktoi gjyqtaren Remzije Istrefi-Peci gjyqtare raportuese dhe me Vendimin [KSH. KO158/23] caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Safet Hoxha (kryesues), Nexhmi Rexhepi dhe Enver Peci (anëtarë).
8. Më 21 korrik 2023, Gjykata njoftoi parashtruesit e kërkesës për regjistrimin e kërkesës.
9. Më 21 korrik 2023, Gjykata për regjistrimin e kërkesës e njoftoi: (i) Presidenten e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Presidentja); (ii) Kryetarin e Kuvendit, të cilit iu kërkua që t'i njoftojë deputetët se mund të dorëzojnë komentet e tyre në lidhje me kërkesat e parashtruesve të kërkesave, jo më vonë se 4 gushti 2023; si dhe (iii) Sekretarin e Përgjithshëm të Kuvendit, me sqarimin që bazuar në paragrafin 2 të nenit 43 të Ligjit, *“në rast kur ligji apo vendimi i miratuar nga ana e Kuvendit të Republikës së Kosovës kontestohet sipas nenit 113, paragrafi 5 i Kushtetutës, ligji apo vendimi i tillë mund t'i dërgohet Presidentit të Republikës së Kosovës për shpallje në pajtim me modalitetet e përcaktuara në vendimin final të Gjykatës Kushtetuese për rastin e kontestuar”*. Gjykata, bazuar në dispozitën e lartcekur të Ligjit dhe praktikën e saj gjyqësore, rikujtoi se kjo dispozitë nënkupton që Ligji i kontestuar nuk mund të dekretohet, të hyjë në fuqi, ose të prodhojë efekte ligjore deri në vendimin final të Gjykatës lidhur me çështjen e ngritur pranë saj.
10. Në po të njëjtën ditë, Gjykata për regjistrimin e kërkesës njoftoi: (i) Kryeministrin e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Kryeministri); (ii) Institucionin e Avokatit të Popullit (në tekstin e mëtejshëm: Avokati i Popullit); dhe (iii) Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve (në tekstin e mëtejshëm: Ministria e Financave), duke i informuar se mund t'i paraqesin në Gjykatë komentet e tyre lidhur me kërkesën e parashtruar, nëse kanë, jo më vonë se me 4 gusht 2023.
11. Më 28 korrik 2023, Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit dorëzoi në Gjykatë dokumentet si në vijim:
 1. Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që përcaktojnë shumën e beneficionit në lartësi të pagës minimale, procedurat e caktimit të pagës minimale dhe shkallët tatimore në të ardhurat personale vjetore, i 15 prillit 2022;
 2. Raportin e Komisionit funksional për Buxhet, Punë dhe Transfere për shqyrtimin në parim të Projektligjit nr. 08/L-142 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që përcaktojnë shumën e beneficionit në lartësi të pagës minimale, procedurat e caktimit të pagës minimale dhe shkallët tatimore në të ardhurat personale vjetore, i 27 prillit 2022;
 3. Vendimin [nr. 08-V-297] e Kuvendit për miratimin në parim të Projektligjit nr. 08/L-142 dhe plotësimin e ligjeve që përcaktojnë shumën e beneficionit në lartësi të pagës minimale, procedurat e caktimit të pagës minimale dhe shkallët tatimore në të ardhurat personale vjetore, i 14 qershorit 2022;
 4. Procesverbalin e Seancës plenare të Kuvendit, i 5 majit 2022;
 5. Pjesë nga transkripti i Seancës Plenare, shqyrtimi i parë i Projektligjit nr.08/L-142 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që përcaktojnë shumën e beneficionit në lartësi të pagës minimale, procedurat e caktimit të pagës minimale dhe shkallët tatimore në të ardhurat personale vjetore, i 5 majit, 13 dhe 14 qershorit 2022;
 6. Raportin me amendamente të Komisionit funksional për Buxhet, Punë dhe Transfere, për shqyrtimin e dytë të Projektligjit nr. 08/L-142 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që përcaktojnë shumën e beneficionit në lartësi të pagës minimale, procedurat e caktimit të pagës minimale dhe shkallët tatimore

- në të ardhurat personale vjetore, dërguar komisioneve të përhershme, i 7 qershorit 2023;
7. Procesverbalin e mbledhjes së Komisionit funksional për Buxhet, Punë dhe Transfere, i 24 majit 2023;
 8. Raportin me rekomandim i Komisionit për Legjislacion, mandate, Imunitete, rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit për Projektligjin nr. 08/L-142 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që përcaktojnë shumën e beneficionit në lartësi të pagës minimale, procedurat e caktimit të pagës minimale dhe shkallët tatimore në të ardhurat personale vjetore dhe amendamenteve në këtë projektligj, i 7 qershorit 2023;
 9. Procesverbalin embledhjes së Komisionit për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit, i 7 qershorit 2023;
 10. Raportin me rekomandim i Komisionit për Integrim Evropian për Projektligjin nr. 08/L-142 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që përcaktojnë shumën e beneficionit në lartësi të pagës minimale, procedurat e caktimit të pagës minimale dhe shkallët tatimore në të ardhurat personale vjetore dhe amendamenteve në këtë Projektligj, i 14 qershorit 2023;
 11. Procesverbalin e mbledhjes së Komisionit për Integrim Evropian, datë 14 qershor 2023;
 12. Raportin e Komisionit funksional për Buxhet, Punë dhe Transfere, për shqyrtimin e dytë të Projektligjit nr. 08/L-142 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që përcaktojnë shumën e beneficionit në lartësi të pagës minimale, procedurat e caktimit të pagës minimale dhe shkallët tatimore në të ardhurat personale vjetore, të bashkëngjitura edhe raportet e komisioneve të përhershme, i 22 qershorit 2023;
 13. Vendimin [nr. 08-V-589] e Kuvendit për miratimin e Ligjit nr. 08/L-142 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që përcaktojnë shumën e beneficionit në lartësi të pagës minimale, procedurat e caktimit të pagës minimale dhe shkallët tatimore në të ardhurat personale vjetore, i 13 korrikut 2023.
12. Më 4 gusht 2023, Gjykata pranoi komentet lidhur me kërkesën nga (i) Avokati i Popullit; (ii) Qeveria e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Qeveria), përkatësisht në emër të Ministrisë së Financave nëpërmjet Kryeministrit; dhe (iii) Grupi parlamentar i Lëvizjes VETËVENDOSJE!, nëpërmjet znj. Mimoza Kusari-Lila, Kryetare e Grupit parlamentar të Lëvizjes VETËVENDOSJE!, lidhur me kërkesën.
 13. Më 10 gusht 2023, Gjykata për pranimin e komenteve me lartë njoftoi: (i) parashtruesit e kërkesës; (ii) Presidentin; (iii) Kryetarin e Kuvendit; (iv) Kryeministrin; (v) Avokatin e Popullit; (vi) Ministrinë e Financave, të cilët u njoftuan për mundësinë e dorëzimit të komenteve shtesë, jo më vonë se më 25 gusht 2023, në lidhje me komentet e pranuar nga palët e interesuara.
 14. Më 15 gusht 2023, Gjykata pranoi një kërkesë nga Kryetari i Kuvendit për zgjatje të afatit për dorëzimin e komenteve shtesë.
 15. Më 22 gusht 2023, Gjykata e miratoi kërkesën e Kryetarit të Kuvendit për zgjatje të afatit, përkatësisht deri më 26 shtator 2023. Megjithatë, Kryetari i Kuvendit nuk dorëzoi komente shtesë.
 16. Më 19 qershor 2024, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarës raportuese dhe njëzëri, i rekomandoi Gjykatës pranueshmërinë e kërkesës. Në të njëjtën ditë, Gjykata vendosi njëzëri : (i) që të konstatojë që neni 2 (Ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit Nr. 04/L-261 për Veteranët e Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 05/L-141) i Ligjit të kontestuar, nuk është në kundërshtim me

nenin 24 [Barazia para Ligjit] dhe nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës në lidhje me nenin 1 (Mbrojtja e pronës) të Protokollit nr. 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; (ii) me tetë (8) vota për dhe një (1) kundër, që neni 3 (Ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit nr. 04/L-092 për Personat e Verbër) i Ligjit të kontestuar, nuk është në kundërshtim me nenin 24 [Barazia para Ligjit] dhe nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës në lidhje me nenin 1 (Mbrojtja e pronës) të Protokollit nr. 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; (iii) njëzëri, që neni 4 (Ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit nr. 05/L-067 për Statusin dhe të Drejtat e Personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik) i Ligjit të kontestuar, nuk është në kundërshtim me nenin 24 [Barazia para Ligjit] dhe nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës në lidhje me nenin 1 (Mbrojtja e pronës) të Protokollit nr. 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; (iv) me tetë (8) vota për dhe një (1) kundër, që të konstatojë që neni 6 (Ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit nr. 03/L-212 të Punës) i Ligjit të kontestuar, nuk është në kundërshtim me nenin 51 [Mbrojtja Shëndetësore dhe Sociale] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Përmbledhja e fakteve

17. Më 13 prill 2022, Qeveria përmes Vendimit [Nr. 04/69] miratoi Projektligjin nr. 08/L-142 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që përcaktojnë shumën e beneficionit në lartësi të pagës minimale, procedurat e caktimit të pagës minimale dhe shkallët tatimore në të ardhurat personale vjetore.
18. Më 14 prill 2022, Qeveria e procedoi Projektligjin nr. 08/L-142 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që përcaktojnë shumën e beneficionit në lartësi të pagës minimale, procedurat e caktimit të pagës minimale dhe shkallët tatimore në të ardhurat personale vjetore, për shqyrtim dhe miratim në Kuvend.
19. Më 26 prill 2022, Komisioni FunkSIONAL për Buxhet, Punë dhe Transfere (në tekstin e mëtejshëm: Komisioni FunkSIONAL për Buxhet), i rekomandoi Kuvendit miratimin, në parim, të Projektligjit nr. 08/L-142 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që përcaktojnë shumën e beneficionit në lartësi të pagës minimale, procedurat e caktimit të pagës minimale dhe shkallët tatimore në të ardhurat personale vjetore.
20. Më 14 qershor 2022, Kuvendi përmes Vendimit [Nr. 08-V-297], me gjashtëdhjetë e tetë (68) vota “për” dhe gjashtë (6) “abstenime”, miratoi në parim Projektligjin nr. 08/L-142 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që përcaktojnë shumën e beneficionit në lartësi të pagës minimale, procedurat e caktimit të pagës minimale dhe shkallët tatimore në të ardhurat personale vjetore.
21. Më 7 qershor 2023, Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit (në tekstin e mëtejshëm: Komisioni për Legjislacion), rekomandoi që projektligji i kontestuar është në përputhshmëri me Kushtetutën dhe ligjin e zbatueshëm, dhe që i njëjti mund t'i procedohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.
22. Më 14 qershor 2023, Komisioni për Integrim Evropian, me shumicë votash, nxori përfundimin se: *“Projektligji nr. 08/L-142 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që përcaktojnë shumën e beneficionit në lartësi të pagës minimale, procedurat e caktimit të pagës minimale dhe shkallët tatimore në të ardhurat personale vjetore, nuk rregullohet në mënyrë specifike me legjislacion të BE-së”*.
23. Më 21 qershor 2023, Komisioni FunkSIONAL për Buxhet, i rekomandoi Kuvendit miratimin e Projektligjit nr. 08/L-142 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që përcaktojnë shumën e beneficionit në lartësi të pagës minimale, procedurat e caktimit

të pagës minimale dhe shkallët tatimore në të ardhurat personale vjetore, dhe të njëjtit i dorëzoi edhe katër (4) propozim-amendamente.

24. Më 13 korrik 2023, Kuvendi përmes Vendimit [nr. 08-V-589], me gjashtëdhjetë (60) vota “për” dhe një (1) “abstenim”, miratoi Ligjin e kontestuar, pa amendamentet e propozuara.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

25. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se Ligji i kontestuar në tërësinë e tij nuk është në përputhshmëri me nenet: 7 [Vlerat], 24 [Barazia para Ligjit], 46 [Mbrojtja e Pronës], 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] dhe nenin 51 [Mbrojtja Shëndetësore dhe Sociale] të Kushtetutës. Specifikisht, parashtruesit e kërkesës pretendojnë se nenet 2, 3, 4 dhe 6 të Ligjit të kontestuar nuk janë në përputhshmëri me (i) “barazinë para ligjit dhe mosdiskriminimin” të garantuar me nenin 24 [Barazia para Ligjit]; (ii) “të drejtën në pronë” të garantuar me nenin 46 [Mbrojtja e Pronës]; dhe (iii) “barazinë sociale dhe mbrojtjen sociale” të garantuar me nenin 7 [Vlerat] dhe nenin 51 [Mbrojtja Shëndetësore dhe Sociale] të Kushtetutës, pretendime këto të cilat, do të paraqiten në vijim.

(i) lidhur me “barazinë para ligjit dhe mosdiskriminimin”

26. Fillimisht, parashtruesit e kërkesës, duke iu referuar Ligjit nr. 04/L-261 Për Veteranët e Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 05/L-141, theksojnë: “*Veteranët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës marrin vetëm pensionin e veteranit, i cili nuk mund të jetë nën pagën minimale. Ky pension, sipas Ligjit, nuk merret në rastet kur i njëjti person përfiton nga ndonjë skemë tjetër sociale e as kur i njëjti është në ndonjë marrëdhënie pune. Si rrjedhojë, pensioni në fjalë, në secilin rast, është burim i vetëm i të ardhurave të veteranëve*”.
27. Parashtruesit e kërkesës specifikisht i referohen përmbajtjes së nenit 18 (Lartësia e shumëve të pensioneve) të Ligjit nr. 04/L-261 për Veteranët e Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 05/L-141, duke theksuar: “*Varësisht nga mundësitë buxhetore, kostoja e jetesës dhe inflacioni eventual, në fund të çdo viti për vitin e ardhshëm, Qeveria e Kosovës, me propozimin e Ministrisë së Financave me vendim të veçantë, mund të vendosë për lartësinë e shumëve të pensionit të Veteranit Luftëtar të UÇK-së, e cila nuk mund të jetë më e vogël se paga minimale e përcaktuar në Kosovë*”. Në ndërlidhje me këtë, parashtruesit e kërkesës theksojnë se “*Ligji në fjalë është ndryshuar me Ligjin Nr. 05/L-141. Ky ligj ka përcaktuar pensionin mujor sipas kategorive. Neni 16 A i Ligjit Nr. 05/L-141 ka përcaktuar se “3. Skema e përcaktuar në paragrafin 2 të këtij neni, zbatohet pas kategorizimit përfundimtar. 3.1. Deri në kategorizimin përfundimtar të listës së Veteranit Luftëtar të UÇK-së, skema pensionale zbatohet siç është paraparë me ligjin bazik*”. Kategorizimi në fjalë nuk ka përfunduar ende”.
28. Parashtruesit e kërkesës theksojnë se pensioni i veteranëve të UÇK-së është burim i vetëm i të ardhurave të tyre. Prandaj, sipas tyre, referimi që i bëhet pagës minimale për lartësinë e pensioneve të tyre është racional. Parashtruesit e kërkesës i referohen Raportit të Komitetit të Ekspertëve për Aplikimin e Konventës dhe Rekomandimeve të Organizatës Ndërkombëtare të Punës, e cila e ka definuar pagën minimale si “*shuma minimale që i paguhet një punëtori për punën e kryer ose shërbimet e kryera, brenda një periudhe të caktuar, qoftë e llogaritur në bazë të kohës ose prodhimit, e cila nuk mund të reduktohet as nga individit ose marrëveshja kolektive, e cila garantohet me ligj dhe që mund të fiksohet në mënyrë të tillë që të mbulojë nevojat minimale të punëtorit dhe familjes së tij, në dritën e kushteve kombëtare, ekonomike dhe sociale*”.

29. Parashtruesit e kërkesës theksojnë se “*situatë e njëjtë është edhe sa i përket personave të verbër [shih nenin 7.2. të Ligjit I Nr. 04/L - 092 për Personat e Verbër] dhe personat paraplegjik dhe tetraplegjik [shih neni 7.1. i Ligjit Nr. 05/L -067 për Statusin dhe të Drejtat e Personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik]. Edhe në këto raste, konsiderohet se lartësia e pensionit duhet të përmbushë nevojat minimale për jetesë. Se cila është lartësia e shumës që i përgjigjet nevojave elementare, kjo përcaktohet me pagën minimale, sipas procedurave të përcaktuara me ligj”.*
30. Sipas parashtruesve të kërkesës, Ligji i kontestuar, i trajton pensionet e grupeve të lartcekura të ndara nga paga minimale pasi që nenet 2, 3, 4 dhe 7 [Sqarim: parashtruesit i referohen nenit 7, por pretendimet i referohen përcaktimeve të nenit 6 të Ligjit të kontestuar], e shuajnë referencën në pagën minimale. Specifikisht parashtruesit, theksojnë se “*Ligji i kontestuar më nuk jep garancë për veteranët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, personat e verbër dhe personat paraplegjik dhe tetraplegjik, se pensionet e tyre do të jenë sa paga minimale, përkatësisht sa shuma të cilën Qeveria e vlerëson si minimale për mbulimin e shpenzimeve minimale për jetesë. Përkundër faktit se pensioni në fjalë, është burim i vetëm i të hyrave të këtyre kategorive”.*
31. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se Ligji i kontestuar: (i) i jep të drejtë Qeverisë t'i caktojë pensionet e këtyre grupeve në lartësi të ndryshme, dhe jo në mënyrë të barabartë për të gjithë; (ii) bën dallimin e kategorive, në rrethana të njëjta; dhe se (iii) ekziston mundësia që lartësia e shumës së pensionit të njëjës kategori të jetë më e lartë sesa lartësia e shumës së pensionit të njëjës kategorije tjetër, e cila mund të përbëjë diskriminim.
32. Sipas parashtruesve të kërkesës, Ligji i kontestuar e bën dallimin e kategorive të ndryshme, që nuk ka ekzistuar më parë dhe se Qeveria tashmë do të ketë mundësi që të vlerësojë dhe përcaktojë lartësinë e shumës e cila është e domosdoshme për plotësimin e nevojave minimale për jetesë, por se jo domosdoshmërisht do ta caktojë këtë lartësi të shumës për kategoritë e tjera. Sipas parashtruesve të kërkesës këto kategori janë në situata relativisht të ngjashme, ndërsa Ligji i kontestuar lejon trajtimin ndryshe të tyre.
33. Parashtruesit e kërkesës tutje pretendojnë se Ligji i kontestuar përmbushë të gjitha kriteret për t'u konsideruar si diskriminues, sipas parimeve të përcaktuara nga praktika gjyqësore e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: GJEDNJ-së) dhe e Gjykatës. Në këtë kontekst, parashtruesit e kërkesës i referohen rasteve të Gjykatës (i) [KO01/17](#), me parashtrues *Aida Dërguti dhe 23 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës*, Aktgjykim i 28 marsit 2017, paragrafi 74; (ii) [KO157/18](#), me parashtrues *Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës*, Aktgjykim i 13 marsit 2019; dhe (iii) [KO93/21](#), me parashtrues *Blerta Deliu-Kodra dhe 12 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës*, Aktgjykim i 28 dhjetorit 2021, paragrafi 298), si dhe rasteve të GJEDNJ-së (i) [Sejdić dhe Finci kundër Bosnje-Hercegovinës](#), nr. 27996/06 dhe 34836/06, Aktgjykim i 22 dhjetorit 2009; (ii) [Konstantin Markin kundër Rusisë](#), nr.30078/06, Aktgjykim i 22 marsit 2012; (iii) [Mamatas dhe të tjerët kundër Greqisë](#), nr. 63066/14, 64297/14, 66106/14, Aktgjykim i 21 korrikut 2016; dhe (iv) [Napotnik kundër Rumanisë](#), nr. 33139/13, Aktgjykim i 20 janarit 2021.
34. Përfundimisht, parashtruesit e kërkesës pretendojnë se (i) Ligji i kontestuar i jep mundësinë Qeverisë që të bëjë “*dallime ndërmjet kategorive të ndryshme*”; (ii) se nuk ndjek një “*qëllim legjitim*” që do e justifikonte një dallim të tillë; dhe se (iii) i njëjti nuk është “*proporcional me qëllimin e ndjekur*”. Sipas parashtruesve “*për të gjitha këto arsye, Ligji i kontestuar është në kundërshtim me nenin 24 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës*”.

(ii) lidhur me “*të drejtën në pronë*”

35. Parashtruesit e kërkesës në lidhje me këtë pretendim, theksojnë se veteranët e UÇK-së, personat e verbër dhe personat paraplegjik dhe tetraplegjik kanë pasur “*pritshmëri legjitime*” që pensioni i tyre do të jetë në nivel të pagës minimale, dhe se Ligji i kontestuar i vë në “*pasiguri juridike*” këto kategori shoqërore, për shkak se Qeveria mund të caktojë lartësi tjetër të pensionit, duke mos marrë si referencë pagën minimale, e cila konsiderohet si shuma e domosdoshme për mbulimin e shpenzimeve jetësore. Një gjë e tillë sipas parashtruesve të kërkesës paraqet “*shkelje të drejtës në pronë,*” e cila garantohej me Kushtetutë dhe KEDNJ.
36. Parashtruesit e kërkesës, tutje theksojnë se “*pritshmëritë legjitime*” përbëjnë pronë, e cila si e tillë gëzon mbrojtje në kuadër të nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së. Në këtë drejtim, parashtruesit e kërkesës theksojnë se “*në rastin konkret, “pritshmëria legjitime” nuk është një shpresë e thjeshtë, por është e bazuar në ligjet në fuqi*”. Në këtë kontekst, të njëjtit i referohen rasteve të GJEDNJ-së: (i) [*Pressos Compania Naviera S.A dhe të tjerët kundër Belgjikës*](#), nr. 17849/91, Aktgjykim i 20 nëntorit 1995; (ii) [*Kopecky kundër Sllovakisë*](#), nr. 44912/98, Aktgjykim i 28 shtatorit 2004; (iii) [*Centro Europa 7 S.R.L dhe Di Stefano kundër Italisë*](#), nr. 38433/09, Aktgjykim i 7 qershorit 2012; (iv) [*Saghinadze kundër Gjeorgjisë*](#), nr. 18768/05, Aktgjykim i 1 qershorit 2015; (v) [*Ceni kundër Italisë*](#), nr. 25376/06, Aktgjykim i 4 shkurtit 2014; dhe (vi) [*Belane Nagy kundër Hungarisë*](#), nr. 53080/13, Aktgjykim i 13 dhjetorit 2016.
37. Specifikisht, parashtruesit e kërkesës theksojnë se “*veteranët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, personat e verbër dhe personat paraplegjik dhe tetraplegjik kanë pasur pritje legjitime, të bazuara nga ligjet në fuqi, se pensionet e tyre do të jenë të mjaftueshme për të mbuluar shpenzimet e tyre minimale për jetesë, lartësia e të cilës shumë caktohet vit pas viti nga Qeveria, varësisht rrethanave ekonomike. Diskrecioni i Qeverisë që për këto kategori të caktojë lartësinë e pensioneve nën pagën minimale, derisa kategoritë në fjalë nuk kanë të hyra të tjera, cenon seriozisht pritjet e tyre legjitime*”.
38. Përfundimisht, përkitazi me pretendimin e lartcekur, parashtruesit e kërkesës theksojnë se Ligji i kontestuar i jep diskrecion Qeverisë në përcaktimin e lartësisë së pensionit të tyre, e cila mund të jetë më e vogël se paga minimale, dhe rrjedhimisht sipas tyre kjo përbën shkelje të “*pritshmërive legjitime*”, përkatësisht shkelje të nenit 46 [Mbrojtja e pronës] të Kushtetutës.
- (ii) lidhur me “*barazinë sociale dhe mbrojtjen sociale*”
39. Parashtruesit e kërkesës theksojnë se Ligji i Punës, në nenin 57 (Paga minimale) të tij, përcakton që: “*Qeveria në fund të çdo viti kalendarik, përcakton pagën minimale sipas propozimit të Këshillit-Ekonomiko-Social*”. Ndërkaq, Ligji për Këshillin Ekonomiko-Social, në nenin 2 përcakton që “*Dispozitat e këtij ligji zbatohen për të gjithë partnerët social në nivel nacional, të cilët në Këshillin Ekonomiko-Social përfaqësohen nga: 1.1 Organizatat e të punësuarve (sindikatat); 1.2 Organizatat e punëdhënësve; dhe 1.3 Qeveria*”. Në këtë mënyrë, parashtruesit e kërkesës theksojnë se procedura për caktimin e pagës minimale kërkon arritjen e një pajtueshmërie të përfaqësuesve të shoqërisë.
40. Parashtruesit e kërkesës përkitazi me këtë pretendim, i referohen Konventës për Caktimin e Pagës Minimale të Organizatës Ndërkombëtare të Punës (*Minimum Wage Fixing Convention*, 1970, nr. 131) dhe theksojnë se sipas kësaj Konvente, “*çdo anëtar i Organizatës Ndërkombëtare të Punës që ratifikon këtë Konventë, merr përsipër të krijojë një sistem të pagave minimale që mbulon të gjitha grupet e pagës fituese, kushtet e punësimit të të cilëve janë të tilla që mbulimi do të ishte i përshtatshëm*”. Përveç kësaj, parashtruesit e kërkesës theksojnë se kjo Konventë parasheh që

“autoriteti kompetent në çdo vend, në marrëveshje ose pas konsultimit të plotë me organizatat përfaqësuese të punëdhënësve dhe punëtorëve në fjalë, aty ku ekzistojnë, do të përcaktojë grupet e pagave që do të mbulohen”. Në ndërlidhje me këtë, parashtruesit e kërkesës pretendojnë që Ligji i kontestuar i cenon këto standarde ndërkombëtare sepse i jep të drejtën Qeverisë të vendosë lartësinë e pagës minimale, pa u arritur pajtimi në Këshillin Ekonomiko-Social.

41. Parashtruesit e kërkesës i referohen nenit 6 (Ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës) të Ligjit të kontestuar, përmes të cilit ndryshohet neni 57 (Paga Minimale) i Ligjit të Punës, i cili përcakton se: *“Qeveria e Republikës së Kosovës në fund të çdo viti kalendarik përcakton pagën minimale sipas propozimit të Këshillit Ekonomiko-Social. Në mungesë të një propozimi të tillë nga Këshilli Ekonomiko-Social, Ministri përkatës për Financa, pas informimit të Këshillit Ekonomiko-Social, mund të parashtrojë një propozim të tillë për Qeverinë e Republikës së Kosovës”, dhe në këtë kontekst, pretendojnë “që dispozita e lartcekur e Ligjit të kontestuar, që e ndryshon Ligjin Nr. 03/L-212 të Punës (neni 57, paragrafi 1 i Ligjit nr. 03/L-212 të Punës) është në kundërshtim me standardet ndërkombëtare të cilat kërkojnë domosdoshmërinë e koordinimit social me rastin e përcaktimit të lartësisë së pagës minimale”.*
42. Në ndërlidhje me *“domosdoshmërinë e koordinimit social në përcaktimin e pagës minimale”,* parashtruesit e kërkesës theksojnë se e kanë parasysh se *“... obligueshmeria e Qeverisë apo ndonjë institucioni tjetër për koordinim të gjerë shoqëror me rastin e përcaktimit të lartësisë së pagës minimale nuk është e përcaktuar me Kushtetutë, ashtu si edhe Komiteti Ekonomiko-Social nuk rregullohet përmes dispozitave kushtetuese. Por përtej kësaj, jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese tanimë ka etabluar qëndrimin e saj se me rastin e interpretimit të Kushtetutës duhet të shqyrtohet edhe fryma dhe thelbi i Kushtetutës dhe jo domosdoshmërisht vetëm teksti i saj”. Në këtë kontekst, parashtruesit e kërkesës theksojnë se (i) domosdoshmëria e koordinimit social në caktimin e pagës minimale është standard ndërkombëtar i përcaktuar nga Organizata Botërore e Punës; (ii) se Organizata Botërore e Punës ka definuar çështjet kryesore sociale; dhe se (iii) drejtësia sociale është një prej vlerave kushtetuese të përcaktuar me nenin 7 [Vlerat] të Kushtetutës. Bazuar në si më lart, parashtruesit theksojnë se *“me rastin e veprimit sipas nenit 7 dhe 51 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, mospërfillja e koncepteve bazike të drejtësisë sociale, siç janë përcaktuar nga ana e Organizatës Ndërkombëtare të Punës, cenon drejtësinë sociale si vlera kushtetuese, të përcaktuar në nenin 7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe qëllimin e Kushtetutës, sipas nenit 51 të saj. Për këtë arsye, mundësia e Qeverisë që për pagën minimale të vendos njëanshëm bie në kundërshtim me nenin 7 dhe 51 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës”.**
43. Duke iu referuar Ligjit nr. 03/L-212 të Punës, parashtruesit e kërkesës theksojnë se ky ligj, në hyrjen e tij, nënvizon: *“Duke pasur parasysh Konventat e Organizatës Ndërkombëtare të Punës, Legjislacionin e BE-së dhe parimet themelore të ekonomisë së hapur dhe të tregut të punës”. Kështu, përderisa kemi një ligj në fuqi që përcakton së Konventat e Organizatës Ndërkombëtare të Punës janë bazamenti i këtij ligji, dispozitat e Ligjit të kontestuar cenojnë infrastrukturën juridike lidhur me çështjet nga marrëdhënia e punës”. Një gjë e tillë, sipas parashtruesve të kërkesës është në kundërshtim me nenin 7 [Vlerat] të Kushtetutës, që e përcakton drejtësinë sociale pjesë të vlerave të rendit kushtetues.*
44. Në fund, parashtruesit e kërkesës theksojnë se mundësia që Qeveria të caktojë lartësinë e pagës minimale njëanshëm është në kundërshtim me nenet 7 dhe 51 të Kushtetutës, dhe me *“Konventat e Organizatës Ndërkombëtare të Punës”.*

Komentet e dorëzuara nga palët e interesuara

45. Në vijim, Gjykata do të paraqes përgjigjet në kërkesën e parashtrueseve të kërkesës, përkatësisht (i) komentet e Avokatit të Popullit; (ii) komentet e Qeverisë së Republikës së Kosovës, në emër të Ministrisë së Financave; dhe (iii) komentet e Grupit parlamentar të Lëvizjes VETËVENDOSJE!.

(i) komentet e Avokatit të Popullit

46. Më 4 gusht 2023, Avokati i Popullit dorëzoi në Gjykatë komentet lidhur me Ligjin e kontestuar, duke theksuar se ka analizuar të njëjtin “[...] në dritën e sigurisë juridike, sundimit të ligjit, mbrojtjes shëndetësore dhe sociale, si dhe dinjitetin e njeriut”, dhe se ka vërejtur se me këtë Ligj ndryshohen (i) Ligji nr. 04/L-261 për Veteranët e Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 05/L-141; (ii) Ligji nr. 04/L - 092 për Personat e Verbër; dhe (iii) Ligji nr. 05/L - 067 për Statusin dhe të Drejtat e Personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik.

(a) lidhur me ndryshimin e Ligjit nr. 04/L-261 për Veteranët e Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 05/L-141 me Ligjin e kontestuar.

47. Avokati i Popullit, duke u bazuar në përcaktimet e Ligjit të kontestuar, thekson se “Qeverisë i është lënë mundësia që pas propozimit të ministrisë përkatëse, të vendosë për lartësinë e shumës së pensioneve”. Sipas Avokatit të Popullit, “Lënia e kësaj mundësie Qeverisë mund të rezultojë me jostabilitet për sa u përket pensioneve të veteranëve të UÇK-së”. Avokati i Popullit tutje thekson: “edhe pse në dukje fryma e kësaj dispozite lë të kuptohet se bëhet fjalë për rritje të shumës së pensionit të veteranit, sepse përmendet kostoja e jetesës dhe inflacioni eventual, kjo nuk do të thotë se nëse mundësitë buxhetore janë të limituara, Qeveria mund edhe të zvogëlojë lartësinë e shumës së pensionit. Përcaktimi i një mundësie të tillë i vë veteranët në situatë të pasigurisë juridike për sa i përket lartësisë së shumës së pensionit, sepse e drejta e tyre zhvendoset nga niveli ligjor në nivel të vendimit të Qeverisë, e cila në faza vjetore do të rivlerësohet, sidomos ata të cilët burim të vetëm të të hyrave e kanë këtë pension”.

(b) lidhur me ndryshimin e Ligjit nr. 04/L - 092 për Personat e Verbër me Ligjin e kontestuar

48. Avokati i Popullit thekson se Ligji i kontestuar “e ndryshon tërësisht rregullimin në ligjin bazik, sepse e ka shmangur bazën në pagën minimale e po ashtu e ka shmangur pragun minimal prej 100 eurosh të të ardhurave për personat e verbër. Një praktikë e tillë prodhon pasiguri juridike për personat të drejtat e të cilëve rregullohen me ligje të veçanta”. Në lidhje me këtë, Avokati i Popullit thekson: “ngjashëm sikurse tek Ligji për Veteranët e Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, që d.m.th. ekziston mundësia që Qeveria me vendim të caktojë lartësinë e shumës së pensioneve të personave të verbër, duke mos u bazuar në pagën minimale e as pragun minimal prej 100 eurosh sipas ligjit bazik aktualisht. Mosekzistimi i një pragu ligjor e lë krejtësisht në diskrecion të Qeverisë rregullimin e lartësisë së të ardhurave për personat e verbër dhe, pa paragjykuar asgjë, rreziku për jostabilitet të këtyre të ardhurave është më i madh, sepse vendimet e Qeverisë rishikohen në faza vjetore”.

(c) lidhur me ndryshimin e Ligjit nr. 05/L-067 për Statusin dhe të Drejtat e Personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik me Ligjin e kontestuar

49. Avokati i Popullit, ndër të tjera, thekson se “[...] edhe në këtë rast ligji e ndryshon rrënjësisht përcaktimin për sa i përket bazës së kompensimit të personave paraplegjik

dhe tetraplegjik”, duke shtuar që përderisa “ligji bazik e ka përcaktuar qartë bazën në pagën minimale, Ligji nr.08/L-142 e ka fshirë këtë bazë duke e lënë krejtësisht në diskrecion të Qeverisë, e cila pas propozimit të ministrisë përkatëse, të vendosë lidhur me lartësinë e shumës së kompensimeve për përfituesit e këtij ligji”.

(d) analizë e Avokatit të Popullit

50. Avokati i Popullit thekson se Ligji i kontestuar i ndryshon ligjet që rregullojnë aspektet sociale (i) të veteranëve të UÇK-së; (ii) të personave të verbër; si dhe (iii) të personave paraplegjikë dhe tetrapelgjik, dhe se ndryshimi i ligjeve bazike, duke hequr referencën në pagën minimale si bazë e pensione apo të ardhurave tjera, si dhe duke hequr pragun minimal për kategoritë e caktuara të personave (personat e verbër), mund të rezultojë në cenimin e parimit të sigurisë juridike të këtyre kategorive të personave, të drejtat e të cilëve rregullohen me ligje të veçanta.
51. Sipas Avokatit të Popullit, në situata të tilla kur ndryshimi i pagës minimale nga ana e Qeverisë si rezultat i rritjes së kostos së jetesës apo inflacionit eventual, *“mosekzistimi i një baze”* që kategorive të caktuara ligjërisht u garanton se të ardhurat dhe pensionet e tyre janë në përputhje me pagën minimale *“i sjellë personat e tillë në vështirësi ekonomike dhe ndikon në mënyrë e jetesës”*.
52. Avokati i Popullit thekson se nëpërmjet ndryshimit të ligjeve të veçanta nga ligjet e përgjithshme, po krijohet një praktikë e rrezikshme e hartimit të legjislacionit. Ai thekson se tashmë të drejtat dhe benficionet e kategorive të këtyre personave po zhvendosen nga niveli ligjor në atë nënligjor, duke i vënë ato në pozitë më të pasigurtë. Avokati i Popullit në këtë drejtim shton se mangësitë në aktet normative ndikojnë në sundimin e ligjit, përkatësisht në sigurinë juridike. Me siguri juridike, thekson ai, kërkohet që normat ligjore të jenë të qarta dhe precize, me të cilat synohet parashikimi i situatave, i veprimeve dhe i premtimeve të dhëna individëve nga Shteti (pritjet legjitime), e të cilat duhet të respektohen. Ligji i kontestuar sipas Avokatit të Popullit *“nuk i përmbush elementet e nevojshme të një norme e cila do t'i kontribuonte sundimit të ligjit”*. Avokati i Popullit i referohet edhe Komisionit të Venecias, respektivisht Raportit për Sundim të Ligjit të Komisionit të Venecias, miratuar nga Komisioni i Venecias në Seancën Plenare të 86-të, më 25-26 mars 2011, paragrafi 41.
53. Tutje, Avokati i Popullit vlerëson se neni 51 i Kushtetutës përcakton se kujdesi shëndetësor dhe sigurimi social që ka të bëjë me papunësinë, sëmundjen, aftësitë e kufizuara dhe moshën e shtyrë, rregullohen me ligj. E drejta e pensionit, thekson ai, përfshihet në grupin e të drejtave ekonomike sociale, të cilat për nga natyra janë të drejta pozitive. Është detyrim pozitiv i Shtetit që të marrë në mbrojtje individin, për t'i siguruar atij mjete jetese në formën e mbështetjes ekonomike nga Shteti, kur gjendet në moshën e pleqërisë ose kur është i paaftë për punë. Nëpërmjet politikave ekonomike dhe sociale, thekson ai, Shteti ka detyrimin që të garantojë mbrojtjen e individit, nëpërmjet masave financiare, ku bëjnë pjesë edhe pensionet për këto kategori shoqërore.
54. Avokati i Popullit, duke u referuar në përcaktimet e nenit 23 [Dinjiteti i Njeriut] të Kushtetutës, thekson se *“[...] është obligim i Shtetit t'u sigurojë të ardhura të mjaftueshme kategorive të personave të theksuar në mënyrë që ata të kenë mundësi të zhvillojnë jetë të dinjitetshme”*. Avokati i Popullit e mbështet këtë konsideratë, *“duke pasur parasysh rritjen e çmimeve si dhe inflacionin që mbretëron viteve të fundit në vend”*.
55. Përfundimisht, Avokati i Popullit kërkon nga Gjykata të vlerësojë nëse Ligji i kontestuar është në pajtim me Kushtetutën, përkatësisht në pajtim me *“sigurinë juridike”*, me

“elementet e sundimit të ligjit”, si dhe me “mbrojtjen shëndetësore dhe sociale dhe me dinjitetin e njeriut”.

(ii) Komentet e Qeverisë së Republikës së Kosovës, në emër të Ministrisë së Financave

56. Më 4 gusht 2023, Kryeministri i dorëzoi *“Komentet e Qeverisë së Republikës së Kosovës lidhur me kërkesën KO158/23, respektivisht komentet e Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve”*, duke theksuar që komentet e paraqitura janë në emër të Ministrisë së Financave, dhe që bazuar në pretendimet e parashtruesve të kërkesës, komentet do të kufizohen vetëm në atë nëse përmbajtja e Ligjit të kontestuar është në kundërshtim me Kushtetutën dhe specifikisht, Ministria e Financave do të parashtrrojë argumentet e saj (a) *përkitazi me pretendimet për diskriminimin e kategorive shoqërore*; dhe (b) *përkitazi me pretendimet për mënyrën e përcaktimit të pagës minimale*. Ndërlidhur me pretendimet për diskriminimin e kategorive shoqërore, Ministria e Financave, duke u referuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese dhe të GJEDNJ-së, thekson se për të konstatuar nëse një akt mund të ketë rezultuar në diskriminim në kundërshtim me garancitë e nenit 24 të Kushtetutës, nenit 14 të KEDNJ-së, dhe nenit 1 të Protokollit nr. 12 të KEDNJ-së, së pari duhet të vlerësohet nëse akti përkatës ka trajtuar në mënyrë të ndryshme *“persona në situata analoge ose relativisht të ngjashme”*, dhe nëse ky është rasti, të vlerësojë nëse ky dallim në trajtim (a) është përcaktuar me ligj; (b) ndjek një qëllim legjitim; dhe (c) është proporcional, përkatësisht *“nëse ekziston një marrëdhënie e proporcionalitetit ndërmjet kufizimit të së drejtës, dhe qëllimit që synohet të arrihet”*. Me këtë rast, Ministria e Financave i referohet rastit të Gjykatës [KO01/17](#), cituar më lart, paragrafi 74, dhe rastit të GJEDNJ-së [Carson dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar](#), nr. 42184/05, Aktgjykim i 16 marsit 2010.
57. Ministria e Financave në ndërlidhje me pretendimet e parashtruesve të kërkesës për diskriminimin e kategorive shoqërore, ka paraqitur komente përkitazi me vlerësimin (i) *“nëse kemi të bëjmë me persona në situata analoge ose relativisht të ngjashme”*, duke aplikuar (a) *“parimet e përgjithshme”*, dhe (b) *“aplikimin e këtyre parimeve në rastin konkret”*. Më pas, Ministria e Financave paraqiti komente edhe përkitazi me pretendimet e parashtruesve të kërkesës në lidhje me (c) *“qëllimin legjitim dhe proporcionalitetin i cili është ndjekur”*, dhe (d) *“pritshmëritë legjitime” si dhe për (ii) “mënyrën e “përcaktimit të pagës minimale”*.
58. Ministria e Financave fillimisht thekson se koncepti i *“dallimeve midis njerëzve që nuk janë persona në situata analoge ose relativisht të ngjashme”*, i referohet njohjes se individët mund të kenë karakteristika ose rrethana të dallueshme që i dallojnë ata në disa aspekte. Këto dallime sipas Ministrisë së Financave mund *“të kenë implikime ligjore, sociale ose praktike, duke çuar në trajtim ose konsideratë të ndryshme për secilin grup, si dhe se kërkesa për të demonstruar një situatë analoge nuk kërkon që grupet krahasuese të jenë identike”*.
59. Ministria e Financave, bazuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës, thekson se: *“Gjykata Kushtetuese ka përcaktuar në praktikën e saj gjyqësore se vetëm ndryshimet në trajtim të bazuara në një karakteristikë të identifikueshme ose “status” mund të arrijnë në diskriminim sipas kuptimit të nenit 24 të Kushtetutës dhe 14 të KEDNJ-së. Së dyti, një ndryshim në trajtim është diskriminues nëse nuk ka arsyetim objektiv dhe të arsyeshëm; me fjalë të tjera, nëse nuk ndjek një qëllim legjitim ose nëse nuk ka një marrëdhënie të arsyeshme proporcionaliteti midis mjeteve të përdorura dhe qëllimit që kërkohet të realizohet”*. Për më tepër, Ministria thekson se, *“Gjykata ka theksuar që Qeveria dhe Kuvendi gëzojnë një margjinë të vlerësimit të lirë kur vlerësojnë nëse dhe deri në çfarë mase diferenat në situata tjera të ngjashme justifikojnë një ndryshim në*

trajtim. Një margjinë e gjerë zakonisht i lejohet Shtetit kur bëhet fjalë për masat e përgjithshme të strategjisë ekonomike ose sociale, përveç nëse ato janë qartazi pa asnjë bazë të arsyeshme (shih, rastin e Gjykatës, [K001/17](#), cituar më lart, paragrafët 74 dhe 75).

60. Në këtë kontekst, Ministria e Financave konsideron se është e nevojshme që (i) të vlerësohet nëse veteranët e luftës, personat e verbër, personat paraplegjik dhe tetraplegjik ndodhen në një situatë të ngjashme apo të krahasueshme si kategori me njëra-tjetrën, si dhe (ii) të vlerësohen po ashtu nëse janë në një situatë të ngjashme apo të krahasueshme me punëtorët e tjerë që janë në marrëdhënie pune. Sipas Ministrisë së Financave, *“punëtorët në marrëdhënie pune”* përbëjnë *“krahasuesin”* apo grupin e personave ndaj të cilëve krahasohen veteranët e luftës, personat e verbër, paraplegjikët dhe tetraplegjikët. Në ndërlidhje me këtë, Ministria vë në pah se ekzistimi i një rregullimi të veçantë të statusit ligjor me ligje specifike të këtyre kategorive në shikim të parë shpërfaq ekzistimin e një situatë për të cilën këto kategori nuk janë në një situatë të krahasueshme apo të ngjashme.
61. Ministria e Financave më tej thekson se: *“Veteranët e Luftës Çlirimtare si kategori e veçantë kanë kaluar në përvoja unike pasi kanë shërbyer në Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës dhe së dyti kanë dhënë kontribut jetik në lirinë e vendit”*. Në këtë mënyrë, si shpërblim për mundin dhe sakrificën e kësaj kategorie, ligjvënësi ka përcaktuar të drejta dhe beneficione të caktuara, të cilat në Ligjin nr. 04/L-261 nuk janë kufizuar vetëm në pensionin e përcaktuar në nenin 18 të këtij Ligji, por edhe të drejta të tjera si të drejtë në shërbime shëndetësore falas, përparësi në punësim, të drejta të caktuara në udhëtim, përparësi të pranimit në institucionet arsimore publike. Prandaj, të drejtat dhe përfitimet e dhëna për veteranët e Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, bazohen në vlerësimin e ligjvënësit për kontributet e tyre gjatë Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, dhe jo mbi bazën e të drejtës në një shumë të caktuar të beneficionit. Veteranët realizojnë edhe të drejta të tjera sipas Ligjit nr. 04/L-261, përtej beneficionit në nenin 18 të Ligjit nr. 04/L-261, e që dallon nga *“punëtorët në marrëdhënie punë”* për të cilët vlen instituti i pagës minimale dhe të cilët nuk i kanë këto të drejta të garantuara siç i kanë veteranët nga fakti i të qenit punëtorë në marrëdhënie pune.
62. Ministria e Financave tuje thekson që për dallim nga veteranët e luftës, personat e verbër, paraplegjikët dhe tetraplegjikët, fitojnë të drejta dhe beneficione për shkak të karakteristikave të tyre personale, në këtë rast, *“mungesa e aftësive të caktuara fizike”*. Në këtë kontekst, Ministria e Financave thekson se *“... të drejtat dhe beneficionet e personave të verbër janë të specifikuara në Ligjin Nr. 04/L-092 për Personat e Verbër, ku ndër të tjera personat e verbër gëzojnë të drejtën e punësimit në kushte të favorshme dhe me përparësi, lirinë nga taksat dhe tatime, strehimi, udhëtimi, shpenzimet e energjisë elektrike etj. Ngjashëm të drejtat dhe beneficionet e personave paraplegjik dhe tetraplegjik rregullohen përmes Ligjit Nr. 05/L-067 për Statusin dhe të Drejtat e Personave me Paraplegji dhe Tetraplegji ku ndër të tjera kjo kategori kanë të drejtë në kujdestar personal, lirim nga taksat dhe tatimet, kujdes shëndetësor falas, reduktim në tarifrat e energjisë elektrike, përkujdesje për strehim dhe lirimë në udhëtim”*.
63. Në këto baza, Ministria e Financave konsideron se *“... kategoria e veteranëve, personave të verbër dhe personat paraplegjik dhe tetraplegjikë gëzojnë të drejta dhe beneficione të tjera të cilat paraqesin politika të tilla që mundësojnë përballimin e shpenzimeve jetësore përtej beneficionit që më parë lidhej me shumën e pagës minimale, ndërsa në anën tjetër për ‘punëtorët në marrëdhënie punë’ për të cilët vlen nocioni i pagës minimale, si burim i vetëm i të ardhurave nuk kanë lirimë apo përparësi të ngjashme që do t’i mundësonin përballimin e shpenzimeve jetësore”*. Rrjedhimisht, sipas Ministrisë së Financave *“këto kategori nuk mund të konsiderohen*

si persona në situata analoge ose relativisht të ngjashme vetëm nga fakti se shuma e një nga beneficionet e ndryshme që ju takojnë këtyre kategorive është e ndërlidhur me pagën minimale.

64. Në përfundim, Ministria e Financave thekson që, “*duke qenë edhe kategori të ndryshme e që nuk janë në situatë të njëjtë, ligjvënësi ka konsideruar që instituti i pagës minimale duhet të lidhet vetëm me punën dhe shërbimet e kryera në kuadër të punës, ndryshe nga koncepti i të ardhurave minimale që synon të garantojë kushte minimale të jetesës pavarësisht nëse personi ka një punë nga e cila merr pagë*”.
65. Në lidhje me “*qëllimin legjitim dhe proporcionalitetin që është ndjekur*”, Ministria e Financave i referohet praktikës së GJEDNJ-së, duke theksuar se kjo e fundit kishte vlerësuar që në fushën e legjislacionit social, duke përfshirë edhe fushën e pensioneve, shtetet gëzojnë një margjinë të gjerë vlerësimi, e cila në interes të drejtësisë sociale dhe mirëqenies ekonomike mund t’i shtyjë në mënyrë legjitime të rregullojnë, kufizojnë apo edhe reduktojnë sasinë e pensionit që zakonisht i paguhen popullatës kualifikuese. Ministria e Financave i referohet edhe praktikës gjyqësore të Gjykatës, respektivisht rastit [KOO1/17](#), citur më lart, ku kishte vlerësuar se “*ligjvënësi gëzon diskrecion të caktuar për të vendosur lidhur me masat për arritjen e objektivave specifike dhe, sigurisht, nuk i takon Gjykatës të zëvendësojë vlerësimin e bërë nga autoritetet relevante me vlerësim të vetin, lidhur me atë se cila mund të jetë politika më e mirë në këtë fushë*”.
66. Ministria e Financave tutje shpjegon se Ligji i kontestuar synon krijimin e kushteve për rritjen e pagës minimale, duke pasur parasysh stabilitetin dhe qëndrueshmërinë financiare për buxhetin e Republikës së Kosovës. Në ndërlidhje me këtë, Ministria e Financave argumenton se marrja për bazë e pagës minimale si nivel për caktimin e lartësisë së pensioneve për kategoritë e lartcekura shoqërore, është jo e qëndrueshme, joproporcionale në planin afatgjatë dhe barrë e madhe për buxhetin e vendit. Në këtë kontekst, Ministria e Financave thekson: “*Kjo për shkak se do të krijonte barrë të madhe për buxhetin e Kosovës, duke ndërlidhur këto beneficione me pagën minimale, qëllimi i së cilës është tërësisht tjetër dhe që vendoset duke pasur parasysh kritere të tjera që kanë të bëjnë me marrëdhënien e punës, e që po ashtu do të ndikonte në dialogun social në mes partnerëve social, duke qenë se elementi i ndërlidhjes së pagës minimale do të duhej të merrej parasysh gjatë përcaktimit të pagës minimale*”. Ministria e Financave, më tej, thekson se, “*Fakti që paga minimale nuk është ndryshuar asnjëherë edhe pas më shumë se 12 viteve, ndonëse kishte obligim ligjor për këtë, tregon efektin praktik të kësaj ndërlidhje që është bërë, prandaj edhe është konsideruar që ka qenë e domosdoshme rregullimi i aspekteve ligjore që ndërlidhen me pagën minimale*”. Sipas Ministrisë së Financave, më 17 gusht 2011, Qeveria përmes Vendimit nr. 04/33, e përcaktoi pagën minimale në Kosovë, 130.00 euro për të punësuarit nën moshën 35-vjeçare, dhe 170.00 euro për të punësuarit mbi moshën 35-vjeçare deri në moshën 65-vjeçare. Që nga ajo kohë paga minimale nuk është ndryshuar asnjëherë, ndonëse neni 57 i Ligjit Nr. 03/L-212 të punës kishte përcaktuar që Qeveria e Kosovës në fund të çdo viti kalendarik përcakton pagën minimale sipas propozimit të Këshillit-Ekonomik Social”. Sipas Ministrisë së Financave kjo situatë “*... do të krijonte barrë të madhe për buxhetin e Kosovës, duke ndërlidhur këto beneficione me pagën minimale, qëllimi i së cilës është tërësisht tjetër dhe që vendoset duke pasur parasysh kritere të tjera që kanë të bëjnë me marrëdhënien e punës, e që po ashtu do të ndikonte në dialogun social në mes partnerëve social, duke qenë se elementi i ndërlidhjes së pagës minimale do të duhej të merrej parasysh gjatë përcaktimit të pagës minimale. Kjo anasjelltas do të nënkuptonte në mënyrë që ndikimi tek buxheti të ishte i qëndrueshëm, paga minimale do të përcaktohej në nivel më të ulët se kriteret/formula përkatëse për caktimin e pagës minimale*”.

67. Ministria e Financave tutje argumenton se caktimi i pensionit për të gjitha kategoritë e tjera shoqërore, përfshirë përfituesit e pensionit bazik të moshës, pensionit kontributdhënës të moshës, pensionit të aftësisë së kufizuar, pensionet e parakohshme, pensionit invalidor të punës dhe pensionit familjar, dhe të tjera si këto, rregullohet nga Ligji për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti, dhe lartësia e këtyre pensioneve nuk lidhet me pagën minimale, por caktohet nga Qeveria me vendim të veçantë, sipas kriterëve të përcaktuara, përfshirë koston e jetës, mundësitë buxhetore dhe inflacionin eventual. Në mënyrë që rregullimi ligjor të jetë i ngjashëm dhe proporcional për të gjitha kategoritë shoqërore, dhe duke marrë parasysh karakteristikat e secilit grup shoqëror, është paraparë mundësia që përcaktimi i pensionit të bëhet sipas propozimit të ministrisë dhe bazuar në kriterë të caktuara.
68. Ministria e Financave thekson se shkëputja e lidhshmërisë së pagës minimale me tri kategoritë e përmendura është se *“kategoritë e tjera shoqërore, siç janë ato të cilat rregullohen përmes Ligjit Nr. 04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti, (përfituesit e pensionit bazik të moshës, pensionit kontributpagues të moshës, pensionit të aftësisë së kufizuar, pensionit të parakohshëm, pensionit invalidor të punës dhe pensionit familjar) lartësinë e shumës së pensioneve nuk e kanë të ndërlidhur me shumën e pagës minimale”*. Në ndërlidhje me këtë, Ministria e Financave thekson se *“... përcaktimi i pagës minimale si kriter për vendosjen e beneficioneve të cilat nuk ndërlidhen me periudha të sigurimit dhe që paguhen direkt nga buxheti i Shtetit, do të mund të ngriste çështje të trajtimit të pabarabartë me kategoritë e tjera të rregulluara me Ligjin Nr. 04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti dhe do të krijonte pritshmëritë joproporcionale që secili grup a kategori që përfiton nga skemat pensionale apo benefitet e financuara nga buxheti i shtetit, duke përfshirë personat në asistencë sociale do të duhej të merrnin beneficionin në shumën e pagës minimale, gjë që shkon përtej qëllimit të pagës minimale, si dhe rrezikon stabilitetin makro-ekonomik të vendit”*.
69. Më tej, dhe në lidhje me pretendimin e parashtruesve të kërkesës se *“veteranët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, personat e verbër, personat paraplegjik dhe tetraplegjik kanë pasur pritje legjitime që pensioni i tyre do të jetë në nivel të pagës minimale”*, Ministria e Financave, i referohet praktikës së GJEDNJ-së, sipas së cilës shtetet kontraktuese kanlirinë për të vendosur në lidhje me formën e skemave shoqërore, dhe zgjedhjen e llojit apo shumës së përfitimeve që duhen ofruar. Sipas Ministrisë, GJEDNJ ka pranuar se në fushën e legjislacionit social, duke përfshirë fushën e pensioneve, shtetet gëzojnë një diskrecion të gjerë vlerësimi, e cila në interes të drejtësisë sociale dhe mirëqenies ekonomike, mund t'i shtyjë në mënyrë legjitime të rregullojnë, kufizojnë apo edhe reduktojnë sasinë e pensionit që zakonisht i paguhen popullatës kualifikuese, duke pasur parasysh që çdo masë e tillë duhet të zbatohet në mënyrë jo-diskriminuese dhe të jetë në përputhje me kërkesat e proporcionalitetit. Në këtë kontekst, Ministria i referohet rasteve të GJEDNJ-së (i) [Sukhanov dhe Ilchenko kundër Ukrainës](#), nr. 683885/10, Aktgjykimi i 26 qershorit 2014, paragrafi 36; (ii) [Kolesnyk kundër Ukrainës](#), nr. 57116/10, Vendim i 3 qershorit 2014, paragrafët 89 dhe 91; dhe (iii) [Fakas kundër Ukrainës](#), nr. 4519/11, Vendimi i 3 qershorit 2014, paragrafët 37-43 dhe 48.
70. Tutje, Ministria e Financave thekson se ligjvënësi ka në diskrecion autorizime për të ndryshuar ligjet që rregullojnë çështjet sociale, nëse synimi i ndjekur ka qenë legjitim dhe ka një marrëdhënie të arsyeshme proporcionaliteti ndërmjet mjetit të përdorur dhe qëllimit të kërkuar për t'u realizuar. Në këtë kontekst, Ministria e Financave, i referohet rastit të GJEDNJ-së [Lakićević dhe të tjerët kundër Malit të Zi dhe Serbisë](#), nr. 27458/06, 37205/06, 37207/06 dhe 33604/07, Aktgjykim i 13 dhjetorit 2011, paragrafi 61. Në rastin konkret, Ministria e Financave argumenton se e drejta e pensionit nuk është

ndalur, por vetëm është shkëputur paga minimale me pensionin e grupeve shoqërore, dhe një gjë e tillë “është legjitime dhe proporcionale”.

71. Shprehimisht, Ministria e Financave thekson se: “në rastin e ndryshimit të formës së përcaktimit të lartësisë së beneficioneve përkatëse sipas Ligjit të kontestuar, thelbi i të drejtës për beneficion si i tillë nuk është cenuar në rastin e Ligjit të kontestuar. Pra, kjo e drejtë, do të vazhdojë të aplikohet, dhe ashtu siç u shpjegua më lart ndërhyrja e ligjvënësit për të shkëputur lidhshmërinë me nivelin e pagës minimale është proporcionale dhe legjitime, andaj nuk mund të konsiderohet që kemi të bëjmë me 'pritje legjitime' ashtu që lartësia e shumës së beneficioneve do të ishte gjithmonë sa lartësia e pagës minimale”.
72. Ministria e Financave, duke iu referuar praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, thekson se: “Për më shumë, duke u ndërlidhur me rastin [Sukhanov dhe Ilchenko kundër Ukrainës](#) (të cituar më lart) në paragrafin 36, sa për shumën e caktuar të pensionit, GJEDNJ, nuk pranoi që kërkesat e aplikantëve për shtesë pensioni në masën 30% të pensionit minimal përbënin një “prishmëri legjitime ... në veçanti, sepse pretendimet të tilla nuk kishin bazë të mjaftueshme në ligjin kombëtar”. Ngjashëm, në lidhje me veteranët, lidhshmëria e beneficioneve me pagën minimale, me nenin 16A të Ligjit Nr. 04/L-141 vetëm se ishin përcaktuar shuma fikse të ndryshme nga paga minimale”.
73. Ministria e Financave konsideron që “ka ekzistuar një vakum ligjor për mënyrën e përcaktimit të lartësisë së shumës së beneficioneve të përcaktuara me Ligjin Nr. 04/L-261.” Kjo sepse, sipas Ministrisë së Financave, “... përmes nenit 5 të Ligjit Nr. 05/L-141 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/1. -261 për Veteranët e Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, neni 18 i Ligjit bazik ishte fshirë, që përcaktonte lartësinë e beneficionit në nivel të pagës minimale. Në këtë situatë, ligjvënësi ka konsideruar që është e nevojshme që të plotësohet dhe ndryshohet neni 16A, paragrafi 3 nënparagrafi 3.1 i Ligjit Nr. 04/1+261, ku përpos qëllimit legjitim dhe proporcional për përcaktimin e lartësisë së shumës së beneficionit ndryshe nga siç kishte qenë më parë, është sqaruar edhe mënyra e rregullimit të lartësisë së shumës së beneficioneve përkatëse”.
74. Bazuar në si më lart, Ministria e Financave thekson se, “në analogji edhe me praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, nuk mund të thuhet se ka ekzistuar ndonjë “prishmëri legjitime” kur ka një mosmarrëveshje në lidhje me interpretimin dhe zbatimin e saktë të ligjit të brendshëm (shih, ndër të tjera, [Kopecky kundër Sllovakisë](#), cituar më lart, paragrafi 50, [Anheuser-Busch Inc. kundër Portugalisë](#), nr. 73049/01, Aktgjykimi i 11 janarit 2007, paragrafi 65)”.
75. Duke iu referuar praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, Ministria e Financave thekson se “përveç veteranëve, edhe në aspektin e personave të verbër dhe personave paraplegjik dhe tetraplegjik, rikujtojmë se nga praktika gjyqësore e GJEDNJ-së mund të konkludohet se doktrina e pritjeve legjitime vlerësohet brenda një konteksti nëse pritjet legjitime mbështeten në një akt juridik të pushtetit (baza e pritjeve legjitime) i justifikuar në kuptimin që ai mund të supozojë se ligji ose norma nuk do të ndryshohet më pas (shih, mutatis mutandis, [Pine Valley Developments Ltd dhe të tjerët kundër Irlandës](#), nr. 12742/87, Aktgjykim i 29 nëntorit 1991)”.
76. Për sa i përket pretendimeve për mënyrën e përcaktimit të pagës minimale, Ministria e Financave, thekson se: “parashtruesit e kërkesës kanë dështuar të argumentojnë se një çështje e tillë ka të bëjë me kategori kushtetuese”, sepse “baza e pretendimit të tyre është e rrënjësuar në nocionin se standardet ndërkombëtare të Organizatës Ndërkombëtare të Punës (“ILO”) janë në përputhje me frymën dhe thelbin e Kushtetutës”. Megjithatë, nga këndvështrimi i Ministrisë së Financave “një argument

i tillë, i cili synon të inkorporojë 'në bllok' të gjitha standardet e punës të ILO-s brenda sistemit kushtetues të Kosovës, ngre shqetësime”.

77. Në këtë vazhdë, Ministria e Financave thekson se parashtruesit e kërkesës marrin për bazë Organizatën Ndërkombëtare të Punës dhe konventat e saj me rastin e caktimit të pagës minimale. Ministria e Financave thekson që: *“Kosova nuk e ka ratifikuar Konventën e ILO-s për caktimin e pagës minimale dhe konventat e tjera, e as nuk është pjesë e kësaj organizate. Për më tepër, shumë shtete anëtare nuk e kanë ratifikuar Konventën për caktimin e pagës minimale, përfshirë gjysmën e shteteve të Këshillit të Evropës, ndërsa disa vende të tjera nuk e rregullojnë fare institutin e pagës minimale”*. Ministria e Financave tutje thekson se Ligji i kontestuar është në përputhje të plotë me Konventën për caktimin e pagës minimale, ngase mundëson që paga minimale të fiksohet dhe rregullohet herë pas herë pasi që dialogu social do të fokusohet vetëm në komponentët përkatës të tregut të punës që lidhen me lartësinë e pagës minimale.
78. Sipas Ministrisë së Financave, *“Konventa e ILO-s përcakton që autoriteti kompetent në çdo vend, në marrëveshje ose pas konsultimit të plotë me organizatat përfaqësuese të punëdhënësve dhe punëtorëve në fjalë, aty ku ekzistojnë, do të përcaktojë grupet e pagave që do të mbulohen”*. Ministria e Financave shton se sipas kësaj Konvente është e nevojshme të ketë marrëveshje ose konsultim të plotë. Konventa nuk përcakton domosdoshmërinë që të ekzistojë një propozim konkret nga ndonjë institucion i ngjashëm me Këshillin Ekonomiko-Social. Sipas saj (i) funksioni i Këshillit Ekonomiko-Social është që të nxisë konsultimin e palëve, rrjedhimisht përmes ndryshimeve të reja ligjore synohet që edhe roli i këtij këshilli të jetë proaktiv dhe të mundësoj arritjen e një propozimi përkatës, (ii) dhe vetëm kur të mungon propozimi i Këshillit Ekonomiko-Social, atëherë Qeveria e ushtron autoritetin e vet ekzekutiv për caktimin e pagës minimale, por vetëm pas konsultimit të plotë dhe në mungesë të një propozimi.
79. Në vazhdim, Ministria e Financave, thekson se, sipas saj, pavarësisht këtij fakti, instituti i pagës minimale nuk është kategori kushtetuese, dhe se *“parashtruesit e kërkesës gabimisht pretendojnë se rregullimi i Ligjit të kontestuar është në kundërshtim me Konventën për Fiksimin e Pagës Minimale (Nr. 131) të vitit 1970, për më shumë nuk saktësojnë se cila është esenca e së drejtës e cila është cenuar dhe nuk saktësojnë nenin specifik të Konventës që konsiderohet që nuk është respektuar”*. Ministria e Financave, përkundrazi konsideron që duke bërë rregullimin e ri sipas Ligjit të kontestuar arrihet përputhshmëri më e madhe e aplikimit indirekt të kësaj Konvente në legjislacionin tonë, duke pasur parasysh që paga minimale nuk është ndryshuar që 12 vite, pikërisht përmes rregullimit të ri mundësohet që të krijohen kushtet dhe lehtësirat që paga minimale të fiksohet dhe rregullohet herë pas here pasi që dialogu social do fokusohet vetëm në komponentët përkatës të tregut të punës që lidhen me lartësinë e pagës minimale. Kjo për arsye se në bazë të Ligjit nr. 04/L-008 për Këshillin Ekonomiko-Social është pikërisht funksion i Këshillit Ekonomiko-Social që të nxisë konsultimin e palëve, rrjedhimisht përmes ndryshimeve të reja ligjore synohet që edhe roli i këtij këshilli të jetë proaktiv dhe të mundësoj arritjen e një propozimi përkatës, dhe vetëm në mungesë të këtij propozimi, Ministri i Financave autorizohet që pas informimit të Këshillit Ekonomiko-Social të bëjë një propozim të tij në Qeveri, ashtu që i mundësohet Qeverisë që të ushtroj kompetencat e saj kushtetuese për ushtrimin e pushtetit ekzekutiv. Në këtë rast propozimi i Ministrit të Financave nënkupton se do të shterohet konsultimi i plotë, dhe vetëm kur të ndodhë kjo dhe nëse nuk ka një propozim, atëherë Ministri ka të drejtë të jap propozimin e tij për pagën minimale.
80. Ministria e Financave thekson se është e pakontestueshme që parashtruesi i kërkesës thekson se në Ligjin nr. 03/L-212 të Punës, në preambulë përcaktohet se ai është miratuar *“duke marrë parasysh Konventat e ILO-s, legjislacionin e BE-së dhe parimet themelore të tregut dhe ekonomisë së lirë të punës”*, mirëpo, vetë përfshirja e disa

traktateve dhe konventave që burojnë nga entitete të ndryshme, paraqet problem në mënyrën e zbatimit të ligjit, kur në një rast specifik, këto entitete të ndryshme e shohin kuptimin e të njëjtave të drejta të njeriut ndryshe. Në lidhje me këtë, Ministria e Financave i referohet rasteve të Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Evropian (GJDBE), [International Transport Workers Federation and Finnisht Seamen's Union v. Viking Line ABP dhe OU Viking Line Eesti](#), C-438-05, Aktgjykim i 11 dhjetorit 2007; [Laval un Parterni Ltd v. Svenska Byggnadsarbetareförbundet and Others](#), C-341/05, Aktgjykim i 18 dhjetorit 2007, si dhe të drejtës së Bashkimit Evropian, duke argumentuar se ka “mungesë koherence në interpretim”. Prandaj, sipas Ministrisë së Financave, parashtruesit e kërkesës kanë dështuar të argumentojnë se si mënyra e përcaktimit të pagës minimale është bërë standard kushtetues vetëm me faktin e përmendjes në mënyrë të përgjithshme të standardeve ndërkombëtare të ONP-së.

81. Megjithatë, Ministria e Financave gjithashtu thekson se disa standarde ndërkombëtare të ONP-së, për shkak të ratifikimit pothuajse universal të tyre, praktikisht janë shndërruar në standarde fundamentale të të drejtave të njeriut lidhur me çështjet e punës, duke cekur, (i) Konventën për Lirinë e Asociimit dhe Mbrojtjen e të Drejtës për Organizim, e vitit 1948 (Nr. 87); (ii) Konventën për të Drejtën për Organizim dhe Bisedime Kolektive, e vitit 1949 (Nr. 98); (iii) Konventën e Punës së Detyrueshme, e vitit 1930 (Nr. 29) (dhe Protokollin i saj i vitit 2014); (iv) Konventën për heqjen e punës së detyruar, e vitit 1957 (nr. 105); (v) Konventën për moshën minimale, e vitit 1973 (nr. 138); (vi) Konventën për format më të këqija të punës së fëmijëve, e vitit 1999 (nr. 182); (vii) Konventën për shpërblim të barabartë, e vitit 1951 (nr. 100); (viii) Konventën e Diskriminimit (Punësimi dhe Profesionin), e vitit 1958 (Nr. 11 1); (ix) Konventën për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, e vitit 1981 (Nr. 155); dhe (x) Konventën e Kornizës Promovuese për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, e vitit 2006 (Nr. 187).

(iii) Komentet e Grupit parlamentar të Lëvizjes VETËVENDOSJE!

82. Më 4 gusht 2023, deputetja Mimoza Kusari-Lila, në emër të Grupit parlamentar të Lëvizjes VETËVENDOSJE! (në tekstin e mëtejme: grupi parlamentar i LVV-së), dorëzoi komente në lidhje me kërkesën. Fillimisht, Grupi parlamentar i LVV-së konsideron se kërkesa e parashtrueseve të kërkesës paraqet pretendime që nuk kanë asnjë lidhje direkte apo indirekte me normën kushtetuese, duke theksuar specifikisht se “në asnjë rrethanë Ligji i kontestuar nuk ka cenuar germën apo frymën e Kushtetutës apo të akteve ndërkombëtare që janë të pranura nga Republika e Kosovës”.
83. Gjykata vëren se, në tërësinë të tyre, komentet e dorëzuara nga Grupi parlamentar i LVV-së janë të ngjashme me komentet e Ministrisë së Financave.
84. Më saktësisht, dhe ndërlidhur me pretendimet lidhur me diskriminimin, grupi parlamentar i LVV-së, thekson se për të përcaktuar nëse ka apo jo diskriminim, duhet vlerësuar nëse ekziston dallimi në trajtim midis personave në situata të ngjashme. Duke iu referuar praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, ata theksojnë se vetëm ndryshimet në trajtim që janë të bazuara në një karakteristikë të identifikueshme ose “status” mund të shkaktojnë diskriminim. Sipas tyre, praktika e GJEDNJ-së ka përcaktuar se kur bëhet fjalë për masat e përgjithshme të strategjisë ekonomike ose sociale, shteteve u lejohet një fushëveprim shumë më i gjerë, sepse vetëm kështu mund të zbatohen qëllimet legjitime të programeve qeverisëse e politike të institucioneve legjitime të zgjedhura në formë demokratike. Sipas tyre, GJEDNJ-ja e respekton zgjedhjen e politikës së legjislativit, sepse ligjvënësit dhe qeveritë janë në posedim të njohurive të drejtpërdrejta të shoqërisë së tyre dhe nevojave të saj dhe në këtë kontekst i referohen rasteve të GJEDNJ-së: [Carson dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar](#), cituar më lart, paragrafi 61; [Molla Sali kundër Greqisë](#), nr. 20452/14, Aktgjykim i 18 qershorit 2020; [Fabris kundër Francës](#), nr. 16574/08, Aktgjykim i 7 shkurtit 2013; [Weller kundër](#)

[Hungarisë](#), nr. 44399/05, Aktgjykimi i 30 qershorit 2009; [Hämäläinen kundër Finlandës](#), nr. 37359/09, Aktgjykim i 16 korrikut 2014, para. 109.

85. Grupi parlamentar i LVV-së thekson se Ligji i kontestuar ka ndryshuar ligjet të cilat e ndërlidhin lartësinë e pensionit me pagën minimale, përkatësisht ligjin për veteranët e luftës së UÇK-së, për personat e verbër, për statusin dhe të drejtat e personave paraplegjik dhe tetraplegjik. Ekzistimi i një rregullimi të veçantë të statusit ligjor me ligje specifike të këtyre kategorive tregon që këto kategori nuk janë në një situatë të ngjashme. Veteranët e luftës së UÇK-së i marrin të drejtat në beneficione për shkak të pjesëmarrjes së tyre në luftë, si mirënjohje e shoqërisë për kontributin e tyre për lirinë e vendit, që nuk e ka për bazë gjendjen e tyre ekonomike. Ligji për veteranët e luftës përcakton edhe të drejta shtesë, si shërbime shëndetësore falas, përparësi në punësim dhe të tjera. Në anën tjetër, theksojnë ata, personat e verbër dhe personat paraplegjik dhe tetraplegjik, fitojnë të drejta dhe beneficione për shkak të karakteristikave të tyre personale, përfshirë jo vetëm pensionin por edhe të drejta të tjera, si kujdesi shëndetësor, lirim nga taksat dhe tatimet dhe të tjera. Ndërkaq, për punëtorët në marrëdhënie pune vlen koncepti i pagës minimale, si shpërblim për kryerjen e detyrave në vendin e punës. Rrjedhimisht, sipas Grupit parlamentar i LVV-së, të gjitha këto kategori shoqërore janë të ndryshme dhe nuk kanë ngjashmëri ndërmjet vete.
86. Tutje, grupi parlamentar i LVV-së thekson se nëpërmjet Ligjit të kontestuar ligjvënësi ka pasur qëllim krijimin e mundësisë për rritjen e pagës minimale, ashtu që ky instrument të luajë rolin e tij vetëm si institucion i rregullit i tregut dhe mbrojtjes së punëtorit. Marrja për bazë e pagës minimale gjatë caktimit të lartësisë së pensionit për kategoritë e lartpërmendura shoqërore, është e paqëndrueshme në planin afatgjatë. Sipas tyre, fakti që paga minimale nuk është ndryshuar për 12 vjet, përkundër që përbën detyrim ligjor, tregon për domosdoshmërinë e ndarjes së pagës minimale me lartësinë e pensioneve. Ndërlidhja e tyre nuk ka qenë e përshtatshme, edhe për faktin që kategoritë e përmendura shoqërore fitojnë edhe të drejta të tjera të përcaktuara nga ligji. Një arsye tjetër i shikëputjes së pagës minimale me pensionet e këtyre kategorive shoqërore, është fakti se Ligji nr. 04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti (përfituesit e pensionit bazik të moshës, pensionit kontributpagues të moshës, pensionit të aftësisë së kufizuar, pensionet e parakohshme, pensionit invalidor të punës dhe pensionit familjar), nuk e ndërlidh pagën minimale me lartësinë e shumës së pensionit për këto kategori. Ligji i lartcekur përcakton se *“varësisht nga mundësitë buxhetore, kostoja e jetës dhe inflacioni eventual, Qeveria e Kosovës me propozimin e Ministrisë së Financave, me vendim të veçantë, do të vendosë për lartësinë e shumës së pensioneve të përcaktuara me këtë ligj”*. Pikërisht nëpërmjet Ligjit të kontestuar të gjitha kategoritë shoqërore trajtohen në mënyrë të barabartë, duke marrë parasysh veçoritë specifike të secilit grup. Përcaktimi i pagës minimale si kriter për vendosjen e beneficioneve do të krijonte pritshmërinë që secili grup i cili përfiton nga skemat sociale dhe pensionale të financuara nga Shteti, do të duhej të merrnin përfitime sa paga minimale, gjë që shkon përtej qëllimit të pagës minimale dhe rrezikon stabilitetin makro-ekonomik të vendit. Ata theksojnë se qëllimi i ligjvënësit është që përmes Ligjit të kontestuar paga minimale të jetë instrument i rregullimit të tregut të punës dhe mbrojtje sociale të punëtorëve, ndërsa, *“caktimi i “të ardhurave minimale” që ofrohen përmes buxhetit të Shtetit duhet të dizajnohen në mënyrë që të mos ndikojnë në stimujt e punës dhe as të krijojë kurthe varfërie”*.
87. Më tej dhe ndërlidhur me *“pritshmëritë legjitime”*, grupi parlamentar i LVV-së thekson se Ligji i kontestuar nuk e cenon të drejtën për pension për këto grupe shoqërore, dhe kjo e drejtë do të vazhdojë të aplikohet edhe më tutje. Sipas tyre, nuk mund të krijohet pritshmëria legjitime duke besuar që pensioni do të jetë gjithmonë sa paga minimale. Ata i referohen rastit të GJEDNJ-së [Sukhanov dhe Ilchenko kundër Ukrainës](#), sipas së cilëve kjo e fundit kishte theksuar se sa i përket masës së pensionit, nuk mund të

konsiderohet që pretendimet e kërkuarve për shtesë pensioni në masë 30 përqind të pensionit minimal përbënin “*pritshtëri legjitime*” (shih, GJEDNJ, [Sukhanov dhe Ilchenko kundër Ukrainës](#), cituar më lart, paragrafi 36).

88. Grupi parlamentar i LVV-së thekson se sipas praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, doktrina e pritshtërive legjitime vlerësohet brenda një konteksti nëse pritshtë legjitime mbështeten në një akt juridik të pushtetit, i justifikuar në kuptimin që ai mund të supozojë se ligji ose norma nuk do të ndryshohet më pas. Sipas tyre, praktika e GJEDNJ-së thekson se nuk mund të garantohet që ligjvënësi nuk mund ta ndryshojë ligjin, veçanërisht nëse një ndryshim i tillë është proporcional.
89. Specifikisht, grupi parlamentar i LVV-së thekson se “*përmes, nenit 5 të Ligjit Nr. 05/L-141 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-261 për Veteranët e Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, neni 18 i Ligjit bazik ishte fshirë, që përcaktonte lartësinë e beneficionit në nivel të pagës minimale. Rrjedhimisht, në një situatë të tillë ka ekzistuar një vakum ligjor për mënyrën e përcaktimit të lartësisë së shumës së beneficioneve të përcaktuara me Ligjin Nr. 04/L-261*”. Në këtë situatë, sipas Grupit parlamentar të LVV-së “*ligjvënësi ka konsideruar që është e nevojshme që të plotësohet dhe ndryshohet neni 16A, paragrafi 3, nënparagrafi 3.1 i Ligjit Nr. 04/L-261, ku përpos qëllimit legjitim për përcaktimin e lartësisë së shumës së beneficionit ndryshe nga siç kishte qenë më parë, është sqaruar edhe mënyra e rregullimit të lartësisë së shumës së beneficioneve përkatëse. Prandaj, në analogji edhe me praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së nuk mund të thuhet se ka ekzistuar ndonjë “pritshtëri legjitime” kur ka një mosmarrëveshje në lidhje me interpretimin dhe zbatimin e saktë të ligjit të brendshëm*”. Grupi parlamentar i LVV-së i referohet rastit [Kopecký kundër Sllovakisë](#), cituar më lart, paragrafi 50; dhe [Anheuser-Busch Inc. kundër Portugalisë](#), cituar më lart, paragrafi 65.
90. Tutje, grupi parlamentar i LVV-së, konsideron se përveç veteranëve, edhe në aspektin e personave të verbër dhe personave paraplegjik dhe tetraplegjik, nga praktika gjyqësore e GJEDNJ-së “*mund të konkludohet se doktrina e pritshtëve legjitime vlerësohet brenda një konteksti nëse pritshtë legjitime mbështeten në një akt juridik të pushtetit (baza e pritshtëve legjitime) i justifikuar në kuptimin që ai mund të supozojë se ligji ose norma nuk do të ndryshohet më pas (shih, mutatis mutandis, GJEDNJ [Pine Valley Developments Ltd dhe të tjerët kundër Irlandës](#), cituar më lart)*”. Rrjedhimisht, Grupi parlamentar i LVV-së thekson se “*sipas praktikës së GJEDNJ-së nuk garantohet që ligjvënësi nuk mund ta ndryshojë ligjin, veçanërisht nëse një ndryshim i tillë është proporcional (shih, mutatis mutandis, GJEDNJ, X kundër Gjermanisë, kërkesa nr. 8410/78, Vendim për pranueshmëri, i 13 dhjetorit 1979)*”.
91. Përfundimisht, Grupi parlamentar i LVV-së thekson se “*ndërlidhja e pagës minimale me beneficionet përkatëse në lidhje me veteranët, personat e verbër, personat paraplegjikë dhe tetraplegjikë të cilat janë paguar nga buxheti i Shtetit dhe të cilat nuk janë subjekt i periudhave të caktuara të kontributit financiar, do të rrezikonte në term afatshkurtër dhe afatgjatë qëndrueshmërinë makro-financiare apo anasjelltas do të pamundësonte rritjen e pagës minimale*”.
92. Në fund, dhe ndërlidhur me pretendimet për “*caktimin e pagës minimale*”, grupi parlamentar i LVV-së thekson se parashtruesit e kërkesës kanë dështuar të argumentojnë “*pretendimin se përcaktimi i pagës minimale ka cenuar Kushtetutën e Republikës së Kosovës*”, një çështje e tillë ka të bëjë me kategori kushtetuese. Pavarësisht kësaj, grupi parlamentar i LVV-së thekson se “*parashtruesit e kërkesës gabimisht pretendojnë se caktimi i pagës minimale sipas Ligjit të kontestuar nuk është në përputhje me Konventën për Pagën Minimale të ILO-s, dhe nuk saktësojnë nenin e Konventës që është cenuar*”.

93. Sipas grupit parlamentar të LVV-së, Ligji i kontestuar për caktimin e pagës minimale është në përputhje të plotë me Konventën e ILO-së për caktimin e pagës minimale. Specifikisht, grupi parlamentar i LVV-së thekson: “*e pikërisht duke bërë rregullimin e ri sipas ligjit të kontestuar arrihet përputhshmëri më e madhe e aplikimit indirekt të kësaj Konvente në legjislacionin tonë*”. Konventa në fjalë përcakton që “*autoriteti kompetent në çdo vend, me marrëveshje ose pas konsultimit të plotë me organizatat e përfaqësuesve të punëdhënësve dhe punëtorëve në fjalë, aty ku ekzistojnë, do të përcaktojë grupet e pagave që do të mbulohen*”. Sipas tyre, Konventa nuk kërkon të ketë një propozim konkret nga ndonjë institucion i ngjashëm me Këshillin Ekonomiko-Social, por ofron dy opsione, atë të marrëveshjes dhe atë të konsultimit të plotë. Sipas Ligjit të kontestuar, Ministria e Financave mund të propozojë caktimin e pagës minimale, vetëm pas konsultimit të plotë me Këshillin Ekonomik-Social dhe në mungesë të një propozimi konkret të tyre.

Dispozitat relevante kushtetuese dhe ligjore

94. Në vijim, Gjykata do të paraqes: (I) Dispozitat relevante të Kushtetutës së Republikës së Kosovës; (II) Dispozitat relevante të KEDNJ-së dhe protokollet e aplikueshme në rastin konkret, përfshirë dokumentet dhe instrumentet tjera relevante ndërkombëtare; (III) Dispozitat relevante të ligjeve të aplikueshme të Republikës së Kosovës; dhe (IV) Dispozitat kontestuese të Ligjit të kontestuar.

I. DISPOZITAT RELEVANTE KUSHTETUESE

KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Neni 7 [Vlerat]

1. Rendi kushtetues i Republikës së Kosovës bazohet në parimet e lirisë, paqes, demokracisë, barazisë, respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut dhe sundimit të ligjit, mosdiskriminimit, të drejtës së pronës, mbrojtjes e mjedisit, drejtësisë sociale, pluralizmit, ndarjes së pushtetit shtetëror dhe ekonomisë së tregut.

[...]

Neni 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare]

Të drejtat dhe liritë e njeriut të garantuara me marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare në vijim, garantohen me këtë Kushtetutë, zbatohen drejtpërdrejtë në Republikën e Kosovës dhe kanë prioritet, në rast konflikti, ndaj dispozitave e ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike:

- (1) Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut;*
- (2) Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj;*
- (3) Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile e Politike dhe Protokollet e saj;*
- (4) Konventa Kornizë e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare;*
- (5) Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racor;*
- (6) Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas;*
- (7) Konventa për të Drejtat e Fëmijës;*
- (8) Konventa kundër Torturës dhe Trajtimeve e Ndëshkimeve të tjera Mizore, Jonjerëzore dhe Poshtëruese.*

Neni 24
[Barazia para Ligjit]

1. Të gjithë janë të barabartë para ligjit. Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim.
2. Askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal.
3. Parimet e mbrojtjes së barabartë ligjore nuk parandalojnë vënien e masave të nevojshme për mbrojtjen dhe përparimin e të drejtave të individëve dhe grupeve që janë në pozitë të pabarabartë. Masat e tilla do të zbatohen vetëm derisa të arrihet qëllimi për të cilin janë vënë ato.

Neni 46
[Mbrojtja e Pronës]

1. E drejta e pronës është e garantuar.
2. Shfrytëzimi i pronës rregullohet me ligj, në pajtim me interesin publik.
[...]

Neni 51
[Mbrojtja Shëndetësore dhe Sociale]

1. Kujdesi shëndetësor dhe sigurimi social rregullohen me ligj.
2. Sigurimi social themelor, që ka të bëjë me papunësinë, sëmundjen, aftësitë e kufizuara dhe moshën e shtyrë, rregullohet me ligj.

Neni 53
[Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut]

Të drejtat njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Neni 55
[Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore]

- “1. Të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, mund të kufizohen vetëm me ligj.
2. Të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, mund të kufizohen vetëm deri në atë masë sa është e domosdoshme që, në një shoqëri të hapur dhe demokratike, të përmbushet qëllimi për të cilin lejohet kufizimi.
3. Kufizimet e të drejtave dhe lirive themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, nuk mund të bëhen për qëllime të tjera, përveç atyre për të cilat janë përcaktuar.
4. Me rastin e kufizimit të të drejtave të njeriut dhe interpretimit të atyre kufizimeve, të gjitha institucionet e pushtetit publik, dhe sidomos gjykatat, e kanë për detyrë t'i kushtojnë kujdes esencës së të drejtës që kufizohet, rëndësisë së qëllimit të kufizimit, natyrës dhe vëllimit të kufizimit, raportit midis kufizimit dhe qëllimit që synohet të arrihet, si dhe të shqyrtojnë mundësinë e realizimit të atij qëllimi me kufizim më të vogël.
5. Kufizimi i të drejtave dhe lirive të garantuara me këtë Kushtetutë, nuk bën të mohojë kurrësesi esencën e së drejtës së garantuar”.

Neni 65

[Kompetencat e Kuvendit]

Kuvendi i Republikës së Kosovës:

(1) miraton ligje, rezoluta dhe akte të tjera të përgjithshme

[...]

Neni 93

[Kompetencat e Qeverisë]

Qeveria ka këto kompetenca:

(1) propozon dhe zbaton politikën e brendshme dhe të jashtme të vendit;

(2) mundëson zhvillimin ekonomik të vendit;

(3) propozon Kuvendit projektligje dhe akte të tjera;

[...]

Neni 94

[Kompetencat e Kryeministrit]

[...]

(3) siguron zbatimin e ligjeve dhe të politikave të përcaktuara të Qeverisë;

II. KONVENTA EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

Neni 14

[Ndalimi i diskriminimit]

Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër.

Protokolli Nr. 1 i Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe të Lirive Themelore

Neni 1

[Mbrojtja e pronës]

Çdo person fizik ose juridik ka të drejtën e gëzimit paqësor të pasurisë së tij. Askush nuk mund të privohet nga prona e tij, përveçse për arsye të interesit publik dhe në kushtet e parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare.

[...]

Protokolli Nr.12 i Konventës për mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe të Lirive Themelore

Neni 1

[Ndalimi i përgjithshëm i diskriminimit]

1. Gëzimi i çdo të drejte të parashikuar me ligj duhet të sigurohet pa asnjë diskriminim të bazuar në shkaqe të tilla si gjinia, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo situatë tjetër.

2. Askush nuk duhet të diskriminohet nga një autoritet publik për ndonjë nga arsyet e parashikuara në paragrafin 1.

III. DISPOZITAT RELEVANTE TË LIGJEVE TË APLIKUESHME

LIGJI NR. 04/L -261 PËR VETERANËT E LUFTËS SË USHTRISË ÇLIRIMTARE TË KOSOVËS (publikuar në Gazetën zyrtare, më 23 prill 2014)

Neni 16 (Pensioni personal i veteranit luftëtar)

1. *Veterani Luftëtar i UÇK-së realizon Pensionin personal të veteranit luftëtar sipas kushteve të përcaktuara në këtë ligj.*
2. *Veterani Luftëtar i UÇK-së nuk mund të jetë shfrytëzues i asnjë pensioni nga skemat e tjera pensionale të financuara nga shteti. Nëse Veterani luftëtar është shfrytëzues i ndonjë skeme personale të financuar nga shteti në Republikën e Kosovës duhet të përcaktohet se cilin pension do të marrë.
[...]*
4. *Veteranët e UÇK-së të cilët janë të punësuar në sektorin publik dhe privat nuk kanë të drejtë të përfitimit të pensionit.*

Neni 17 (Shtesa në Pensionin e pleqërisë)

Veterani Luftëtar i UÇK-së i punësuar në sektorin publik dhe privat pas arritjes së moshës ligjore të pensionimit ka të drejtë në shtesë të pensionit për barazim me pensionin e veteranit luftëtar.

Neni 18 (Lartësia e shumës së pensioneve)

Varësisht nga mundësitë buxhetore, kostoja e jetesës dhe inflacioni eventual, në fund të çdo viti për vitin e ardhshëm, Qeveria e Kosovës me propozimin e Ministrisë së Financave me vendim të veçantë, mund të vendosë për lartësinë e shumës së pensionit të Veteranit Luftëtar të UÇK-së, e cila nuk mund të jetë më e vogël se paga minimale e përcaktuar në Kosovë.

LIGJI Nr. 05/L -141 PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT Nr. 04/L -261 PËR VETERANËT E LUFTËS SË USHTRISË ÇLIRIMTARE TË KOSOVËS (publikuar në Gazetën zyrtare më 14 prill 2017)

Neni 16 A

- [...]
2. *Buxheti i përgjithshëm, për realizimin e pagesës së pensionit të Veteranit Luftëtar të UÇK-së, shfrytëzohet tërësisht gjatë vitit për këtë destinim dhe nuk mund të tejkalojë 0.7% të Bruto Prodhimit Vendor në vit.*
3. *Skema e përcaktuar në paragrafin 2 të këtij neni, zbatohet pas kategorizimit përfundimtar.*
 - 3.1. *Deri në kategorizimin përfundimtar të listës së Veteranit Luftëtar të UÇK-së, skema pensionale zbatohet siç është paraparë me ligjin bazik. (ndryshuar me nenin 2 të Ligjit të kontestuar)*

[...]

Neni 5

1. *Neni 18 i ligjit bazik, fshihet.*

LIGJI Nr. 04/L - 092 PËR PERSONAT E VERBËR (publikuar në Gazetën zyrtare, më 18 korrik 2012)

**Neni 7
(Të ardhurat dhe beneficionet)**

1. *Personat e verbër gëzojnë të gjitha të drejtat dhe beneficionet sipas ligjeve në fuqi.*
2. *Personat e verbër të përcaktuar me këtë ligj, marrin nga buxheti shtetëror kompensimin në një shkallë të caktuar bazuar në pagën minimale në Kosovë, por jo më pak se njëqind (100) euro në muaj dhe përcaktohet me akt nënligjor të nxjerrë nga Qeveria.*
(ndryshuar me nenin 3 të Ligjit të kontestuar)
[...]

LIGJI Nr. 05/L -067 PËR STATUSIN DHE TË DREJTAT E PERSONAVE PARAPLEGJIK DHE TETRAPLEGJIK (publikuar në Gazetën zyrtare, më 16 qershor 2016)

**Neni 7
(Kompensimi)**

1. *Përfituesit e këtij ligji, marrin nga buxheti shtetëror kompensimin në një shkallë të caktuar, bazuar në pagën minimale në Kosovë, dhe përcaktohet me akt nënligjor të nxjerrë nga Qeveria, sipas propozimit të MPMS.*
(ndryshuar me nenin 4 të Ligjit të kontestuar)
[...]

LIGJI Nr. 03/L-212 I PUNËS (publikuar në Gazetën zyrtare, më 1 dhjetor 2010)

**Neni 57
(Paga minimale)**

1. *Qeveria e Kosovës në fund të çdo viti kalenderik përcakton pagën minimale sipas propozimit të Këshillit Ekonomiko-Social.*
(ndryshuar me nenin 6 të Ligjit të kontestuar)
[...]

LIGJI Nr. 04/L-008 PËR KËSHILLIN EKONOMIKO-SOCIAL (publikuar në Gazetën zyrtare, më 10 korrik 2011)

**Neni 6
(Përbërja e Këshillit Ekonomiko-Social)**

1. *KES-i përbëhet prej pesëmbëdhjetë (15) anëtarëve, të cilët në këtë organ përfaqësojnë interesat e Organizatave të punësuarve, Organizatave të punëdhënësve dhe Qeverisë.*
2. *KES-i përbëhet nga:*
 - 2.1. *pesë (5) përfaqësues të cilët caktohen nga Organizatat e të punësuarve;*
 - 2.2. *pesë (5) përfaqësues të cilët caktohen nga Organizatat e punëdhënësve; dhe*
 - 2.3. *pesë (5) përfaqësues të cilët caktohen nga Qeveria e Kosovës.*

**Neni 8
(Funksionet e KES-it)**

Funksionet e Këshillit Ekonomiko-Social janë:

1.1. krijimi dhe udhëzimi i institucioneve të Republikës së Kosovës, në krijimin dhe realizimin e politikave të punës, mirëqenies sociale dhe politikave ekonomike;

Neni 9 (Detyrat, përgjegjësitë dhe kompetencat e KES-it)

1. KES-i me qëllim të realizimit të suksesshëm të funksioneve të tij, është përgjegjës dhe kompetent, për:

*1.1. krijimin, zhvillimin dhe përparimin e dialogut social në Republikën e Kosovës;
[...]*

*1.5. politikat e nxitjes së punësimit, zbutjen e papunësisë, konkurrencën, produktivitetin e punës, çmimet, pagat dhe pagën minimale të të punësuarave në Republikën e Kosovës;
[...]*

IV. DISPOZITAT KONTESTUESE TË LIGJIT TË KONTESTUAR

LIGJI PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJEVE QË PËRCAKTOJNË SHUMËN E BENEFICIONIT NË LARTËSI TË PAGËS MINIMALE, PROCEDURAT E CAKTIMIT TË PAGËS MINIMALE DHE SHKALLËT TATIMORE NË TË ARDHURAT PERSONALE VJETORE

Neni 1 (Qëllimi)

1. Ky Ligj ka për qëllim të ndryshojë dhe plotësojë ligjet e përcaktuara në dispozitat e mëtejme të këtij Ligji, të cilat ndërlidhin shumën e beneficioneve apo kompensimeve me pagën minimale, të ndryshojë shkallët tatimore në të ardhurat personale vjetore, si dhe të ndryshojë procedurën e vendosjes së pagës minimale.

Neni 2

(Ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit Nr. 04/L-261 për Veteranët e Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 05/L-141)

Neni 16A, paragrafi 3 nënparagrafi 3.1 i Ligjit Nr. 04/L-261 për Veteranët e Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 05/L-141, ndryshohet me tekstin si në vijim:

3.1. Deri në kategorizimin përfundimtar të listës së Veteranit Luftëtar të UÇK-së, Qeveria e Republikës së Kosovës, me propozimin e Ministrisë përgjegjëse për financa, vendosë për lartësinë e shumës së pensioneve të përcaktuara me këtë ligj, varësisht nga mundësitë buxhetore, kostoja e jetesës dhe inflacioni eventual.

Neni 3

(Ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit Nr. 04/L - 092 për Personat e Verbër)

1. Neni 7, paragrafi 2 i Ligjit Nr. 04/L - 092 për Personat e Verbër, ndryshohet me tekstin si në vijim:

2. Qeveria e Republikës së Kosovës, me propozimin e Ministrisë përgjegjëse për financa, vendosë për lartësinë e shumës së kompensimeve për personat e verbër të përcaktuar me këtë ligj, varësisht nga mundësitë buxhetore, kostoja e jetesës dhe inflacioni eventual.

Neni 4
(Ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit Nr. 05/L - 067 për Statusin dhe të Drejtat e Personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik)

1. Neni 7, paragrafi 1 i Ligjit Nr. 05/L -067 për Statusin dhe të Drejtat e Personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik, ndryshohet me tekstin si në vijim:

1. Qeveria e Republikës së Kosovës, me propozimin e Ministrisë përgjegjëse për Financa, vendosë për lartësinë e shumës së kompensimeve për përfituesit e këtij ligji, varësisht nga mundësitë buxhetore, kostoja e jetesës dhe inflacioni eventual.

Neni 6
(Ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës)

Neni 57, paragrafi 1, i Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës, ndryshohet si në vijim:

Neni 57
Paga Minimale

1. Qeveria e Republikës së Kosovës në fund të çdo viti kalendarik përcakton pagën minimale sipas propozimit të Këshilli Ekonomiko-Social. Në mungesë të një propozimi të tillë nga Këshilli Ekonomiko Social, Ministri përkatës për Financa, pas informimit të Këshillit Ekonomiko Social, mund të parashtrojë një propozim të tillë për Qeverinë e Republikës së Kosovës.

Pranueshmëria e kërkesës

95. Gjykata duhet së pari të vlerësojë nëse kërkesat e parashtruara para Gjykatës i kanë përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuar më tej me Ligj dhe Rregullore të punës.
96. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafit 1 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, që përcakton:

Neni 113
[Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara]

1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para Gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

97. Gjykata vëren se parashtruesit e kërkesës e kanë paraqitur kërkesën e tyre në bazë të paragrafit 5 të nenit 113 të Kushtetutës, i cili përcakton:

[...]

5. Dhjetë (10) a më shumë deputetë të Kuvendit të Kosovës, brenda një afati prej tetë (8) ditësh nga dita e miratimit, kanë të drejtë të kontestojnë kushtetutshmërinë e çfarëdo ligji ose vendimi të miratuar nga Kuvendi, si për përmbajtjen, ashtu edhe për procedurën e ndjekur.

[...]

98. Gjykata, në vlerësimin e përmbushjes së numrit të nevojshëm të deputetëve të Kuvendit për të parashtruar kërkesë në bazë të kësaj dispozite përkatëse, vëren se kërkesa është parashtruar nga dhjetë (10) deputetë, numër ky mjaftueshëm për përmbushjen e kriterit të përcaktuar nëpërmjet fjalisë së parë të paragrafit 5 të nenit 113 të Kushtetutës për të vënë në lëvizje Gjykatën. Rrjedhimisht, ky kriter është përmbushur.

99. Gjykata po ashtu duhet të vlerësojë nëse dhjetë (10) a më shumë deputetë të Kuvendit, legjitimohen se janë “*palë e autorizuar*” në kuptim të fjalisë së dytë të paragrafit 5 të nenit 113 të Kushtetutës, për të kontestuar kushtetutshmërinë e çfarëdo ligji ose akti të miratuar nga Kuvendi, si për nga përmbajtja, ashtu dhe procedura e ndjekur. Në rastin konkret, parashtruesit e kërkesës legjitimohen se janë palë e autorizuar, për faktin se të njëjtit kontestojnë kushtetutshmërinë e Ligjit nr. 08/L-142 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjeve që Përcaktojnë Shumën e Beneficionit në lartësi të Pagës Minimale dhe Shkallët Tatimore në të ardhurat Personale Vjetore, të miratuar me Vendimin [nr. 08-V-589] të 13 korrikut 2023 të Kuvendit.
100. Ndërsa sa i përket afatit kohor brenda të cilit duhet të parashtrohet kërkesa përkatëse në Gjykatë, kjo e fundit vëren se kërkesa është dorëzuar nga parashtruesit e kërkesës më 21 korrik 2023, ndërkohë që Ligji i kontestuar është miratuar nga Kuvendi më 13 korrik 2023, që nënkupton se kërkesa është dorëzuar në Gjykatë brenda afatit të përcaktuar me paragrafin 5 të nenit 113 të Kushtetutës.
101. Përveç kriterëve kushtetuese të lartcekura, Gjykata gjithashtu merr parasysh edhe nenin 42 (Saktësimi i kërkesës) dhe 43 (Afatet) të Ligjit, që saktësojnë dhe përcaktojnë kushtet të mëtejme për parashtrimin e kërkesës, në bazë të paragrafit 5 të nenit 113 të Kushtetutës, që përcaktojnë si në vijim:

**Neni 42
(Saktësimi i kërkesës)**

1. Në kërkesën e ngritur në pajtim me nenin 113, paragrafi 6 të Kushtetutës, ndër të tjera, paraqiten informatat e mëposhtme:

- 1.1. emrat dhe nënshkrimet e të gjithë deputetëve të Kuvendit që kontestojnë kushtetutshmërinë e ligjit apo vendimit të nxjerrë nga ana e Kuvendit të Republikës së Kosovës;*
- 1.2. dispozitat e Kushtetutës apo të ndonjë akti apo ligji që ka të bëjë me këtë kërkesë; dhe*
- 1.3. paraqitjen e provave mbi të cila mbështetet kontesti.*

**Neni 43
(Afati)**

1. Një ligj apo vendim i miratuar nga ana e Kuvendit të Republikës së Kosovës i dërgohet Presidentit të Republikës së Kosovës për shpallje pas mbarimit të afatit të përcaktuar në pajtim me nenin 113, paragrafi 5 i Kushtetutës.

102. Gjykata, gjithashtu, i referohet dhe rregullit 72 [Kërkesa në pajtim me paragrafin 5 të nenit 113 të Kushtetutës dhe me nenet 42 dhe 43 të Ligjit] të Rregullores së punës, i cili parasheh:

**Rregulli 72
(Kërkesa në pajtim me paragrafin 5 të nenit 113 të Kushtetutës dhe me nenet 42 dhe 43 të Ligjit)**

(1) Kërkesa e parashtruar sipas këtij rregulli duhet të përmbushë kriteret e përcaktuara me paragrafin (5) të nenit 113 të Kushtetutës dhe me nenet 42 (Saktësimi i kërkesës) dhe 43 (Afati) të Ligjit.

(2) Kërkesa e parashtruar sipas këtij rregulli ka efekt suspensiv.

(3) Kërkesa e parashtruar sipas këtij rregulli, ndër të tjera, duhet të përmbajë informatat e mëposhtme:

(a) emrat dhe nënshkrimet e të gjithë deputetëve të Kuvendit që kontestojnë kushtetutshmërinë e ligjit apo vendimit të nxjerrë nga ana e Kuvendit të Republikës së Kosovës;

(b) dispozitat e Kushtetutës apo të ndonjë akti apo ligji që ka të bëjë me këtë kërkesë; dhe

(c) paraqitjen e provave mbi të cilat mbështetet kontesti.

(4) Kërkesës duhet t'i bashkëngjitet një kopje e ligjit ose vendimit të kontestuar të miratuar nga Kuvendi, regjistri dhe nënshkrimet personale të deputetëve që paraqesin kërkesën, si dhe autorizimi i personit që i përfaqëson ata para Gjykatës.

(5) Gjykata menjëherë pas regjistrimit të një kërkesë të parashtruar në pajtim me paragrafin 5 të nenit 113 të Kushtetutës, e njofton Kuvendin e Republikës së Kosovës për regjistrimin e kërkesës.

(6) Në rast se kontestohet një ligj ose një vendim i Kuvendit që kërkon dekretimin nga Presidenti/ja, Gjykata menjëherë pas regjistrimit të kërkesës së parashtruar, në pajtim me paragrafin (5) të nenit 113 të Kushtetutës dhe nenet 42 (Efekti Suspensiv) dhe 43 (Afatet) të Ligjit e njofton Presidentin/en dhe Kuvendin për efektin suspensiv të kërkesës ndaj hyrjes në fuqi të ligjit ose vendimit që kontestohet, derisa Gjykata të nxjerrë vendim përfundimtar lidhur me çështjen para saj”.

(7) Kërkesa sipas këtij rregulli duhet të parashtrohet brenda tetë (8) ditësh nga data e miratimit të ligjit apo të vendimit të kontestuar.

103. Në kontekst të dispozitave të Ligjit të kontestuar, Gjykata vëren se parashtruesit e kërkesës (i) shënuan emrat dhe nënshkrimet e tyre në kërkesën e tyre përkatëse; (ii) specifikuan Ligjin e kontestuar të Kuvendit të 13 korrikut 2023; (iii) iu referuan neneve specifike të Kushtetutës, me të cilat ata pretendojnë se dispozitat e Ligjit të kontestuar nuk janë në përputhshmëri; dhe (iv) dorëzuan argumentet në mbështetje të pretendimeve të tyre, si dhe (v) kërkesën e dorëzuan brenda afati prej tetë (8) ditësh, ashtu siç përcakton paragrafi 5 i nenit 113 të Kushtetutës dhe nënregulli (7) i rregullit 72 të Rregullores së punës.
104. Rrjedhimisht, marrë parasysh plotësimin e kriterëve kushtetuese dhe ligjore përkitazi me pranueshmërinë e kërkesës, Gjykata deklaron kërkesën e parashtruesve të kërkesës të pranueshme dhe në vijim, do të shqyrtojë meritat e saj.

Meritat e kërkesës

I. HYRJE

105. Gjykata fillimisht rikujton që parashtruesit e kërkesës, kontestojnë kushtetutshmërinë e Ligjit nr. 08/L-142 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që përcaktojnë shumën e beneficionit në lartësi të pagës minimale, procedurat e caktimit të pagës minimale dhe shkallët tatimore në të ardhurat personale vjetore, duke pretenduar që i njëjti nuk është në përputhshmëri me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, përkatësisht me nenet 7 [Vlerat], 24 [Barazia para Ligjit], 46 [Mbrojtja e Pronës] dhe 51 [Mbrojtja shëndetësore dhe sociale] të saj.
106. Siç është sqaruar detajisht në pjesën e këtij Aktgjykimi që ndërlidhet me pretendimet dhe kundërgargumentet përkatëse, parashtruesit e kërkesës para Gjykatës specifikisht kontestojnë kushtetutshmërinë e neneve 2, 3, 4 dhe 6 të Ligjit të kontestuar, duke pretenduar që të njëjtat, rezultojnë në cenimin e (i) barazisë para ligjit; dhe (ii) të drejtave pronësore të veteranëve të UÇK-së, personave të verbër dhe personave paraplegjik dhe tetraplegjik, në esencë, sepse, si rezultat i eliminimit të garancive ligjore që pensionet dhe kompensimet përkatëse të kategorive të lartcekura, të jenë të paktën në nivelin e pagës minimale në Republikën e Kosovës, të njëjtët nuk janë trajtuar në

mënyrë të barabartë dhe rrjedhimisht janë diskriminuar, për më tepër që janë cenuar të drejtat e tyre në pronë, dhe (iii) mënyra e përcaktimit të pagës minimale rezulton në cenimin e barazisë dhe mbrojtjes sociale. Avokati i Popullit, në esencë, mbështet argumentet e parashtruesve të kërkesës, ndërsa të njëjtat kundërshtohen nga Ministria e Financave dhe grupi parlamentar i LVV-së.

107. Në kontekstin e lartcekur, Gjykata fillimisht vëren që bazuar në nenin 1 (Qëllimi) të Ligjit të kontestuar, qëllimi i këtij ligji është që: (i) të ndryshojë dhe plotësojë ligjet e përcaktuara në nenet 2, 3 dhe 4 të tij, të cilat ndërlidhin shumën e pensionit dhe kompensimeve me pagën minimale për (a) Veteranët e Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës; (b) personat e verbër; dhe (c) personat paraplegjik dhe tetraplegjik; (ii) të ndryshohen shkallët tatimore në të ardhurat personale vjetore; dhe (iii) të ndryshojë procedurën e vendosjes së pagës minimale. Specifikisht dhe në rrethanat e rastit konkret, Gjykata vëren se dispozita specifike të Ligjit të kontestuar ndryshojnë dhe plotësojnë (i) Ligjin nr. 04/L-261 për Veteranët e Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 05/L-141; (ii) Ligjin nr. 04/L - 092 për Personat e Verbër; (iii) Ligjin nr. 05/L - 067 për Statusin dhe të Drejtat e Personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik; dhe (iv) Ligjin nr. 03/L-212 të Punës.
108. Ndryshimi dhe plotësimi i ligjeve të lartcekura përmes Ligjit të kontestuar, ndërlidhet me mënyrën e përcaktimit të lartësisë së kompensimit të kategorive të lartcekura, përkatësisht (i) veteranëve të UÇK-së; (ii) personave të verbër; dhe (iii) personave paraplegjik dhe tetraplegjik, kategori të cilat bazuar në ligjet e aplikueshme, gëzojnë të drejta dhe beneficione të caktuara që garantohen dhe/ose kompensohen nga buxheti i Republikës së Kosovës.
109. Para vlerësimit të kushtetutshmërisë së dispozitave të Ligjit të kontestuar, Gjykata fillimisht potencon kompetencën kryesore kushtetuese të Kuvendit për ligjvënien në nivel vendi. Kuvendi, si pushtet legjislativ, *“përveç Kushtetutës dhe detyrimit për të ushtruar pushtetin legjislativ në pajtim me Kushtetutën, [...] nuk i nënshtrohet asnjë pushteti tjetër”* (shih, ndër të tjera, rastin e Gjykatës [KO72/20](#), parashtrues *Rexhep Selimi dhe 29 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës*, Aktgjykimi i 28 majit 2022, paragrafi 352). Në kontekst të rrethanave të rastit konkret, është rrjedhimisht i padiskutueshëm autorizimi i Kuvendit që në ushtrim të kompetencës së tij, bazuar në paragrafin 1 të nenit 65 [Kompetencat e Kuvendit] të Kushtetutës për *“miratim të ligjeve”*, të rregullojë çështjen e beneficioneve dhe kompensimeve për kategoritë e lartcekura sipas një politike të caktuar të zgjedhur nga vet Kuvendi. Ky i fundit ka autorizim të plotë që të zgjedhë modalitetin më të mirë dhe më të përshtatshëm që konsideron se në aspekt të politikave publike i përshtatet sistemit të pagave për Republikën e Kosovës. Të vetmin kufizim që Kuvendi e ka në ligjvënien është që të respektojë procedurat e ligjbërjes dhe të votojë ligje që janë në përputhshmëri me Kushtetutën dhe vlerat e parimet e proklamuar aty.
110. Gjykata gjithashtu thekson që është e qartë që bazuar në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, Gjykata Kushtetuese nuk vepron *ex officio* në kontrollim të kushtetutshmërisë së ligjeve. Kushtetutshmëria e të gjitha ligjeve në fuqi në Republikën e Kosovës prezumohet si e tillë përderisa e njëjta nuk kontestohet pranë Gjykatës Kushtetuese nga palët e autorizuara. Kuvendi konsiderohet të ketë nxjerrë një ligj kushtetues deri në momentin që një ligj i tillë ose një pjesë e ligjit të mos vlerësohet si kundërkushtetues nga Gjykata. Kjo e fundit, gjithashtu potencon faktin se në të gjitha rastet kur një Ligj i Kuvendit kontestohet para Gjykatës nga palët e autorizuara, fokusi i vlerësimit është gjithmonë respektimi i normave kushtetuese dhe të drejtave dhe lirive të njeriut – e asnjëherë vlerësimi i përzgjedhjes së politikës publike që ka dërguar deri tek miratimi i një Ligji të caktuar. Gjykata veçse ka theksuar në praktikën e saj gjyqësore që në shqyrtim të kushtetutshmërisë së një ligji, ajo asnjëherë nuk vlerëson se a është një ligj

i bazuar në politika të mira publike apo jo, por nëse i njëjti është në përputhje me dispozitat kushtetuese (shih, rastet e Gjykatës [KO73/16](#), parashtrues *Avokati i Popullit*, Aktgjykim i 16 nëntorit 2016, paragrafi 52; rastin [KO72/20](#), cituar më lart, paragrafi 357; [KO12/18](#), parashtrues *Albulena Haxhiu dhe 30 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës*, Aktgjykimi i 29 majit 2018, paragrafi 117; [KO219/19](#), cituar më lart, paragrafi 259; dhe [KO216/22_KO220/22](#), parashtrues: për kërkesën *KO216/22 - Isak Shabani dhe 10 (dhjetë) deputetë të tjerë, dhe për KO220/22 - Arben Gashi dhe 9 (nëntë) deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës*, Aktgjykimi i 2 gushtit 2023, paragrafi 312).

111. Me sqarimet e mësipërme në pah, Gjykata thekson që fushëveprimi i kësaj kërkesë dhe respektivisht çështja kushtetuese që ngërthen ky Aktgjykim është përputhshmëria me Kushtetutën e dispozitave të Ligjit të kontestuar, përkatësisht vlerësimi nëse ky i fundit cenon parimin e barazisë para ligjit dhe të drejtën në pronë të garantuar me nenet 7, 24 dhe 46 të Kushtetutës, si dhe barazinë dhe mbrojtjen sociale bazuar në nenin 51 të Kushtetutës.
112. Me qëllim të vlerësimit të kushtetutshmërisë së Ligjit të kontestuar, Gjykata fillimisht do të paraqesë: (I) fushëveprimin e Ligjit të kontestuar; dhe (II) do t' ia nënshtrojë vlerësimit të saj dispozitat e kontestuara të Ligjit të kontestuar, duke aplikuar përgjatë këtij vlerësimit, ndër të tjera, parimet relevante kushtetuese dhe ato që burojnë nga praktika gjyqësore e GJEDNJ-së dhe e Gjykatës, ndërlidhur me barazinë para ligjit dhe të drejtën në pronë.

II. Fushëveprimi i Ligjit të kontestuar

113. Gjykata rikujton që nenet 2, 3 dhe 4 të Ligjit të kontestuar, ndryshojnë dhe plotësojnë (i) Ligjin nr. 04/L-261 për Veteranët e Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 05/L-141; (ii) Ligjin nr. 04/L - 092 për Personat e Verbër; dhe (iii) Ligjin nr. 05/L - 067 për Statusin dhe të Drejtat e Personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik. Dispozitat e ndryshuara dhe/ose plotësuara të ligjeve të lartcekura, ndërlidhen me mënyrën e përcaktimit në lartësinë e shumës së pensioneve dhe kompensimeve për kategorinë e (i) veteranëve të UÇK-së; (ii) personave të verbër; dhe (iii) personave paraplegjik dhe tetraplegjik. Gjithashtu, Gjykata rikujton që neni 6 i Ligjit të kontestuar, ndryshon dhe plotëson Ligjin nr. 03/L-212 të Punës, ndërlidhur me mënyrën e përcaktimit të nivelit të pagës minimale në Republikën e Kosovës. Neni 5 i Ligjit të kontestuar në anën tjetër, ndryshon dhe plotëson Ligjin nr. 05/L-028 për Tatimin në të Ardhurat Personale, por ky nen nuk është kontestuar para Gjykatës nga ana e parashtruesve të kërkesës.
114. Për qëllim të trajtimit të pretendimeve të parashtruesve të kërkesës, përfshirë komentet dhe përgjigjet e Avokatit të Popullit dhe palëve tjera, përfshirë Qeverinë, në vijim, Gjykata fillimisht do të shtjellojë, për aq sa është relevante në rrethanat e rastit konkret, (i) ligjet e aplikueshme, përfshirë ndryshimet ndër vite lidhur me kategoritë e lartcekura; dhe (ii) ndryshimet e tyre përmes Ligjit të kontestuar, duke filluar me (a) veteranët e UÇK-së; (b) personat e verbër; dhe (c) personat paraplegjik dhe tetraplegjik, dhe (iii) ndryshimin e mënyrës së përcaktimit të pagës minimale.

(a) Veteranët e UÇK-së

115. Gjykata, fillimisht rikujton që më 7 dhjetor të vitit 2000, kishte hyrë në fuqi Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2000/66 për beneficionet për invalidët e luftës dhe të afërmeve të atyre që kanë vdekur, si pasojë e konfliktit të armatosur në Kosovë. Për aq sa është relevante për rrethanat e rastit konkret, e njëjta, ndër të tjera, kishte përcaktuar benefitet për kategoritë e përfshira në fushëveprimin e saj, duke përfshirë por duke mos u kufizuar,

në (i) pagesa financiare për invalidët e luftës; (ii) shfrytëzimin pa pagesë të ndihmës mjekësore që sigurohet në qendrat qeveritare mjekësore dhe qendrat rehabilituese në Kosovë për invalidët e luftës dhe më të afërmit e tyre; (iii) lirim nga tatimi i shitjes, akcizave dhe taksës doganore mbi mjetet e përshtatura për paaftësinë specifike të invalidëve të luftës; dhe (iv) pagesat financiare për më të afërmit e atyre që kanë vdekur si pasojë e konfliktit të armatosur në Kosovë. Kjo Rregullore, në nenin 3 (Fondi i Veçantë) kishte përcaktuar si në vijim: *një fond i veçantë do të themelohet për sigurimin e ndihmave të veçanta për invalidët e luftës me të drejtë shfrytëzimi dhe për më të afërmit e atyre që kanë vdekur si pasojë e konfliktit të armatosur në Kosovë, duke përfshirë pagesa të kufizuara financiare nga burimet e ndara për këtë qëllim nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës dhe kontributet plotësuese përmes Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës.*

116. Më 23 shkurt 2006, Kuvendi i Kosovës, kishte miratuar Ligjin nr. 02/L-02 për Statusin dhe të Drejtat e Familjeve të Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve dhe Pjesëtarëve të UÇK-së dhe Familjeve të Viktimave Civile të Luftës. Përmes këtij ligji, i cili përfshinte edhe kategorinë e veteranëve të UÇK-së, ishin rregulluar dhe statusi i invalidëve, veteranëve dhe pjesëtarëve të UÇK-së, si dhe të drejtat dhe beneficionet e posaçme për familjarët e tyre. Ligji i lartcekur, ndër të tjera, përcaktonte (i) format e pensioneve në nenin 4 (Format e pensioneve) të tij; (ii) beneficionet e veçanta në nenin 5 (Beneficionet e Veçanta) të tij; (iii) bazën e pensionit invalidor dhe kategorizimin e invaliditetit në nenin 8 (Invalidët e UÇK-së sipas shkallës së invaliditetit) të tij, dhe sipas të cilit gjithashtu baza e pensionit invalidor personal është 140 % e pagës minimale të realizuar në Kosovë, në vitin paraprak; dhe (iv) të drejtat e veteranëve dhe pjesëtarëve të UÇK-së në nenin 10 (Të drejtat e veteranëve dhe pjesëtarëve të UÇK-së) të tij.
117. Ligji i lartcekur u shfuqizua në vitin 2011, përmes miratimit të Ligjit nr. 04/L-054 për Statusin dhe të Drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve, Pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Viktimave Civile dhe Familjeve të tyre. I njëjti, gjithashtu përcaktonte pensione dhe benefite edhe për kategorinë e invalidëve të UÇK-së. Ndërsa, ndërlidhur me kategorinë e veteranëve, ligji i lartcekur në nenin 12 (Statusi dhe të drejtat e veteranëve të UÇK-së) të tij, saktësonte që (i) sipas dispozitave të këtij ligji, nga organi përgjegjës i Qeverisë, njihet dhe përcaktohet statusi i veteranëve të UÇK-së; dhe (ii) të drejtat në beneficione për veteranët e UÇK-së si dhe kriteret e kualifikimit për njohjen dhe realizimin e tyre do të rregullohen me ligj të veçantë.
118. Gjykata më tej rikujton që Ligji nr. 04/L-261 për Veteranët e Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji për Veteranët i vitit 2014), ishte miratuar në vitin 2014. Ky ligj, për aq sa është relevante për rrethanat e rastit konkret, (i) kishte përcaktuar kategorizimin e veteranëve të UÇK-së sipas nenit 4 (Kategorizimi i veteranëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës) të tij; dhe (ii) të drejtat në beneficione për veteranët luftëtarë të UÇK-së, në Kreun IV të tij. Këto të fundit, përfshinin, (i) të drejtën në shërbime shëndetësore falas në nenin 23; (ii) të drejtën e përparësisë në punësim në nenin 24; (iii) të drejtën e udhëtimit në nenin 25; (iv) të drejtën në riaftësim profesional në nenin 26; (v) lehtësirat për veteranët luftëtarë të UÇK-së në nenin 27; (vi) të drejtën në stazhin e dyfishtë në nenin 28; (vii) përkujdesjen për banim në nenin 29; (viii) përparësinë e pranimit në institucionet arsimore publike në nenin 30; (ix) lirim nga pagesat administrative në shkollimin Universitar Publik në nenin 31; (x) vendosjen në shtëpitë e personave të moshuar në nenin 32; (xi) shpenzimet e varrimit në nenin 33; dhe (xii) pensionin për trashëgimtarët në nenin 20, sipas përcaktimeve të ligjit të lartcekur. Për më tepër, Gjykata po ashtu vë re se në bazë të nenit 17 (Shtesa në Pensionin e pleqërisë) është paraparë se Veterani Luftëtar i UÇK-së i punësuar në sektorin publik dhe privat pas arritjes së moshës ligjore të pensionimit ka të drejtë në shtesë të pensionit për barazim me pensionin e veteranit luftëtar.

119. Për aq sa është relevante për rrethanat e rastit konkret, nenet 16 (Pensioni personal i Veteranit Luftëtar) dhe 18 (Lartësia e shumës së pensioneve) të Ligjit për Veteranët të vitit 2014, përcaktojnë lartësinë dhe mënyrën e përcaktimit të pensionit. Më specifikisht, neni 16 i Ligjit të lartcekur, përcakton që (i) Veterani Luftëtar i UÇK-së realizon pensionin personal të Veteranit Luftëtar sipas kushteve të përcaktuara në këtë ligj; (ii) Veterani Luftëtar i UÇK-së nuk mund të jetë shfrytëzues i asnjë pensioni nga skemat e tjera pensionale të financuara nga shteti dhe nëse Veterani Luftëtar është shfrytëzues i ndonjë skeme personale të financuar nga shteti në Republikën e Kosovës duhet të përcaktohet se cilin pension do të marrë; dhe (iii) veteranët e UÇK-së të cilët janë të punësuar në sektorin publik dhe privat nuk kanë të drejtë të përfitimit të pensionit. Ndërsa, neni 18 i ligjit të lartcekur, saktëson që varësisht nga mundësitë buxhetore, kostoja e jetesës dhe inflacioni eventual, në fund të çdo viti për vitin e ardhshëm, Qeveria e Kosovës me propozimin e Ministrisë së Financave me vendim të veçantë, mund të vendosë për lartësinë e shumës së pensionit të Veteranit Luftëtar të UÇK-së, cila nuk mund të jetë më e vogël se paga minimale e përcaktuar në Kosovë.
120. Ligji i lartcekur u plotësua dhe ndryshua në vitin 2017, përmes Ligjit nr. 05/L -141 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 04/L-261 për Veteranët e Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji për Veteranët i vitit 2017). Ky ligj, riformuloi nenin 15 (Realizimi i të drejtës në pension dhe beneficione) të Ligjit të vitit 2014, si në vijim (i) Veterani Luftëtar i UÇK-së, përmes njohjes së të drejtës në pension dhe beneficione të ndryshme i sigurohet mbështetje financiare dhe benefite të caktuara për kontributin e dhënë në luftën e UÇK-së; (ii) Veterani Luftëtar i UÇK-së i cili gjatë luftës nuk ka vepruar në Kosovë, nuk gëzon të drejtën në pension; dhe (iii) përjashtim nga ky nen bën pjesë logjistika që ka vepruar në pika furnizimi në Shqipëri dhe vendet fqinje. Ndërsa, Ligji për Veteranët i vitit 2017, nenin 16 të Ligjit të vitit 2014, e plotësoi përmes nenit 16A, dhe përmes të cilit u bë kategorizimi i Veteranit Luftëtar të UÇK-së, si përfitues i pensionit dhe beneficioneve të tjera, në tri kategori, në përputhje me kohën e mobilizimit dhe shërbimit në UÇK, duke përcaktuar pensionin mujor (i) në dyqind e pesëdhjetë (250) euro për kategorinë e parë; (ii) njëqind e shtatëdhjetë (170) euro për kategorinë e dytë; dhe (iii) njëqind e njëzet (120) euro për kategorinë e tretë. Neni 16A gjithashtu përcaktoi që (i) buxheti i përgjithshëm, për realizimin e pagesës së pensionit të Veteranit Luftëtar të UÇK-së, shfrytëzohet tërësisht gjatë vitit për këtë destinim dhe nuk mund të tejkalojë 0.7% të Bruto Prodhimit Vendor në vit; dhe (ii) deri në kategorizimin përfundimtar të listës së Veteranit Luftëtar të UÇK-së, skema pensionale zbatohet siç është paraparë me ligjin bazik. Në fund, përmes Ligjit të vitit 2017, u eliminua neni 18 (Lartësia e shumës së pensioneve) i Ligjit për Veteranët të vitit 2014, sipas të cilit, varësisht nga mundësitë buxhetore, kostoja e jetesës dhe inflacioni eventual, në fund të çdo viti për vitin e ardhshëm, Qeveria e Kosovës me propozimin e Ministrisë së Financave me vendim të veçantë, mund të vendosë për lartësinë e shumës së pensionit të Veteranit Luftëtar të UÇK-së, e cila nuk mund të jetë më e vogël se paga minimale e përcaktuar në Kosovë.
121. Gjykata rikujton që Ligji i kontestuar, përmes nenit 2 të tij, ndryshon nenin 16A të Ligjit të Veteranëve të vitit 2017, përkatësisht zëvendëson paragrafin 3.1 të tij, me paragrafin 3.1 të nenit 2 të Ligjit të kontestuar, duke zëvendësuar formulimin (i) “*deri në kategorizimin përfundimtar të listës së Veteranit Luftëtar të UÇK-së, skema pensionale zbatohet siç është paraparë me ligjin bazik*” me (ii) “*deri në kategorizimin përfundimtar të listës së Veteranit Luftëtar të UÇK-së, Qeveria e Republikës së Kosovës, me propozimin e Ministrisë përgjegjëse për financa, vendosë për lartësinë e shumës së pensioneve të përcaktuara me këtë ligj, varësisht nga mundësitë buxhetore, kostoja e jetesës dhe inflacioni eventual*”.

(b) *Personat e verbër*

122. Gjykata rikujton që Ligji nr. 04/L-092 për Personat e Verbër (në tekstin e mëtejme: Ligji për Personat e Verbër) u miratua nga Kuvendi në vitin 2012. I njëjti rregullon statusin ligjor të personave të verbër në Republikën e Kosovës, si dhe të drejtat dhe përfitimet, si dhe përcakton kriteret për kategorizimin e personave të verbër. Për aq sa është relevante për rrethanat e rastit konkret, Ligji i lartcekur, gjithashtu përcakton të drejtat e tyre, duke përfshirë, por duke mos u kufizuar në ato që ndërlidhen me (i) punësimin në nenin 5; (ii) lirin nga taksat dhe tatimi në nenin 6 ; (iii) strehimin në nenin 8 ; (iv) kujdesin shëndetësor në nenin 9 ; (v) edukimin dhe arsimimin në nenin 10 ; (vi) qasjen në informacion në nenin 11 ; (vii) udhëtimin në nenin 13 ; dhe (viii) shpenzimet e energjisë elektrike dhe telefonit në nenin 14 , sipas përcaktimeve të ligjit të lartcekur. Neni 7 (Të ardhurat dhe beneficionet) i Ligjit për Personat e Verbër, gjithashtu përcakton të ardhurat dhe beneficionet, duke përfshirë, që (i) personat e verbër të përcaktuar me këtë ligj, marrin nga buxheti shtetëror kompensimin në një shkallë të caktuar bazuar në pagën minimale në Kosovë, por jo më pak se njëqind (100) euro në muaj dhe përcaktohet me akt nënligjor të nxjerrë nga Qeveria; dhe (ii) përfituesit material për shkak të verbërisë, sipas paragrafit 1., të këtij neni nuk mund të jenë shfrytëzues të asnjë kompensimi nga skemat e tjera pensionale të aplikueshme në Kosovë, përveç nëse ndryshe është përcaktuar me ligj.

123. Gjykata rikujton që Ligji i kontestuar përmes nenit 3 të tij, ndryshon paragrafin 2 të nenit 7 të Ligjit për Personat e Verbër, duke zëvendësuar të njëjtin me paragrafin 2 të nenit 3 të Ligjit të kontestuar, përkatësisht duke zëvendësuar formulimin (i) *“Personat e verbër të përcaktuar me këtë ligj, marrin nga buxheti shtetëror kompensimin në një shkallë të caktuar bazuar në pagën minimale në Kosovë, por jo më pak se njëqind (100) euro në muaj dhe përcaktohet me akt nënligjor të nxjerrë nga Qeveria”* me (i) *“Qeveria e Republikës së Kosovës, me propozimin e Ministrisë përgjegjëse për financa, vendosë për lartësinë e shumës së kompensimeve për personat e verbër të përcaktuar me këtë ligj, varësisht nga mundësitë buxhetore, kostoja e jetesës dhe inflacioni eventual”*.

(c) *Personat Paraplegjik dhe Tetraplegjik*

124. Gjykata rikujton që Ligji nr. 05/L-067 për Statusin dhe të Drejtat e Personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik (në tekstin e mëtejme: Ligji për Personat Paraplegjik dhe Tetraplegjik) u miratua nga Kuvendi në vitin 2016. I njëjti rregullon statusin dhe të drejtat e personave, të cilët si shkak i sëmundjes apo dëmtimit kanë humbur në formë të përhershme mundësinë e zhvendosjes dhe lëvizjes së ekstremiteteve të poshtme apo personave të cilët si shkak i sëmundjes apo dëmtimit kanë humbur në formë të përhershme mundësinë e zhvendosjes dhe lëvizjes të ekstremiteteve të sipërme dhe të poshtme të cilët marrin kompensim mujor. Ligji i lartcekur, përcakton të drejtat në beneficione të përfituesve të këtij ligji, si dhe procedurat administrative për realizimin e këtyre të drejtave.

125. Për aq sa është relevante për rrethanat e rastit konkret, Ligji i lartcekur, gjithashtu përcakton të drejtat e tyre, duke përfshirë por mos u kufizuar në ato që ndërlidhen me (i) kujdestarin personal në nenin 8 ; (ii) fondet për pagesa të kompensimit dhe kujdestarit në nenin; (iii) lirin nga taksat dhe tatimi në nenin 10 ; (iv) arsimin në nenin 12 ; (v) kujdesin shëndetësor në nenin 13 ; (vi) shpenzimet e energjisë elektrike në nenin 14 ; (vii) udhëtimin në nenin 15 ; dhe (viii) përkujdesjen për strehim në nenin 16 , sipas përcaktimeve të ligjit të lartcekur. Neni 7 (Kompensimi) i Ligjit të lartcekur, gjithashtu përcakton modalitetet e kompensimit, duke përfshirë që (i) përfituesit e këtij ligji, marrin nga buxheti shtetëror kompensimin në një shkallë të caktuar, bazuar në pagën minimale në Kosovë, dhe përcaktohet me akt nënligjor të nxjerrë nga Qeveria, sipas propozimit të MPMS; (ii) përfituesit e këtij ligji, në bazë të vlerësimit nga komisioni vlerësues, të cilët kanë pasoja të përhershme dhe të plota në inkontinencë, përdorin medikamente në baza ditore, kanë humbje të ndjeshmërisë së plotë të

ekstremiteteve dhe me qëllim të parandalimit të plagëve dekubitare marrin një shumë shtesë prej pesëdhjetë përqind (50%) të kompensimit nga paragrafi 1 i këtij neni; (iii) punësimi, vetëpunësimi apo ndonjë formë tjetër e punësimit, nuk do të jenë arsye për përjashtim nga kompensimi, siç përcaktohet në këtë ligj; dhe (iv) përfituesit e këtij ligji pavarësisht nga mosha marrin kompensim të paraparë me këtë ligj.

126. Gjykata gjithashtu vëren që neni 21 (Beneficionet Subjekt i Vështirësive Fiskale) i Ligjit për Personat Paraplegjik dhe Tetraplegjik, përcakton përjashtimet nga të drejtat, beneficionet dhe kompensimet e lartcekura, duke përcaktuar që pavarësisht nga dispozitat e tjera të këtij ligji, pagesa e cilitdo dhe të gjitha beneficioneve financiare të siguruara nga ky ligj duhet të kërkohet vetëm deri në atë masë që (i) fondet janë përvetësuar veçmas për një qëllim të tillë, sipas ligjit të aplikueshëm për buxhetin vjetor; (ii) ka fonde të mjaftueshme, në dispozicion për pagesa të tilla; (iii) Qeveria nuk ka lëshuar vendim sipas paragrafit 2 të këtij neni që redukton apo eliminon pagesa të tilla; dhe (iv) në masën që Qeveria e sheh të domosdoshme për të adresuar rrethanat që krijojnë tendosje të paparapara fiskale në buxhetin publik apo që përndryshe të sigurojë ruajtjen e disiplinës fiskale publike, Qeveria do të ketë autoritetin që të lëshojë një vendim që redukton apo eliminon çfarëdo beneficioni të siguar me këtë ligj, përfshirë beneficionet që kanë të bëjnë me pagesa financiare madje edhe nëse janë përvetësuar fondet sipas ligjit të buxhetit të aplikueshëm në atë kohë.
127. Gjykata rikujton që Ligji i kontestuar, përmes nenit 4 të tij, ndryshon paragrafin 1 të nenit 7 të Ligjit për Personat Paraplegjik dhe Tetraplegjik, duke zëvendësuar paragrafin 1 të nenit 7 të ligjit të lartcekur me paragrafin 1 të nenit 4 të Ligjit të kontestuar, përkatësisht, duke zëvendësuar formulimin (i) *“Përfituesit e këtij ligji, marrin nga buxheti shtetëror kompensimin në një shkallë të caktuar, bazuar në pagën minimale në Kosovë, dhe përcaktohet me akt nënligjor të nxjerrë nga Qeveria, sipas propozimit të MPMS”*; me (ii) *“Qeveria e Republikës së Kosovës, me propozimin e Ministrisë përgjegjëse për Financa, vendosë për lartësinë e shumës së kompensimeve për përfituesit e këtij ligji, varësisht nga mundësitë buxhetore, kostoja e jetesës dhe inflacioni eventual”*.

III. Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Ligjit të kontestuar

128. Gjykata fillimisht thekson që bazuar në (i) nenin 7 [Vlerat] të Kushtetutës, një nga vlerat e Republikës është edhe drejtësia sociale; (ii) nenin 24 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës, të gjithë janë të barabartë para ligjit dhe askush nuk mund të diskriminohet, ndër të tjera, në bazë të gjendjes ekonomike apo sociale; dhe (iii) nenin 51 [Mbrotjtja Shëndetësore dhe Sociale] të Kushtetutës, (a) kujdesi shëndetësor dhe sigurimi social rregullohen me ligj; dhe (b) sigurimi social themelor, që ka të bëjë me papunësinë, sëmundjen, aftësitë e kufizuara dhe moshën e shtyrë, rregullohet me ligj.
129. Bazuar në dispozitat e lartcekura, Gjykata vë theks në faktin që Kushtetuta përmes nenit 51 të saj, çështjet që ndërlidhen me kujdesin shëndetësor, sigurimin social, përfshirë atë që ka të bëjë me *“papunësinë, sëmundjen, aftësitë e kufizuara dhe moshën e shtyrë”*, i ka deleguar në nivel të ligjit dhe i cili miratohet nga Kuvendi i Republikës, gjithnjë nën garancitë kushtetuese, përfshirë ato që ndërlidhen me drejtësinë sociale dhe barazinë para ligjit, sipas përcaktimeve të nenit 7 dhe 24 të Kushtetutës.
130. Gjykata më tej thekson që çështjet që ndërlidhen me kategoritë e lartcekura, përkatësisht (i) veteranët e UÇK-së; (ii) personat e verbër; dhe (iii) personat paraplegjik dhe tetraplegjik, janë rregulluar me ligje të Republikës së Kosovës dhe të cilat, në kontekst të lartësisë së pensionit dhe kompensimit ndryshohen dhe plotësohen përmes Ligjit të kontestuar. Megjithatë, Gjykata thekson që ligjet e aplikueshme për kategoritë e lartcekura, nuk e rregullojnë në mënyrë identike çështjen e shkallës/lartësisë së

pensioneve dhe/ose kompensimeve përkatëse, duke përfshirë në kontekst të ndërlidhshmërisë me pagën minimale në Republikën e Kosovës.

131. Në fakt, e vetmja kategori e cila bazuar në ligjet e aplikueshme ka garanci që lartësia e shumës së pensionit, “*nuk mund të jetë më e vogël se paga minimale e përcaktuar në Kosovë*”, është kategoria e veteranëve të UÇK-së. Megjithatë, sipas sqarimeve që do të pasojnë në vijim, kjo garanci e përfshirë në nenin 18 të Ligjit për Veteranët të vitit 2014, është eliminuar përmes Ligjit për Veteranët të vitit 2017 dhe i është nënshtruar vlerësimit të Gjykatës Kushtetuese në rastin [K001/17](#), me parashtrues *Aida Dërguti dhe 23 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës* dhe e cila, në kontekst të shkëputjes së ndërlidhshmërisë së lartësisë së shumës së pensionit të veteranit me garancinë e pagës minimale, nuk kishte konstatuar shkelje të dispozitave kushtetuese.
132. Në anën tjetër, garancitë e ndërlidhura me pagën minimale në kontekst të lartësisë së kompensimeve për personat e verbër dhe personat paraplegjik dhe tetraplegjik, i nënshtrohen formulimeve të tjera në ligjet e aplikueshme, përkatësisht Ligjin për Personat e Verbër dhe Ligjin për Personat Paraplegjik dhe Tetraplegjik. Më saktësisht dhe për dallim nga formulimi në Ligjin për Veteranët të vitit 2014, sipas të cilit lartësia e shumës së pensionit, “*nuk mund të jetë më e vogël se paga minimale e përcaktuar në Kosovë*”, (i) Ligji për Personat e Verbër, përcakton që të njëjtit, “*marrin nga buxheti shtetëror kompensimin në një shkallë të caktuar bazuar në pagën minimale në Kosovë, por jo më pak se njëqind (100) euro në muaj dhe përcaktohet me akt nënligjor të nxjerrë nga Qeveria*”, ndërsa (ii) Ligji për Personat Paraplegjik dhe Tetraplegjik, përcakton që të njëjtit “*marrin nga buxheti shtetëror kompensimin në një shkallë të caktuar, bazuar në pagën minimale në Kosovë*”, dhe përcaktohet me akt nënligjor të nxjerrë nga Qeveria, sipas propozimit të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenijes Sociale (MPMS-së), në nenin 7 të tij, për më tepër, që i njëjti i nënshtrohet edhe kushtit të mjaftueshmërisë së fondeve në buxhetin e Shtetit, sipas përcaktimeve të nenit 21 të tij.
133. Bazuar në sqarimet e lartcekura, Gjykata vëren që (i) e vetmja kategori e cila bazuar në Ligjin e aplikueshëm të vitit 2014, ka pasur garanci për lartësinë e kompensimit në nivelin e pagës minimale, është kategoria e veteranëve të UÇK-së, por që një garanci e tillë është eliminuar në vitin 2017 dhe i është nënshtruar vlerësimit të Gjykatës Kushtetuese; (ii) kategoria e personave të verbër dhe personave paraplegjik dhe tetraplegjik, bazuar në ligjet respektive të aplikueshme, nuk kanë garancinë që lartësia e kompensimeve përkatëse nuk do të jetë më e ulët se vlera e pagës minimale, por garancinë e kompensimit “*në një shkallë të caktuar bazuar në pagën minimale*”; ndërsa, (iii) e vetmja kategori për të cilin ligji i aplikueshëm garanton pragun e ulët të vlerës së kompensimit, përkatësisht garancinë që e njëjta nuk mund të jetë më e ulët se njëqind (100) euro në muaj, është ajo e personave të verbër.
134. Në vijim dhe bazuar në sqarimet e lartcekura, Gjykata do t’i nënshtrroj në vlerësim të kushtetutshmërisë dispozitat e kontestuara të Ligjit të kontestuar, duke filluar me (i) vlerësimin e kushtetutshmërisë së nenit 2, 3, 4 të Ligjit të kontestuar me nenin 24 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës; (ii) vlerësimin e kushtetutshmërisë së nenit 2, 3, 4 të Ligjit të kontestuar me nenin 46 [Mbrotjtja e pronës] të Kushtetutës; dhe (iii) vlerësimin e kushtetutshmërisë së nenit 6 të Ligjit të kontestuar me nenet 7 [Vlerat] dhe 51 [Mbrotjtja shëndetësore dhe sociale] të Kushtetutës. Përgjatë vlerësimit të neneve të lartcekura, dhe duke u bazuar në pretendimet e parashtruesve dhe argumentet dhe kundërgargumentet e palëve para Gjykatës, kjo e fundit, gjithashtu do të shtjellojë dhe aplikojë parimet relevante që ndërlidhen me barazinë para ligjit dhe të drejtën në pronë, duke marrë parasysh rrethanat e veçanta të secilës kategori veç e veç, përkatësisht kategorisë së (i) veteranëve të UÇK-së; (ii) personave të verbër; dhe (iii) personave paraplegjik dhe tetraplegjik.

1. Vlerësimi i kushtetutshmërisë së neneve 2, 3, 4 të Ligjit të kontestuar me nenin 24 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës

A. Thelbi i pretendimeve dhe kundërargumentet e palëve

135. Gjykata fillimisht vë në pah që parashtruesit e kërkesës pretendojnë që nenet 2, 3 dhe 4 të Ligjit të kontestuar, me të cilat ndryshohen dhe plotësohen ligjet bazike që rregullojnë statusin e tri kategorive të lartcekura të shoqërisë ndërlidhur me mënyrën e përcaktimit të lartësisë së shumës së pensioneve dhe kompensimeve, duke “*shuar referencën në pagën minimale*”, cenojnë parimin e barazisë para ligjit dhe si të tilla janë diskriminuese. Në esencë, parashtruesit e kërkesës pretendojnë cenim të parimit kushtetues të barazisë para ligjit, në mes të tri kategorive të lartcekura në mes vete, sepse duke lënë përcaktimin e kompensimit përkatës në diskrecionin e Qeverisë, Ligji i kontestuar: (i) i jep të drejtë Qeverisë t’i caktojë pensionet e këtyre grupeve në lartësi të ndryshme, dhe jo në mënyrë të barabartë për të gjithë; (ii) bën dallimin e kategorive, në rrethana të njëjta; dhe se (iii) ekziston mundësia që lartësia e shumës së pensionit të njëjës kategori të jetë më e lartë sesa lartësia e shumës së pensionit të një kategorie tjetër, e cila mund të përbëjë diskriminim. Rrjedhimisht, të njëjtat nuk kanë garanci që do të kompensohen në mënyrë të barabartë. Në esencë, pretendimet e parashtruesve të kërkesës, mbështeten edhe nga Avokati i Popullit.
136. Në anën tjetër, Ministria e Financave dhe grupi Parlamentar i LVV-së, kundërargumentojë, duke theksuar, ndër të tjera, që dispozitat e Ligjit të kontestuar nuk cenojnë parimin e barazisë para ligjit, sepse kategoritë e lartcekura nuk janë në “*një situatë të ngjashme apo të krahasueshme*” me njëra-tjetrën dhe as me punëtorët e tjerë që janë në marrëdhënie pune, sepse (i) veteranët e luftës së UÇK-së marrin pensionin dhe beneficinet tjera për shkak të shërbimit të tyre në luftë dhe si shenjë mirënjohje e shtetit ndaj tyre; (ii) personat e verbër dhe personat paraplegjik dhe tetraplegjik fitojnë të drejta dhe beneficione për shkak të karakteristikave të tyre personale; ndërsa (iii) të punësuarit paguhen për punën dhe shërbimin e tyre dhe, për pasojë, koncepti i pagës minimale vlen vetëm për këta të fundit.

B. Vlerësimi i Gjykatës

137. Gjykata rikujton që pretendimet e parashtruesve të kërkesës në kontekst të neneve të lartcekura, në parim, ndërlidhen me parimin e barazisë para ligjit, përkatësisht trajtimin e pabarabartë në mes kategorive të veteranëve të UÇK-së, personave të verbër dhe personave paraplegjik dhe tetraplegjik dhe të cilët në mungesë të garancive për pagën minimale, mund të mos trajtohen në mënyrë të njëjtë, pretendime këto, të cilat, Gjykata do t’ ia nënshtrojë vlerësimin të saj në vijim.
138. Në kontekstin e lartcekur, Gjykata, ashtu siç ka përcaktuar përmes praktikës së saj gjyqësore, fillimisht rikujton se neni 24 [Barazia para Ligjit] i Kushtetutës, përcakton që të gjithë janë të barabartë para ligjit dhe që të gjithë gëzojnë të drejtën për mbrojtje të barabartë ligjore. Mbrojtja kundër diskriminimit e përcaktuar në nenin 14 (Ndalimi i diskriminimit) dhe nenin 1 (Ndalimi i përgjithshëm i diskriminimit) të Protokollit nr. 12 të KEDNJ-së, e ndalon diskriminimin jo vetëm ndaj të drejtave të përcaktuara nga KEDNJ, por edhe ndaj të drejtave të cilat janë të përcaktuara përmes ligjeve të aplikueshme. Për më tepër dhe në kuptim të nenit 24 të Kushtetutës, Gjykata gjithashtu vë në pah se fushëveprimi i këtij neni është i gjerë dhe shtrihet edhe në garantimin e ndalimit të diskriminimit, jo vetëm sa i përket të drejtave të garantuara me Kushtetutë, por edhe atyre me ligj. Rrjedhimisht, vlerësimi i pretendimeve për cenimin e këtij neni, duhet të bëhet përtej garancive të nenit 14 të KEDNJ-së dhe të përfshijë edhe garancitë e përcaktuara përmes nenit 1 të Protokollit nr. 12 të KEDNJ-së (shih, në lidhje me këtë, rastin e Gjykatës, [KO93/21](#), parashtrues: *Blerta Deliu-Kodra dhe dymbëdhjetë (12)*)

deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Aktgjykimi i 23 dhjetorit 2021, paragrafët 283-293; dhe rastin e Gjykatës [KO79/23](#), me parashtrues Avokati i Popullit, Aktgjykim, i 26 dhjetorit 2023, paragrafët 353-354).

139. Gjykata më tej rikujton se parimet përkitazi me barazinë para ligjit dhe mosdiskriminimin, janë shtjelluar, mes tjerash edhe në tri (3) raste të Gjykatës, përkatësisht, (i) Aktgjykimin [KO93/21](#), lidhur me vlerësimin e kushtetutshmërisë së Rekomandimeve të Kuvendit të Republikës së Kosovës, nr. 08-R-01, të 6 majit 2021 (shih, paragrafët 283-364 lidhur me parimet e përgjithshme); (ii) Aktgjykimin [KO190/19](#) lidhur me vlerësimin e kushtetutshmërisë së nenit 8, paragrafit 2, të Ligjit nr. 04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti lidhur me nenin 5 dhe 6 të Udhëzimit Administrativ (MPMS) nr. 09/2015 për Kategorizimin e Shfrytëzuesve të Pensionit Kontributpagues sipas Strukturës Kualifikuese dhe Kohëzgjatjes së Pagesës së Kontributeve (shih, paragrafët 180-230 lidhur me parimet e përgjithshme); dhe (iii) Aktgjykimin [KO79/23](#) lidhur me vlerësimin e kushtetutshmërisë së Ligjit nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik (shih, paragrafët 352-361 lidhur me parimet e përgjithshme).
140. Bazuar në praktikën e lartcekur gjyqësore dhe për aq sa është relevante në rrethanat e rastit konkret, Gjykata rikujton kriteret që duhet të vlerësohen në mënyrë që të konstatohet nëse është cenuar parimi i barazisë para ligjit sipër përcaktimeve të nenit 24 të Kushtetutës, përkatësisht (i) nëse ka pasur “*dallim në trajtim*” të personave në “*situata analoge ose situata relativisht të ngjashme*” – ose dështim për të trajtuar persona ndryshe në situata relativisht të ndryshme; dhe nëse ky është rasti, atëherë vlerësohet (ii) nëse një dallim i tillë – ose mungesë e dallimit – është e justifikuar në mënyrë objektive, përkatësisht nëse (a) dallimi në trajtim është “*i përcaktuar me ligj*”; (b) dallimi në trajtim ka ndjekur një “*qëllim legjitim*”; dhe (c) ekziston një marrëdhënie e “*proporcionalitetit*” ndërmjet dallimit në trajtim dhe qëllimit që synohet të arrihet (shih, ndër të tjera, rastet e Gjykatës [KO93/21](#) me parashtrues *Blerta Deliu-Kodra dhe 12 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës*, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Rekomandimeve të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Nr. 08-R-01, të 6 majit 2021, Aktgjykim i 28 dhjetorit 2022, paragrafët 301-311; dhe [KOO1/17](#), me parashtruese *Aida Dërguti dhe 23 deputetë të tjerë të Kuvendit*, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-261 për veteranët e luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Aktgjykim i 28 marsit 2017, paragrafi 74).
141. Për pasojë, dhe për të konstatuar nëse, ka një “*dallim në trajtim*”, në mes kategorive të caktuara, Gjykata fillimisht, duhet të përcaktojë nëse të njëjtat janë në “*situata analoge ose situata relativisht të ngjashme*”. Të njëjtën qasje Gjykata ka ndjekur, ndër të tjera, në rastin (i) [KO93/21](#), dhe përmes të cilit ka vlerësuar që të gjithë konsumatorët e energjisë elektrike në Republikën e Kosovës janë në “*situata analoge ose situata relativisht të ngjashme*” (shih, Aktgjykimin e Gjykatës në rastin [KO93/21](#), paragrafët 301-311); dhe (ii) [KO190/19](#), dhe përmes të cilit ka vlerësuar që në kuptim të dispozitave ligjore përkitazi me kategorinë e pensionit kontributpagues, të gjithë qytetarët që kanë dëshmi për kualifikimet respektive siç janë të përcaktuara me Ligjin dhe Udhëzimin Administrativ të kontestuar dhe kanë stazh kontributdhënës, janë në “*situata analoge ose relativisht të ngjashme*” (shih, Aktgjykimin e Gjykatës në rastin [KO190/19](#), paragrafët 183-187).
142. Në rrethanat e dispozitave të kontestuara të Ligjit të kontestuar dhe pretendimeve të parashtruesve të kërkesës, në rrethanat e rastit konkret, kontestuese është nëse ka “*dallim në trajtim*” në mes të tri kategorive në mes vete, sepse duke lënë përcaktimin e kompensimit përkatës në diskrecionin e Qeverisë, të njëjtat nuk kanë garanci që do të kompenson në mënyrë të barabartë. Gjykata sipas sqarimeve të mësipërme, thekson që

për të përcaktuar nëse “*ka një dallim në trajtim*”, fillimisht duhet të saktësojë nëse kategoritë e lartcekura, janë në “*situata analoge ose relativisht të ngjashme*”.

143. Gjykata fillimisht rikujton që statusi, përfshirë beneficinet e veteranëve të UÇK-së, personave të verbër dhe personave paraplegjik dhe tetraplegjik, janë të përcaktuara me (i) Ligjin nr. 04/L-261 për Veteranët e Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 05/L-141; (ii) Ligjin nr. 04/L - 092 për Personat e Verbër; dhe (iii) Ligjin nr. 05/L-067 për Statusin dhe të Drejtat e Personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik, respektivisht, ndërsa (iv) të drejtat dhe detyrimet e të punësuarve në Republikën e Kosovës, janë të saktësuara përmes Ligjit nr. 03/L-212 të Punës.
144. Gjykata, fillimisht dhe në kontekst të pagës minimale në Republikën e Kosovës, sqaron dallimin në mes të Ligjit të punës dhe ligjeve që rregullojnë të drejtat dhe beneficinet/kompensimet përkatëse për veteranët e UÇK-së, personat e verbër dhe personat paraplegjik dhe tetraplegjik, duke iu referuar nenit 1 (Qëllimi) të Ligjit të punës, i cili përcakton që ky ligj ka për qëllim të rregullojë të drejtat dhe detyrimet nga marrëdhënia e punës, siç përcaktohen me këtë ligj, ndërsa neni 2 (Fusha e zbatimit), përcakton që dispozitat e këtij ligji zbatohen për të punësuarit dhe punëdhënësit e sektorit privat dhe publik në Republikën e Kosovës. Në anën tjetër, Ligji për Veteranët, Ligji për Personat e Verbër dhe Ligji për Personat Paraplegjik dhe Tetraplegjik, përcaktojnë të drejtat dhe beneficinet përkatëse për të tri kategoritë e lartcekura, për shkak të kontributit të tyre në Luftën Çlirimtare të Kosovës në rastin e veteranëve të UÇK-së, ndërsa për shkak të karakteristikave të tyre personale në rastin e personave të verbër dhe atyre paraplegjik dhe tetraplegjik. Duke marrë parasysh dallimin e fushëveprimit të Ligjit të punës në njërin anë dhe fushëveprimit të ligjeve të aplikueshme për veteranët e UÇK-së, personat e verbër dhe personat paraplegjik dhe tetraplegjik në anën tjetër, përfshirë qëllimin e secilit ligj të lartcekur, dallimin në mes kategorive që rregullojnë, përfshirë të drejtat dhe lehtësitë që u janë përcaktuar me ligjet e aplikueshme veteranëve të UÇK-së, personave të verbër dhe personave paraplegjik dhe tetraplegjik për dallim nga të punësuarit në sektorin publik dhe privat në Republikën e Kosovës, Gjykata thekson që kategoritë e lartcekura nuk janë në “*situata analoge apo relativisht të ngjashme*” me të punësuarit në Republikën e Kosovës sipas përcaktimeve të Ligjit të punës.
145. Në anën tjetër dhe në kontekst të kategorive të veteranëve të UÇK-së, personave të verbër dhe atyre paraplegjik dhe tetraplegjik, Gjykata vëren që (i) Ligji për Veteranët në nenin 1 (Qëllimi), përcakton që qëllimi i nxjerrjes së këtij ligji është përcaktimi i të drejtave në beneficione të veteranëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të cilët, me sakrificën, angazhimin dhe kontributin e tyre të çmuar, në Luftën Çlirimtare të Kosovës, ishin faktorë vendimtarë për sjelljen e lirisë dhe pavarësisë për popullin e Kosovës, ndërsa në nenin 2 (Fushëveprimi) të tij, saktëson që me këtë ligj përcaktohen të drejtat në beneficione për Veteranët e UÇK-së dhe anëtarët e ngushtë të familjeve të tyre, kriteret e kualifikimit për njohjen dhe realizimin e tyre si dhe procedurat administrative për realizimin e këtyre të drejtave; (ii) Ligji për Personat e Verbër, në nenin 1 (Qëllimi), përcakton që me këtë ligj rregullohet statusi ligjor i personave të verbër në Republikën e Kosovës, ndërsa në nenin 2 (Fushëveprimi), saktëson që i njëjti rregullon të drejtat dhe përfitimet si dhe përcakton kriteret për kategorizimin e personave të verbër; ndërsa (iii) Ligji për Personat Paraplegjik dhe Tetraplegjik, në nenin 1 (Qëllimi), saktëson që me këtë ligj rregullohet statusi dhe të drejtat e personave, të cilët si shkak i sëmundjes apo dëmtimit kanë humbur në formë të përhershme mundësinë e zhvendosjes dhe lëvizjes së ekstremiteteve të poshtme apo personave të cilët si shkak i sëmundjes apo dëmtimit kanë humbur në formë të përhershme mundësinë e zhvendosjes dhe lëvizjes të ekstremiteteve të sipërme dhe të poshtme, të cilët marrin kompensim mujor.

146. Për më tepër, dhe në kontekst të pagës minimale, Gjykata thekson që përderisa ligjet e lartcekura, përkatësisht (i) Ligji për Veteranët i vitit 2017, përmes nenit 16A dhe nenit 5 të tij, ndër të tjera, (a) saktëson pensionin mujor të Veteranit Luftëtar; (b) përcakton që buxheti i përgjithshëm, për realizimin e pagesës së pensionit të Veteranit Luftëtar të UÇK-së, shfrytëzohet tërësisht gjatë vitit për këtë destinim dhe nuk mund të tejkalojë 0.7% të bruto prodhimit vendor në vit dhe në rast të tejkalimit të 0.7% të bruto prodhimit vendor, atëherë reduktimi i pensionit ndodhë në mënyrë proporcionale për të gjithë përfituesit nga ky ligj; (c) eliminon nenin 18 të Ligjit bazik, i cili ndërlihdh lartësinë e shumës së pensioneve me pagën minimale; përderisa gjithashtu saktëson që (d) deri në kategorizimin përfundimtar të listës së Veteranit Luftëtar të UÇK-së, skema pensionale zbatohet siç është paraparë me ligjin bazik; (ii) Ligji për Personat e Verbër në nenin 7 të tij, minimumin e lartësisë së kompensimit përkatës, jodetyrimisht e ndërlihdh me pagën minimale, por me një shumë prej jo më pak së njëqind (100) euro në muaj; dhe (iii) Ligji për Personat Paraplegjik dhe Tetraplegjik, në nenin 7 të tij, minimumin e lartësisë së kompensimit përkatës, jodetyrimisht e ndërlihdh me pagën minimale, por me një shkallë të caktuar të saj, ndërsa në nenin 21 të tij, gjithashtu përcakton diskrecionin e Qeverisë që në rrethana të caktuara të ndryshojë lartësinë e këtij kompensimi.
147. Për më tepër, të tri ligjet dhe nën fushëveprimin e të cilave hyjnë kategoria e veteranëve të UÇK-së, personave të verbër dhe personave paraplegjik dhe tetraplegjik, përtej kompensimit përkatës mujor, përcaktojnë edhe një sërë të drejtash dhe benefitesh dhe të cilat vlejné vetëm për të tri kategoritë e lartcekura. Më saktësisht, në rastin e veteranëve, Ligji për Veteranët i vitit 2014, ndër të tjera, përcakton (i) të drejtën në shërbime shëndetësore falas në nenin 23 ; (ii) të drejtën e përparësisë në punësim në nenin 24 ; (iii) të drejtën e udhëtimit në nenin 25 ; (iv) të drejtën në riaftësim profesional në nenin 26 ; (v) lehtësirat për veteranët luftëtarë të UÇK-së në nenin 27 ; (vi) të drejtën në stazhin e dyfishtë në nenin 28 ; (vii) përkujdesjen për banim në nenin 29 ; (viii) përparësinë e pranimit në institucionet arsimore publike në nenin 30 ; (ix) lirimin nga pagesat administrative në shkollimin Universitar Publik në nenin 31 ; (x) vendosjen në shtëpitë e personave të moshuar në nenin 32 ; (xi) shpenzimet e varrimit në nenin 33 ; dhe (xii) pensionin për trashëgimtarët në nenin 20 , sipas përcaktimeve të ligjit të lartcekur. Ndërsa, Ligji për Personat e Verbër, ndër të tjera, përcakton (i) punësimin në nenin 5; (ii) lirimin nga taksat dhe tatimi në nenin 6 ; (iii) strehimin në nenin 8 ; (iv) kujdesin shëndetësor në nenin 9 ; (v) edukimin dhe arsimimin në nenin 10 ; (vi) qasjen në informacion në nenin 11 ; (vii) udhëtimin në nenin 13 ; dhe (viii) shpenzimet e energjisë elektrike dhe telefonit në nenin 14 , sipas përcaktimeve të ligjit të lartcekur. Në fund, dhe në rastin e personave paraplegjik dhe tetraplegjik, Ligji përkatës, ndër të tjera, përcakton (i) kujdestarin personal në nenin 8; (ii) fondet për pagesa të kompensimit dhe kujdestarit në nenin 9 ; (iii) lirimin nga taksat dhe tatimi në nenin 10 ; (iv) arsimin në nenin 12 ; (v) kujdesin shëndetësor në nenin 13 ; (vi) shpenzimet e energjisë elektrike në nenin 14 ; (vii) udhëtimin në nenin 15 ; dhe (viii) përkujdesjen për strehim në nenin 16 , sipas përcaktimeve të ligjit të lartcekur. Gjykata po ashtu vë re se në bazë të nenit 17 (Shtesa në Pensionin e pleqërisë) është paraparë se Veterani Luftëtar i UÇK-së i punësuar në sektorin publik dhe privat pas arritjes së moshës ligjore të pensionimit ka të drejtë në shtesë të pensionit për barazim me pensionin e veteranit luftëtar.
148. Bazuar në sqarimet e mësipërme, dhe duke marrë parasysh dallimin e fushëveprimit të ligjeve të aplikueshme për veteranët e UÇK-së, personat e verbër dhe personat paraplegjik dhe tetraplegjik, përfshirë qëllimin e secilit ligj të lartcekur, dallimin në mes kategorive që rregullojnë, përfshirë të drejtat dhe lehtësitë që u janë përcaktuar me ligjet e aplikueshme veteranëve të UÇK-së, personave të verbër dhe personave paraplegjik dhe tetraplegjik, Gjykata vlerëson që kategoritë e lartcekura nuk janë në “*situata analoge apo relativisht të ngjashme*”.

149. Në mbështetje të konstatimit të lartcekur, Gjykata i referohet praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, përkatësisht Aktgjykimit të Dhomës së Madhe të GJEDNJ-së, në rastin *Fabian kundër Hungarisë*, në të cilin, GJEDNJ nuk kishte konstatuar shkelje të nenit 14 në ndërlidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, pikërisht pas shtjellimit të parimeve dhe konstatimit që kategoritë respektive, përkatësisht të punësuarit në sektorin publik dhe privat, nuk ishin në “*situata analoge ose relativisht të ngjashme*” në kontekst të kompensimeve dhe/ose benefiteve sociale (shih, rastin e GJEDNJ-së, [Fabian kundër Hungarisë](#), nr. 78117/13 Aktgjykimi i 5 shtatorit 2017, paragrafët 130-134). Për më tepër dhe ngjashëm, GJEDNJ kishte vepruar në rastin *Gellérthegyi dhe të tjerët kundër Hungarisë*, dhe në të cilin, kishte vlerësuar që as kategoritë e ndryshme brenda sektorit publik, nuk janë detyrimisht në “*situata analoge ose relativisht të ngjashme*” (shih, rastin e GJEDNJ-së, [Gellérthegyi dhe të tjerët kundër Hungarisë](#), nr. 78135/13 dhe 429/14, Vendimi i 6 marsit 2018, paragrafët 31, dhe 35-36).
150. Gjithashtu, Gjykata thekson që përmes dy rasteve tjera, GJEDNJ, ka trajtuar edhe dallimin në trajtim në mes veteranëve të luftës dhe kategorive tjera dhe të cilat, përfitojnë nga benefitet e ndryshme sociale. Më saktësisht, Gjykata i referohet rastit të GJEDNJ-së [Popović dhe të tjerët kundër Serbisë](#), në të cilin parashtruesit e kërkesës me paaftësi fizike, kishin ngritur pretendime për diskriminimin e pretenduar nga shteti i paditur në dhënien e përfitimeve të aftësisë së kufizuar. Parashtruesit përkatës pohuan se atyre iu dha një shumë më e ulët se personave të klasifikuar si përfitues ushtarakë, pavarësisht se kishin saktësisht të njëjtën aftësi të kufizuar paraplegjike. Në kontekstin specifik të çështjes në fjalë, GJEDNJ nuk e konsideroi të nevojshme të miratonte një pikëpamje të prerë mbi çështjen nëse parashtruesit (si civilë me aftësi të kufizuara) dhe veteranët me aftësi të kufizuara të luftës, mund të konsideroheshin dy grupe në “*situata analoge ose relativisht të ngjashme*” sipas kuptimit të praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, megjithatë, ajo kishte konstatuar që dallimi përkatës në trajtim kishte një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, duke pranuar në esencë argumentin e Qeverisë përkatëse që dallimi në trajtim justifikohet nga mënyra se si të dy grupet kishin pësuar lëndime, përkatësisht (i) veteranë të luftës që kishin pësuar lëndime gjatë shërbimit të tyre ushtarak, gjatë të cilit, për nga natyra e gjërave, ata ishin ekspozuar ndaj një niveli më të lartë rreziku gjatë kryerjes së detyrave të vendosura nga Shteti; ndërsa (ii) grupi tjetër përbëhej nga civilë, përfshirë parashtruesit, të cilët kishin pësuar lëndime në situata që nuk kishin lidhje me kryerjen e detyrave të tilla, që përfshinin kryesisht aksidente ose sëmundje ose veprime të palëve të treta (shih, rastin e GJEDNJ-së [Popović dhe të tjerët kundër Serbisë](#), nr. 26944/13, Aktgjykimi i 30 qershorit 2020, paragrafët 74-80).
151. Në anën tjetër, në rastin [Radosav Milivojević kundër Serbisë](#), GJEDNJ-ja nuk gjeti ngjashmëri midis personave që përfitonin nga pensionet e moshës dhe atyre që përfitonin pensione të invaliditetit. Sipas GJEDNJ-së, dallimi midis këtyre grupeve nuk kishte synim favorizimin e njërit grup kundrejt tjetrit e as të diskriminonte një grup në bazë të invaliditetit të tyre, por ishte thjesht një reflektim i natyrës së ndryshme të pensioneve dhe kontribuonte në balancimin e pensioneve për grupet që përfitonin nga sigurimi social i Shtetit. Në këtë rast, GJEDNJ vlerësoi që qëllimi i masës që bën dallimin midis pensionistëve të pleqërisë dhe invaliditetit në rastin konkret nuk është të vendosë një kategori në një pozitë më pak të favorshme ose të diskriminojë një grup të caktuar personat në bazë të aftësisë së kufizuar, por në vend të kësaj për të pasqyruar natyrën e ndryshme të dy pensioneve dhe për të kontribuar në balancimin e kujdesshëm të shumave të përfitimeve që u jepen grupeve të ndryshme të përfituesve në sistemin e sigurimeve shoqërore të Shtetit (shih, rastin e GJEDNJ-së [Radosav Milivojević kundër Serbisë](#), nr. 11944/16, Vendimi i 5 korrikut 2022, paragrafi 36).
152. Bazuar në sqarimet e lartcekura, përkatësisht vlerësimin e Gjykatës që, marrë parasysh fushëveprimin e ligjeve të lartcekura, përfshirë dallimin në mes kompensimeve dhe

beneficioneve të kategorive përkatëse ndërlidhur me të drejtat dhe detyrimet përkatëse, kategoria e veteranëve, personave të verbër dhe personave paraplegjik dhe tetraplegjik në mes vete, nuk janë në “*situata analoge ose relativisht të ngjashme*”, duke u bazuar edhe në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, duhet të konstatohet që në mes të njëjtave kategori, nuk ka as “*dallim në trajtim*” dhe rrjedhimisht, as cenim të parimit të barazisë para ligjit.

153. Për pasojë, dhe bazuar në sqarimet si më sipër, Gjykata konstaton që nenet 2, 3 dhe 4 të Ligjit të kontestuar, nuk janë në kundërshtim me nenin 24 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 1 [Ndalimi i përgjithshëm i diskriminimit] të Protokollit nr. 12 të KEDNJ-së.

2. Vlerësimi i kushtetutshmërisë së neneve 2, 3, 4 të Ligjit të kontestuar me nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës

A. Thelbi i pretendimeve dhe kundërargumentet e palëve

154. Gjykata rikujton që parashtruesit e kërkesës pretendojnë që nenet 2, 3 dhe 4 të Ligjit të kontestuar, cenojnë të drejtën në pronë, përfshirë “*pritshmëritë legjitime*” të veteranëve të UÇK-së, personave të verbër dhe personave paraplegjik dhe tetraplegjik ndërlidhur me lartësinë e shumës së pensionit të tyre, përkatësisht garancinë që i njëjti nuk do të jetë nën nivelin e pagës minimale në Republikën e Kosovës. Për më tepër, parashtruesit e kërkesës pretendojnë që diskrecioni i plotë i Qeverisë që të caktojë lartësinë e pensionit të kategorive të lartcekura gjithashtu cenon parimin e sigurisë juridike në kundërshtim me të drejtat pronësore të këtyre kategorive. Në anën tjetër, Ministria e Financave dhe grupi parlamentar i LVV-së, kundërshtojnë këto pretendime, duke theksuar që shkoputja e ndërlidhjes me pagën minimale ndërlidhet me nevojën për të ruajtur qëndrueshmërinë financiare dhe fleksibilitetin e nevojshëm për të ndryshuar nivelin e pagës minimale, duke mbajtur gjithashtu që në parim, qeveritë gëzojnë diskrecion të gjerë në përcaktimin e politikave sociale dhe ekonomike dhe lartësitë e pensioneve.

B. Vlerësimi i Gjykatës

155. Gjykata fillimisht rikujton që konceptin e “*pasurisë*” dhe “*pritjeve legjitime*”, përfshirë në kontekst të të “*hyrave të ardhshme*” sipas përcaktimeve të nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, rishtazi e ka trajtuar edhe në dy aktgjykime të saj, përkatësisht (i) Aktgjykimin e Gjykatës në rastet KO216/22 dhe KO220/22, ndërlidhur me vlerësimin e kushtetutshmërisë së Ligjit për Zyrtarët Publikë; dhe (ii) në rastin KO79/23 ndërlidhur me vlerësimin e kushtetutshmërisë së Ligjit për Pagat në Sektorin Publik.
156. Përmes këtyre aktgjykimeve, dhe për aq sa është relevante për rrethanat e rastit konkret, Gjykata ka sqaruar që bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së në interpretimin e nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, koncepti i “*pasurisë*”, në parim, përfshinë si “*pasuritë ekzistuese*” ashtu edhe pasuritë e pretenduara, në lidhje me të cilat, një parashtrues i kërkesës mund të argumentojë se ai ose ajo ka të paktën një “*pritshmëri legjitime*”. Që një “*pritje*” të jetë “*legjitime*”, ajo duhet të jetë e një natyre më konkrete se sa një shpresë e thjeshtë dhe të bazohet në një dispozitë ligjore ose një akt ligjor si vendimi gjyqësor, që ka të bëjë me interesin pasuror në fjalë. Në të kundërtën kurrfarë pritje legjitime nuk mund të thuhet se lind kur ka një mosmarrëveshje sa i përket interpretimit dhe zbatimit të saktë të ligjit vendor dhe kur kërkesat e parashtruesve më pas refuzohen nga gjykatat kombëtare (shih, ndër të tjera, praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, në rastet [Kopecký kundër Sllovakisë](#), [DhM], nr. 44912/98, Aktgjykim i 28 shtatorit 2004, paragrafët 49-50; [Centro Europa 7 S.R.L. dhe di Stefano kundër Italisë](#), [DhM], nr. 38433/09, Aktgjykim i 7 qershorit 2012, paragrafi

- 173; [Saghinadze dhe të tjerët kundër Gjeorgjisë](#), nr.18768/05, Aktgjykim i 13 janarit 2015, paragrafi 103; [Ceni kundër Italisë](#), nr. 25376/06, Aktgjykim i 16 dhjetorit 2014, paragrafi 39; [Béláné Nagy kundër Hungarisë](#), [DhM], nr. 53080/13, Aktgjykim i 13 dhjetorit 2016, paragrafi 75).
157. Për më tepër, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, “*të hyrat e ardhshme*” dhe “*pensionet dhe përfitimet sociale*” gjithashtu gëzojnë mbrojtjen e nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, në kushtet dhe parimet e përcaktuara nga praktika gjyqësore e GJEDNJ-së. Bazuar në të njëjtën praktikë gjyqësore, këto të drejta nuk janë absolute, megjithatë kufizimi i tyre duhet të plotësojë disa kushte. Testi i përcaktuar përmes praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së në interpretimin e nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së është kompatibil me nenin 55 të Kushtetutës dhe i cili gjithashtu përcakton kriteret përkatëse bazuar në të cilat të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë, përfshirë të drejtën në pronë të garantuara me nenin 46 të Kushtetutës, mund të kufizohen, në rrethanat në të cilat “*ndërhyrja/kufizimi*” i të drejtave përkatëse është (i) i “*përcaktuar me ligj*”; (ii) ndjek një “*qëllim legjitim*”; dhe (iii) është “*proporcional*” në raport me qëllimin legjitim të ndjekur.
158. Gjykata, duke marrë parasysh rrethanat e rastit konkret, gjithashtu sqaron që GJEDNJ, ka përcaktuar edhe parimet themelore që ndërlidhen me skemat pensionale dhe/ose sociale, duke saktësuar që të drejtat që ndërlidhen me të njëjtat, në parim, hyjnë në fushëveprimin dhe gëzojnë garancitë e nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së. Për më tepër, përmes praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, gjithashtu është sqaruar që edhe një përfitim i mirëqenies në një skemë jokontribuese mund të përbëjë një pasuri për qëllimet e nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së (shih, ndër të tjera, aktgjykimet e GJEDNJ-së në rastet [Bucheň kundër Republikës Çeke](#), nr.36541/97, Aktgjykim i 26 nëntorit 2002, paragrafi 46; [Koua Poirrez kundër Francës](#), nr.40892/98, Aktgjykim i 30 shtatorit 2003, paragrafi 37; [Wessels-Bergervoet kundër Hollandës](#), nr.34462/97, Aktgjykimi i 4 qershorit 2002; dhe [Van den Bouëhuijsen dhe Schering kundër Hollandës](#), nr.44658/98, Vendim i 16 dhjetorit 2003.
159. Më tej, përmes praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së dhe për aq sa është relevante në rrethanat e rastit konkret, GJEDNJ, ka përcaktuar (i) të drejtat e shtetit përkatës; por edhe (ii) të drejtat e individit.
160. Në kontekst të diskrecionit të shtetit përkatës, GJEDNJ ka theksuar, në parim, që (i) neni 1 i Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, nuk vendos asnjë kufizim në lirinë e Shteteve Kontraktuese të vendosin nëse do të kenë në funksion ndonjë formë të skemës së sigurimeve sociale, ose të zgjedhin llojin ose sasinë e përfitimeve që mund të sigurohen sipas ndonjë skeme të tillë (shih, ndër të tjera, aktgjykimet e GJEDNJ-së në rastet [Sukhanov dhe Ilchenko kundër Ukrainës](#), cituar më lart, paragrafi 36; [Kolesnyk kundër Ukrainës](#), cituar më lart, paragrafët 89 dhe 91; dhe [Fakas kundër Ukrainës](#), cituar më lart, paragrafët 34-37, 37-43, 48), megjithatë nëse një shtet parashih pagesën si e drejtë e një përfitimi të mirëqenies - qoftë nëse kushtëzohet ose jo nga pagesa paraprake e kontributeve - ai legjislacion duhet të konsiderohet si gjenerues i një interesi pronësie, i cili bie brenda suazave të nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së (shih, ndër të tjera, praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, [Stec dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar](#)[DhM], nr. 65731/01 dhe 65900/01, Vendim i 6 qershorit 2005 paragrafi 54); (ii) shtetet gëzojnë diskrecion më të gjerë në çështjet që kanë të bëjnë me të drejtat sociale dhe ekonomike sepse, qeveritë e shteteve gjenden në pozitë më të mirë për të njohur nevojat e shoqërisë dhe për të përcaktuar interesin publik në çështjet ekonomike dhe sociale (shih, ndër të tjera, rastin e GJEDNJ-së, [Luczak kundër Polonisë](#), nr. 77782/01, Aktgjykim i 27 nëntorit 2008, paragrafi 48); dhe (iii) të drejtat që ndërlidhen me skemat pensionale mund të kufizohen për qëllime legjitime, dhe të cilat, në parim, përfshijnë edhe rrezikun e dëmtimit të ekuilibrit financiar të sistemit të sigurimeve

shoqërore, me kushtin që kufizime të tilla të jenë proporcionale (shih, ndër të tjera, rastet e GJDBE-së, parashtrues [FK Rechtsanwaltskammer Wien](#), Aktgjykim i 15 shtatorit 2022, paragrafët 74 dhe 75; [Raymond Kohll v Union des caisses de maladie](#), Aktgjykim i 28 prillit 1998, paragrafi 41; dhe, [ITC Innovative Technology Center GmbH v Bundesagentur für Arbeit](#), Aktgjykim i 11 janarit 2007, paragrafi 43).

161. Ndërsa, në kontekst të të drejtave që burojnë si më sipër, GJEDNJ, në parim, ka theksuar që (i) përderisa ajo nuk mund të zëvendësojë vlerësimin e autoriteteve kombëtare në lidhje me nivelin e përfitimeve financiare të skemave shoqërore (shih, rastin e GJEDNJ-së, [Seiko kundër Lituanisë](#), nr. 82968/17, Aktgjykim i 12 tetorit 2020, paragrafi 32) dhe që të njëjtat kanë autoritetin e plotë për të vendosur për krijimin e skemave sociale, për lartësitë e pensioneve dhe të beneficioneve të tjera, megjithatë, kur shumica e pensionit reduktohet ose shuhet, kjo përbën ndërhyrje në pronë, që kërkon justifikim për interesin e përgjithshëm (shih, rastin e GJEDNJ-së, [Rasmussen kundër Polonisë](#), nr. 38886/05, Aktgjykimi i 28 prillit 2009, paragrafi 71); dhe (ii) kur personi në fjalë nuk i plotëson ose pushon së plotësuari, kushtet ligjore të përcaktuara në ligjin vendor për dhënien e ndonjë forme të veçantë të përfitimeve ose pensionit, nuk ka ndërhyrje në të drejtat sipas nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së (shih, rastin e GJEDNJ-së, [Rasmussen kundër Polonisë](#), cituar më lart, paragrafi 71), megjithatë, kur pezullimi ose zvogëlimi i një pensioni nuk është për shkak të ndonjë ndryshimi në rrethanat e vetë parashtruesit, por për shkak të ndryshimeve në ligj ose zbatimin e tij, kjo mund të rezultojë në një ndërhyrje në të drejtat sipas nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së (shih, rastin e GJEDNJ-së, [Belane Nagy kundër Hungarisë](#), cituar më lart, paragrafi 86).

162. Në rrethanat e dispozitave të kontestuara të Ligjit të kontestuar dhe pretendimeve të parashtruesve të kërkesës, në rrethanat e rastit konkret, kontestuese është nëse janë cenuar të drejtat në pronë të garantuara me nenin 46 të Kushtetutës dhe nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, për (i) veteranët e UÇK-së; (ii) personat e verbër; dhe (iii) personat paraplegjik dhe tetraplegjik. Për të vlerësuar nëse ky është rasti, sipas sqarimeve që janë dhënë më sipër, Gjykata duhet fillimisht të përcaktojë nëse (i) kategoritë e lartcekura gëzojnë të drejtën në pronë bazuar në ligjet e aplikueshme, përkatësisht Ligjin për Veteranët, Ligjin për Personat e Verbër dhe Ligjin për Personat Paraplegjik dhe Tetraplegjik dhe rrjedhimisht të drejtat e tyre hyjnë në fushëveprimin e mbrojtjes së nenit 46 të Kushtetutës, dhe nëse ky është rasti, (ii) duhet të vlerësojë nëse Ligji i kontestuar ka “ndërhyrë/kufizuar” të drejtat përkatëse pronësore. Për të konstatuar nëse “ndërhyrja/kufizimi” i tillë ka rezultuar në cenim të të drejtave pronësore, Gjykata duhet të vlerësojë nëse kufizimi i të drejtave të kategorive të lartcekura, (i) është “i përcaktuar me ligj”; (ii) ndjek një “qëllim legjitim”; dhe (iii) është “proporcional” me qëllimin e ndjekur. Kriteret e lartcekura, Gjykata do t’i shtjellojë për secilën kategori, përkatësisht për (i) veteranët e UÇK-së; (ii) personat e verbër; dhe (iii) personat paraplegjik dhe tetraplegjik.

(i) *Veteranët e UÇK-së*

163. Gjykata rikujton që Ligji nr. 04/L-261 për Veteranët e Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, përkatësisht Ligji për Veteranët i vitit 2014, për aq sa është relevante për rrethanat e rastit konkret, ka përcaktuar (i) kategorizimin e veteranëve të UÇK-së sipas nenit 4 (Kategorizimi i veteranëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës) të tij; dhe (ii) të drejtat në beneficione për veteranët luftëtarë të UÇK-së, në Kreun IV të tij. Siç është sqaruar më lart, neni 18 (Lartësia e shumës së pensioneve), kishte përcaktuar që varësisht nga mundësitë buxhetore, kostoja e jetesës dhe inflacioni eventual, në fund të çdo viti për vitin e ardhshëm, Qeveria e Kosovës me propozimin e Ministrisë së Financave me vendim të veçantë, mund të vendosë për lartësinë e shumës së pensionit të Veteranit Luftëtar të UÇK-së, e cila “nuk mund të jetë më e vogël se paga minimale

e përcaktuar në Kosovë”. Gjykata vëren që bazuar në këtë dispozitë, Qeveria e Kosovës, kishte diskrecionin e përcaktimit të lartësisë së shumës së pensioneve, varësisht nga mundësitë buxhetore, kostoja e jetesës dhe inflacioni eventual, me kushtin që lartësia e pensionit të mos jetë më e ulët se paga minimale në Republikën e Kosovës. Siç është sqaruar më lart, kjo dispozitë u ndryshua, përkatësisht u eliminua përmes ndryshimit dhe plotësimit të Ligjit të Veteranëve në vitin 2017. Më saktësisht ky i fundit, (i) shton nenin 16A; dhe (ii) eliminon nenin 18 të ligjit bazik.

164. Përmes nenit 16A të Ligjit për Veteranët të vitit 2017, përcaktohet (i) kategorizimi në tri kategori i veteranit të UÇK-së, në përputhje me kohën e mobilizimit dhe shërbimit në UÇK; (ii) pensioni mujor i veteranit, përkatësisht për kategorinë e parë, dyqind e pesëdhjetë (250) euro, kategorinë e dytë, njëqind e shtatëdhjetë (170) euro dhe kategoria e tretë, njëqind e njëzet (120) euro; dhe (iii) që buxheti i përgjithshëm, për realizimin e pagesës së pensionit të Veteranit Luftëtar të UÇK-së, shfrytëzohet tërësisht gjatë vitit për këtë destinim dhe nuk mund të tejkalojë 0.7% të Bruto Prodhimit Vendor në vit dhe në rast të tejkalimit të 0.7% të Bruto Prodhimit Vendor, atëherë reduktimi i pensionit ndodhë në mënyrë proporcionale për të gjithë përfituesit nga ky ligj. Është me rëndësi të theksohet që sipas nenit të lartcekur, një rregullim i tillë zbatohet pas kategorizimit përfundimtar, ndërsa deri në kategorizimin përfundimtar të listës së Veteranit Luftëtar të UÇK-së, skema pensionale zbatohet siç është paraparë me ligjin bazik. Thënë këtë, neni i cili përcaktonte lartësinë e shumës së pensioneve duke e ndërlidhur lartësinë e pensioneve me garancinë e pagës minimale, ishte fshirë përmes nenit 5 të Ligjit për Veteranët të vitit 2017. Për pasojë, Gjykata thekson që pa marrë parasysh që Ligji i vitit 2017, saktëson që dispozitat e ligjit bazik, përkatësisht atij të vitit 2014, do të jenë të aplikueshme deri në kategorizimin përfundimtar të listës së veteranit të UÇK-së, përmes fshirjes së nenit 18 të Ligjit bazik, që në vitin 2017 ishte eliminuar garancia që lartësia e shumës së pensionit të veteranit të jetë e ndërlidhur me të paktën nivelin e pagës minimale në Republikën e Kosovës.
165. Ky Ligj, përkatësisht Ligji i vitit të 2017, i është nënshtuar vlerësimit të kushtetutshmërisë nga ana e Gjykatës Kushtetuese përmes Aktgjykimit në rastin [KO01/17](#), (shih, Aktgjykimin e Gjykatës në rastin [KO01/17](#), me parashtrues *Aida Dërguti dhe 23 deputetë të tjerë të Kuvendit të Republikës së Kosovës*). Parashtruesit përkatës, para Gjykatës, ndër të tjera, kishin pretenduar që Ligji për Veteranët i vitit 2017, ishte në kundërshtim me nenet 24 [Barazia para ligjit], 46 [Mbrojtja e pronës] dhe 51 [Mbrojtja shëndetësore dhe sociale] të Kushtetutës, në esencë dhe ndër të tjera, sepse (i) ligji i lartcekur diskriminonte personat pjesëmarrës në luftën çlirimtare dhe të cilët jetonin në ndonjë shtet tjetër dhe të cilët ishin përjashtuar nga e drejta e beneficioneve; dhe (ii) eliminimi i nenit 18 të ligjit bazik, përjashtonte referencën, përkatësisht garancitë që benefitet e veteranëve nuk mund të jenë më të ulëta se paga minimale në Republikën e Kosovës, duke pretenduar gjithashtu që eliminimi i kësaj garancie është në kundërshtim me “*prijtjet legjitime*” dhe “*të drejtën në pronë*” të veteranëve të UÇK-së (shih, Aktgjykimin e Gjykatës në rastin [KO01/17](#), paragrafët 35-48).
166. Në vlerësimin e kushtetutshmërisë së Ligjit për Veteranët të vitit 2017, Gjykata kishte shpallur në kundërshtim me Kushtetutën, paragrafin 2 të nenit 3 të Ligjit nr. 04/L-241 për Veteranët e Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, i cili bënte dallimin në të drejtën në përfitimin e beneficioneve në mes veteranit të UÇK-së që jeton në vendet fqinje dhe veteranit të UÇK-së që jeton në shtete tjera (shih, Aktgjykimin e Gjykatës në rastin [KO01/17](#), paragrafët 79-103), ndërsa pjesën tjetër të Ligjit të lartcekur, e kishte vlerësuar në përputhje me Kushtetutën.
167. Vlen të theksohet që në Aktgjykimin [KO01/17](#), Gjykata ka vlerësuar edhe kushtetutshmërinë e nenit 16A të Ligjit të Veteranëve të vitit 2017, dhe i cili eliminonte

nenin 18 të ligjit bazik, përkatësisht Ligjit të Veteranëve të vitit 2014 dhe i cili garantonte, nivelin e pensionit të veteranit të paktën në vlerën e pagës minimale në Republikën e Kosovës. Në vlerësimin e këtij neni, Gjykata kishte shtjelluar parimet e përgjithshme që ndërlidhen me të drejtën në pronë, siç garantohet me nenin 46 [Mbrojtja e pronës] të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 1 (Mbrojtja e pronës) të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, përfshirë në kontekst të pritjeve legjitime, dhe kishte konstatuar që (i) përderisa eliminimi i garancive që ndërlidhej me pagën minimale për kategoritë e veteranëve të UÇK-së, përbënte “ndërhyrje” në të drejtat përkatëse pronësore, kjo “ndërhyrje” ishte kishte një qëllim legjitim dhe ishte proporcionale me qëllimin e ndjekur. Në këtë kontekst, Gjykata, ndër të tjera, kishte vënë theks në faktin që (i) legjislacioni në fuqi që parasheh pagesën e një të drejte për beneficion të mirëqenies, duhet të konsiderohet se gjeneron një interes pronësor që hyn në sferën e nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së dhe se një ndërhyrje në këto të drejta, mund të rezultojë nëse pezullimi ose zvogëlimi i një pensioni nuk është si pasojë e ndonjë ndryshimi në vetë rrethanat e parashtruesit, por është si pasojë e ndryshimeve në ligj ose në zbatimin e tij, megjithatë, fakti që një person ka hyrë dhe bën pjesë në një sistem të sigurimit social shtetëror, nuk do të thotë domosdoshmërisht që sistemi nuk mund të ndryshojë, si për nga kushtet e kualifikueshmërisë së pagesës apo për nga shuma e beneficionit ose pensionit (shih, Aktgjykimin e Gjykatës në rastin [KO01/17](#), paragrafët 149, 150 dhe 151); dhe (ii) ligjvënësi gëzon një margjinë më specifike të vlerësimit të lirë kur bëhet fjalë për masat e përgjithshme të strategjisë sociale, për më tepër që reduktimi i shumës është brenda kornizës së arsyeshme dhe aplikohet në mënyrë të barabartë për të gjitha kategoritë e veteranëve të UÇK-së (shih, Aktgjykimin e Gjykatës në rastin [KO01/17](#), paragrafët 181 dhe 183).

168. Gjykata, në vlerësimin që fshirja e nenit 18 të Ligjit për Veteranët të vitit 2014, përkatësisht eliminimi i garancisë që niveli i lartësisë së shumës së pensionit është i ndërlidhur të paktën me nivelin e pagës minimale në Republikën e Kosovës, nuk ishte në kundërshtim me Kushtetutën, gjithashtu kishte theksuar që (i) neni 18 i Ligjit për Veteranët të vitit 2014, rezultonte në të drejta pronësore sipas nenit 46 të Kushtetutës dhe nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së; (ii) që Ligji i vitit 2017, që eliminonte këtë nen, rezultonte në “ndërhyrje” në të drejtat pronësore të veteranëve të UÇK-së, por që (iii) një “ndërhyrje” e tillë, ishte e (i) përcaktuar me ligj; (ii) ndiqte një qëllim legjitim; dhe (iii) ishte proporcionale me qëllimin e ndjekur. Në kontekst të kësaj të fundit, Aktgjykimi i Gjykatës [KO01/17](#), gjithashtu vë në pah faktin që Ligji për Veteranët i vitit 2017 (i) përcakton lartësinë e pensioneve për të tri kategoritë e veteranëve të UÇK-së; dhe (ii) përcakton që buxheti i përgjithshëm, për realizimin e pagesës së pensionit të Veteranit Luftëtar të UÇK-së, shfrytëzohet tërësisht gjatë vitit për këtë destinim dhe nuk mund të tejkalojë 0.7% të Bruto Prodhimit Vendor në vit dhe në rast të tejkalimit të 0.7% të Bruto Prodhimit Vendor, atëherë reduktimi i pensionit ndodhë në mënyrë proporcionale për të gjithë përfituesit nga ky ligj (shih, Aktgjykimin e Gjykatës në rastin [KO01/17](#), paragrafët 172-174).
169. Nën sqarimet e mësipërme, Gjykata thekson që çdo çështje që ndërlidhet me eliminimin e garancisë së lartësisë së shumës së pensionit të veteranit të UÇK-së të paktën në nivelin e pagës minimale në Republikën e Kosovës, është përmbyllur përmes Ligjit të Veteranëve të vitit 2017. Për më tepër, përmes Aktgjykimit të saj në rastin [KO01/17](#), Gjykata kishte shpallur që neni 5 i Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-241 për Veteranët e Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, me të cilin ishte fshirë neni 18 i Ligjit nr. 04/L-241 për Veteranët e Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, është në pajtueshmëri me Kushtetutën.
170. Gjykata rikujton që neni 2 i Ligjit të kontestuar zëvendëson vetëm paragrafin 3.1 të nenit 16A të Ligjit për Veteranët të vitit 2017, sipas të cilit “*deri në kategorizimin përfundimtar të listës së Veteranit Luftëtar të UÇK-së, skema pensionale zbatohet siç*

është paraparë me ligjin bazik”, duke përcaktuar që deri në kategorizimin përfundimtar të listës së Veteranit të UÇK-së, Qeveria e Kosovës, me propozimin e Ministrisë së Financave, vendos për lartësinë e shumës së pensioneve, varësisht nga mundësitë buxhetore, kostoja e jetës dhe inflacioni eventual. Ligji bazik e të cilit i referohet paragrafi 3.1 i nenit 16A të Ligjit për Veteranët i vitit 2017, është Ligji për Veteranët i vitit 2014, dhe i cili në nenin 18 të tij, përcakton garancinë ndërlidhur me pagën minimale për sa i përket lartësisë së pensionit të veteranit. Thënë këtë, zbatimi i nenit 2 të Ligjit të kontestuar, është i kushtëzuar nga dy dispozita tjera të Ligjit për Veteranët të vitit 2017, përkatësisht (i) paragrafit 4 të nenit 16A sipas të cilit, pensioni mujor i Veteranit Luftëtar, për kategoria e parë, është dyqind e pesëdhjetë (250) euro, për kategoria e dytë, është njëqind e shtatëdhjetë (170) euro dhe për kategoria e tretë, njëqind e njëzet (120) euro; dhe (ii) paragrafit 2 të nenit 16A, sipas të cilit, buxheti i përgjithshëm, për realizimin e pagesës së pensionit të Veteranit Luftëtar të UÇK-së, shfrytëzohet tërësisht gjatë vitit për këtë destinim dhe nuk mund të tejkalojë 0.7% të Bruto Prodhimit Vendor në vit.

171. Në kontekstin e lartcekur, Gjykata vëren që (i) përderisa ndërlidhshmëria e nivelit të pensionit me pagën minimale në Republikën e Kosovës është eliminuar që në vitin 2017, duke marrë parasysh që nuk është bërë kategorizimi përfundimtar i listës së veteranit të UÇK-së, këta të fundit, bazuar në paragrafin 3.1 të nenit 16A të Ligjit për Veteranët të vitit 2017, kanë vazhduar të paguhen bazuar në nenin 18 të ligjit bazik, përkatësisht Ligjit për Veteranët të vitit 2014; dhe që (ii) duke e ndryshuar paragrafin 3.1 të nenit 16A të Ligjit për Veteranët të vitit 2017, neni 2 i Ligjit të kontestuar ndërprente ndërlidhjen e nenit 16A të Ligjit për Veteranët të vitit 2017 me nenin 18 të Ligjit për Veteranët të vitit 2014, duke e lënë përcaktimin e lartësisë së pensionit të veteranëve në diskrecionin e Qeverisë së Kosovës, deri atëherë kur të jetë bërë kategorizimi përfundimtar i listës së veteranit të UÇK-së.
172. Bazuar në sqarimin e lartcekur, rezulton neni 2 i Ligjit të lartcekur, nuk eliminon ndërlidhjen ligjore të lartësisë së pensionit të veteranit me pagën minimale, por ka efektin e ndryshimit të mundshëm të lartësisë së këtij pensioni sipas përcaktimeve të vet Qeverisë. Rrjedhimisht, Gjykata thekson që ndërlidhja e vetme e nenit 2 të Ligjit të kontestuar me garancinë për nivelin e pagës minimale në Republikën e Kosovës dhe e cila është eliminuar në vitin 2017, është koha e nevojshme për kategorizimin përfundimtar të listës së veteranëve të UÇK-së. Kategorizimi përfundimtar i listës së veteranëve nuk është bërë që nga miratimi i Ligjit të vitit 2017, përkundër faktit që i njëjti në nenin 8 (Nxjerrja e akteve nënligjore) të tij përcaktonte një afat prej gjashtë (6) muajsh pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, nxjerr aktet nënligjore.
173. Në kontekstin e lartcekur dhe në përcaktimin nëse ndryshimi dhe plotësimi i nenit 16A të Ligjit për Veteranët të vitit 2017 përmes nenit 2 të Ligjit të lartcekur, ngërthen të drejta pronësore për kategorinë e veteranëve të UÇK-së, nuk është kontestuese ndërlidhshmëria e lartësisë së pensioneve me pagën minimale, sepse kjo çështje është zgjidhur përmes Ligjit për Veteranët të vitit 2017 dhe Aktgjykimit të Gjykatës [KO01/17](#). Kontestuese në rrethanat e vlerësimit të nenit 2 të Ligjit të kontestuar, është nëse koha e nevojshme deri në kategorizimin përfundimtar të listës së veteranëve të UÇK-së, mund të ngritë *“pritje legjitime”* në lidhje me të *“hyrat e ardhshme”* të veteranëve të UÇK-së për qëllimet të garancive që ngërthen neni 46 i Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.
174. Siç është shtjelluar në parimet e përgjithshme si më sipër, Gjykata rikujton që bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së në interpretimin e nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, koncepti i *“pasurisë”*, në parim, përfshinë si *“pasuritë ekzistuese”* ashtu edhe pasuritë e pretenduara, në lidhje me të cilat, një parashtrues i kërkesës mund të argumentojë se ai ose ajo ka të paktën një *“pritshmëri legjitime”*. Në rrethanat e rastit

konkret, nuk është kontestuese që nuk kemi të bëjmë me “pasuritë ekzistuese”, por me pasuri të së ardhmes ndërlidhur me të cilat ka një “prishmëri legjitime”. Në mënyrë që një “pritje” të jetë “legjitime”, ajo duhet të jetë e një natyre më konkrete se sa një shpresë e thjeshtë dhe të bazohet në një dispozitë ligjore ose një akt ligjor si vendimi gjyqësor, që ka të bëjë me interesin pasuror në fjalë. Në rrethanat e rastit konkret, dhe siç është sqaruar më sipër, dhe marrë parasysh Ligjin e Veteranëve të vitit 2017 dhe Aktgjykimin pasues të Gjykatës në rastin [KO01/17](#), “pritja legjitime” nuk ndërlidhet me tej me garancinë e lartësisë së pensioneve të paktën në nivelin e pagës minimale, por me mënyrën e përcaktimit të lartësisë së këtij pensioni “*deri në kategorizimin përfundimtar të listës së veteranëve*”. Në këtë kontekst, Gjykata thekson që vonesat në zbatimin e ligjeve të aplikueshme apo shpresa e thjeshtë për vonesat ndërlidhur me kategorizimin përfundimtar të listës së veteranëve të UÇK-së, nuk mund të ngërthejnë “*pritje legjitime*” lidhur me pasurinë, përkatësisht “*të hyrat e ardhshme*”, në kontekst të të drejtave pronësore.

175. Për pasojë, dhe marrë parasysh (i) konstatimet e Aktgjykimit të Gjykatës në rastin [KO01/17](#), lidhur me garancitë që ndërlidhin nivelin e lartësisë së pensionit të veteranit të UÇK-së të paktën në nivelin e pagës minimale në Republikën e Kosovës; (ii) faktin që vonesat ndërlidhur me zbatimin e Ligjit për Veteranët e UÇK-së të vitit 2017 në kontekst të kategorizimit të Listave të Veteranëve të UÇK-së, nuk mund të rezultojnë në “*pritje legjitime*” ndërlidhur me të “*hyrat e ardhshme*”, përkatësisht nuk rezultojnë në garanci për vazhdimin e lartësisë së pagesës së pensionit të paktën në nivelin e pagës minimale në Republikën e Kosovës.

176. Për pasojë dhe bazuar në sqarimet si më sipër, Gjykata konstaton që neni 2 i Ligjit të kontestuar, nuk është në kundërshtim me nenin 46 të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.

(ii) Personat e verbër

177. Gjykata rikujton që Ligji për Personat e Verbër në nenin 7 (Të ardhurat dhe beneficinet) të tij, përcakton që personat e verbër të përcaktuar me këtë ligj, marrin nga buxheti shtetëror “*kompensimin në një shkallë të caktuar bazuar në pagën minimale*” në Kosovë, por “*jo më pak se njëqind (100) euro në muaj*” dhe përcaktohet me akt nënligjor të nxjerrë nga Qeveria. Neni 3 i Ligjit të kontestuar ndryshon këtë dispozitë duke përcaktuar që Qeveria e Kosovës, me propozimin e Ministrisë së Financave, vendos për lartësinë e shumës së kompensimeve për personat e verbër, varësisht nga mundësitë buxhetore, kostoja e jetës dhe inflacioni eventual.

178. Në kontekstin e lartcekur, Gjykata fillimisht vëren që neni 7 i Ligjit për Personat e Verbër, përderisa i referohet pagës minimale, nuk përcakton garancinë e pagesës së kompensimit përkatës në nivelin e pagës minimale. Në fakt, neni i lartcekur saktëson që niveli i kompensimit bazohet “*në një shkallë të caktuar bazuar në pagën minimale në Kosovë*”, duke mos e përcaktuar të njëjtën, por duke garantuar që niveli i kompensimit, nuk mund të jetë më pak se njëqind (100) euro në muaj. Neni 3 i Ligjit të kontestuar, eliminon këtë garanci, duke i lënë në diskrecion Qeverisë që lartësinë e kompensimit për personat e verbër, me propozimin e Ministrisë përgjegjëse për financa të vendosë për lartësinë e shumës së kompensimeve për përfituesit e këtij ligji varësisht nga (i) mundësitë buxhetore, (ii) kostoja e jetesës, dhe (iii) inflacionit eventual.

179. Gjykata vëren që përcaktimet e Ligjit për Personat e Verbër, dallojnë nga përcaktimet e Ligjit për Veteranët dhe Ligjit për Personat Paraplegjik dhe Tetraplegjik. Kjo sepse, siç është shtjelluar më lart (i) Ligji për Veteranët është i vetmi ligj që garanton lartësinë e pensionit mujor të paktën në lartësinë e pagës minimale në Republikën e Kosovës, garanci kjo e cila është eliminuar përmes Ligjit për Veteranët të vitit 2017; (ii) Ligji për

Personat Paraplegjik dhe Tetraplegjik, nuk ngërthen garancinë e lartësisë së kompensimit të paktën në nivelin e pagës minimale në Kosovë, por në një shkallë të caktuar të saj, për më tepër që gjithashtu përcakton diskrecionin e Qeverisë për të ndryshuar dhe zvogëluar këtë shumë në rrethana të caktuara; ndërsa (iii) Ligji për Personat e Verbër, përderisa nuk ngërthen garancinë e lartësisë së kompensimit të paktën në nivelin e pagës minimale në Kosovë, por në një shkallë të caktuar të saj, përcakton pragun e ulët të këtij kompensimi mujor, përkatësisht faktin që i njëjti nuk mund të jetë “*më pak se njëqind (100) euro në muaj*”. Siç është sqaruar më lart, neni 3 i Ligjit të kontestuar, eliminon këtë garanci, duke i lënë në diskrecion Qeverisë që lartësinë e kompensimit për personat e verbër varësisht nga (i) mundësitë buxhetore, (ii) kostoja e jetesës, dhe (iii) inflacionit eventual.

180. Në kontekstin e lartcekur, Gjykata rikujton që personat e verbër dhe të cilët hyjnë në fushëveprimin e Ligjit për Personat e Verbër, kanë një të drejtë ligjore për kompensim mujor të paktën në vlerën prej njëqind (100) eurosh. Të njëjtit rrjedhimisht, kanë një të drejtë të fituar që ndërlihet me “*të hyrat e ardhshme*” dhe “*pensionet dhe përfitimet sociale*”, përfshirë nivelin e kompensimit në shumën e lartcekur, dhe të cilat, praktika gjyqësore e GJEDNJ-së i kualifikon si të drejta pronësore. Nuk është kontestuese, sipas shtjellimeve të parimeve të përgjithshme në këtë Aktgjykim, që një e drejtë konkrete e cila bazohet në ligjin e aplikueshëm, gjithashtu ngërthen “*prirje legjitime*” në kuptim të nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së dhe nenit 46 të Kushtetutës. Gjykata ripërsëritë, se në krahasim me ligjin aktual, ndryshimi që sjellë Ligji i kontestuar, përkundër që i njëjti nuk saktëson lartësinë e kompensimit, ka pasojën e humbjes së garancisë ligjore që lartësia e kompensimit për këtë kategori personash nuk do të bie nën vlerën prej njëqind (100) eurosh.
181. Për të shqyrtuar pretendimet e parashtruesve të kërkesës në lidhje me shkeljen e nenit 46 të Kushtetutës dhe nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, duke pasur parasysh konstatimin e lartcekur të Gjykatës se “*të hyrat e ardhshme*” të paktën në nivelin e vlerës prej njëqind (100) eurosh për personat e verbër, përbëjnë “*pasuri*” në kuptim të këtyre neneve, Gjykata, në vijim, duhet të zbatojë testin e përcaktuar tek parimet e përgjithshme, që përbëhet prej katër (4) hapave dhe respektivisht duhet të përcaktojë: (1) nëse ka pasur ndërhyrje/kufizime në gëzimin paqësor të pronës dhe nëse ky është rasti, më tej të përcaktojë (2) nëse ndërhyrja/kufizimi përkatës në gëzimin paqësor të pronës është i “*përcaktuar me ligj*”; (3) nëse ndërhyrja/kufizimi në gëzimin paqësor të pronës ka pasur një “*qëllim legjitim*”; dhe (4) nëse ndërhyrja/kufizimi në gëzimin paqësor të pronës është “*proporcionale*”.
182. Fillimisht, Gjykata vëren që neni 3 i Ligjit të kontestuar nuk e përcakton vlerën e kompensimit për personat e verbër, duke e lënë të njëjtin në diskrecionin e Qeverisë në varësi të mundësive buxhetore, koston së jetës dhe inflacionit eventual. Gjykata, thekson se nuk është kontestuese që eliminimi i garancisë ligjore për kompensim për personat e verbër të paktën në vlerën prej njëqind (100) euro në muaj, përbën “*ndërhyrje/kufizim*” në të drejtat pronësore të kësaj kategorie të qytetarëve të Republikës së Kosovës. Për më tepër, nuk është kontestuese që një ndërhyrje/kufizim i tillë, (i) është i “*përcaktuar me ligj*”, përkatësisht me nenin 3 të Ligjit të kontestuar; dhe (ii) ndjek një “*qëllim legjitim*”, e në përcaktimin e politikave publike që ndërlihen me menaxhimin e buxhetit të Republikës së Kosovës dhe harmonizimin e ligjeve të aplikueshme ndërlihur me sigurimet/sistemin e pensioneve dhe atë të kompensimit për kategoritë përkatëse. Thënë këtë, në rrethanat e rastit konkret, Gjykata duhet të vlerësojë, nëse një ndërhyrje/kufizim i tillë i të drejtave të personave të verbër është proporcional me qëllimin e ndjekur.
183. Në këtë kontekst, Gjykata rikujton që për të qenë në pajtim me rregullin e përgjithshëm të përcaktuar në fjalinë e parë të paragrafit të parë të nenit 1 të Protokollit nr. 1 të

KEDNJ-së, “ndërrhyrja” në të drejtën e gëzimit paqësor të “pronës”, përveç që duhet të jetë e “përcaktuar me ligj” dhe të ndjek një “qëllim legjitim”, duhet të rezultojë me “ekuilibër të drejtë” mes kërkesave të interesit publik dhe detyrimeve për të mbrojtur të drejtat themelore të individit (shih, ndër të tjera, rastet e GJEDNJ-së, *Beyeler kundër Italisë, nr 78630/11, Aktgjykim i 11 tetor 2022*, paragrafi 107; *Ališić dhe të tjerët kundër Bosnjë e Hercegovinës, Kroacisë, Serbisë dhe ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë*, i cituar më lart, paragrafi 108 dhe rastin e Gjykatës, *KI185/21*, parashtrues *SHPK “Co Colina”*, cituar më lart, paragrafi 211). Më saktësisht, në rastet që përfshihen shkelje të pretenduara të nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, Gjykata duhet të vlerësojë nëse për arsye të veprimit apo mosveprimit të shtetit, individi bartë një barrë joproporcionale dhe të tepërt. Gjatë vlerësimit të pajtueshmërisë me këtë kërkesë, Gjykata, bazuar në praktikën e lartcekur, duhet të bëjë një shqyrtim të gjithmbarshëm “të interesave të ndryshme në këtë çështje”, duke pasur parasysh se KEDNJ ka për qëllim të mbrojë të drejtat të cilat janë “praktike dhe efektive” dhe jo “iluzore”. Në këtë kontekst, duhet theksuar se pasiguria - qoftë legjislative, administrative apo që lind nga praktikat e aplikuara nga autoritetet publike - është faktor që merret parasysh gjatë vlerësimit të veprimeve të një shteti (shih, ndër të tjera, rastin e GJEDNJ-së, *Broniowski kundër Polonisë*, të cituar më lart, paragrafi 151 dhe rastin e Gjykatës, *KI185/21*, parashtrues *SHPK “Co Colina”*, cituar më lart, paragrafi 212).

184. Në vlerësimin nëse “ndërrhyrja” në të drejtat e personave të verbër duke eliminuar garancitë ligjore që kompensimi mujor nuk mund të jetë më i ulët se njëqind (100) euro, Gjykata fillimisht i referohet praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, sipas të cilës dhe ndër të tjera, (i) personat me aftësi të kufizuara janë të identifikuar si kategori e cila është specifikisht e marginalizuar, dhe që historikisht i është nënshtruar diskriminimit dhe paragjyqimeve duke rezultuar në izolimin e tyre në shoqëri; dhe që për pasojë (ii) margjina e vlerësimit të shteteve në kufizimin e të drejtave të kësaj kategorie, është substancialisht më e kufizuar dhe shtetet duhet të kenë arsye shumë serioze për të ndërhyrë në këto të drejta (shih, ndër të tjera, rastet e GJEDNJ-së, *Glor kundër Zvicrës*, nr.13444/04, Aktgjykim i 30 prillit 2009, paragrafi 84; *Guberina kundër Kroacisë*, nr. 23682/13, Aktgjykim i 22 marsit 2016, paragrafi 73).
185. Në këtë kontekst, Gjykata rikujton nenin 7 të Kushtetutës bazuar në të cilin, rendi kushtetues i Republikës së Kosovës bazohet, ndër të tjera, në parimet e respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut dhe sundimit të ligjit, mosdiskriminimit, të drejtës së pronës dhe drejtësisë sociale. Në anën tjetër, Gjykata gjithashtu rikujton nenin 51 të Kushtetutës, bazuar në të cilin, sigurimi social themelor, që ka të bëjë me papunësinë, sëmundjen, aftësitë e kufizuara dhe moshën e shtyrë, rregullohet me ligj. Përderisa neni 51 i Kushtetutës, saktëson që sigurimi social themelor përkatës rregullohet me ligj, ky i fundit, gjithashtu i nënshtrohet garancive që burojnë nga Kushtetuta, përfshirë parimit të sigurisë juridike. Ky i fundit, është shtjelluar detajisht përmes Opinioneve të Komisionit të Venecias, praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së por edhe asaj të Gjykatës, dhe për aq sa është relevante në rrethanat e rastit konkret, gjithashtu ngërthen detyrimin që dispozitat relevante të ligjit të jenë “të qarta, të qasshme dhe të parashikueshme”. “Parashikueshmëria”, bazuar në parimet e lartcekura, kërkon që ligji të formulohet me precizitet dhe qartësi të duhur që t’iu mundësojë subjekteve juridike që të rregullojnë sjelljen e tyre respektivisht (shih, ndër të tjera, Listën Kontrolluese të Sundimit të Ligjit të Komisionit të Venecias, *CDL-Ad(2016)007*, Strasburg, 18 mars 2016, paragrafët 58 dhe 59; dhe ndër të tjera, rastet e Gjykatës *KO100/22* dhe *KO101/22*, cituar më lart, paragrafi 347).
186. Neni 3 i Ligjit të kontestuar, (i) eliminon në tërësinë e tij garancinë ligjore që kompensimi mujor për personat e verbër në Republikën e Kosovës të jetë të paktën në vlerën prej njëqind (100) euro në muaj; (ii) në eliminimin e kësaj garancie, përcaktimin

e shumë së kompensimit për këtë kategori personash e lë në diskrecion të Qeverisë, duke përcaktuar që Qeveria e Republikës së Kosovës me propozim të Ministrisë përgjegjëse për Financa, vendos për lartësinë e shumë së kompensimeve për përfituesit e këtij ligji varësisht nga (a) mundësitë buxhetore, (b) kostoja e jetesës, dhe (c) inflacioni eventual. Thënë këtë, Gjykata konsideron që Ligji i kontestuar në nenin 4 të tij përcakton si garanci ligjore parametrat respektiv në bazë të të cilëve personave të verbër u përcakton siguri dhe parashikueshmëri, duke u mundësuar të njëjtëve që përshtatshëmrisht të rregullojnë sjelljen dhe pritshmëritë përkatëse lidhur me një të drejtë esenciale të tyre, përkatësisht sigurimin social themelor dhe të cilën e kanë fituar bazuar në ligjin e aplikueshëm, përkatësisht Ligjin për Personat e Verbër.

187. Në rrethana të tilla, dhe marrë parasysh (i) kompetencën e Kuvendit për të përcaktuar politikat sociale të Republikës në një rën anë; por edhe (ii) faktin në rrethanat e rastit konkret nuk është kontestuese e drejta e personave të verbër për beneficione dhe/ose kompensim mujor; dhe (iii) faktin që Ligji i kontestuar nuk e përcakton dhe as nuk e zvogëlon shumë e këtyre beneficioneve dhe/ose kompensimeve, Gjykata konstaton që neni 3 i Ligjit të kontestuar nuk është në kundërshtim me nenin 46 të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.
188. Thënë këtë dhe marrë parasysh (i) vlerat e Kushtetutës së Republikës ndërlidhur me drejtësinë sociale dhe të drejtat dhe liritë themelore; (ii) rëndësinë e kësaj kategorie të qytetarëve sipas Kushtetutës, por edhe praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së; (iii) nenin 51 [Mbrotjtja Shëndetësore dhe Sociale] të Kushtetutës dhe i cili ndër të tjera garanton sigurimin social themelor që ka të bëjë me papunësinë, sëmundjen, aftësitë e kufizuara dhe moshën e shtyrë në mënyrën e rregulluar me ligj; dhe (iv) faktin që margjina e vlerësimit të shteteve në kufizimin e të drejtave të kësaj kategorie, është substancialisht më e kufizuar dhe shtetet duhet të kenë arsye shumë serioze për të ndërhyrë në këto të drejta, përfshirë mundësinë e zvogëlimit të kompensimeve përkatëse, Gjykata thekson që zbritja eventuale e lartësisë së të “*hyrave të ardhshme*”, përfshirë në kontekst të “*pensioneve dhe beneficioneve sociale*”, të personave të verbër duhet të jetë gjithnjë proporcionale me qëllimin legjitim të ndjekur dhe në këtë kontekst, çdo zbritje eventuale, përfshirë nën pragun minimal prej njëqind (100) eurosh, mund të kontestohet dhe t’i nënshtrohet vlerësimit të ligjshmërisë dhe/ose kushtetutshmërisë, përkatësisht përputhshmërisë me të drejtat dhe liritë themelore.

(iii) Personat paraplegjik dhe tetraplegjik

189. Gjykata rikujton që Ligji për Personat Paraplegjik dhe Tetraplegjik në nenin 7 (Kompensimi) të tij, përcakton që personat paraplegjik dhe tetraplegjik, marrin nga buxheti shtetëror kompensimin “*në një shkallë të caktuar, bazuar në pagën minimale*” në Kosovë, dhe përcaktohet me akt nënligjor të nxjerrë nga Qeveria, sipas propozimit të MPMS-së. Neni 4 i Ligjit të kontestuar ndryshon këtë dispozitë duke përcaktuar që Qeveria e Kosovës, me propozimin e Ministrisë së Financave, vendos për lartësinë e shumë së kompensimeve për personat paraplegjik dhe tetraplegjik, varësisht nga mundësitë buxhetore, kostoja e jetës dhe inflacioni eventual.
190. Në kontekstin e lartcekur, Gjykata fillimisht vëren që neni 7 i Ligjit për Personat Paraplegjik dhe Tetraplegjik, përderisa i referohet pagës minimale, nuk përcakton garancinë e pagesës së kompensimit përkatës në të paktën nivelin e pagës minimale. Në fakt, neni i lartcekur saktëson që niveli i kompensimit bazohet “*në një shkallë të caktuar bazuar në pagën minimale në Kosovë*”, duke mos e përcaktuar të njëjtën, por duke e referuar përcaktimin e të njëjtës nivel të Qeverisë, përmes aktit nënligjor. Neni 4 i Ligjit të kontestuar, ndryshon këtë dispozitë, përkatësisht përcaktimin e lartësisë së kompensimit për këtë kategori personash, duke përcaktuar që Qeveria e Kosovës, me

propozimin e Ministrisë së Financave, vendos për lartësinë e shumës së kompensimeve, varësisht nga mundësitë buxhetore, kostoja e jetës dhe inflacioni eventual.

191. Gjykata gjithashtu vëren që përtej faktit që neni 7 i ligjit të lartcekur, vetëm përcakton që niveli i kompensimit bazohet “*në një shkallë të caktuar bazuar në pagën minimale në Kosovë*”, rrjedhimisht duke mos përcaktuar detyrimisht që niveli i kompensimit të jetë së paku në nivelin e pagës minimale në Republikën e Kosovës siç është rasti me kategorinë e veteranëve të UÇK-së, në nenin 21 të tij, gjithashtu përcakton diskrecionin e Qeverisë për të ndryshuar lartësinë e kompensimit, varësisht nga disponueshmëria e fondeve të mjaftueshme për pagesa të tilla, duke saktësuar gjithashtu që në masën që Qeveria e sheh të domosdoshme për të adresuar rrethanat që krijojnë tendosje të paparapara fiskale në buxhetin publik apo që përndryshe të sigurojë ruajtjen e disiplinës fiskale publike, ajo do të ketë autoritetin që të lëshojë një vendim që redukton apo eliminon çfarëdo beneficioni të siguruar me këtë ligj, përfshirë beneficionet që kanë të bëjnë me pagesa financiare madje edhe nëse janë përvetësuar fondet sipas ligjit të buxhetit të aplikueshëm në atë kohë.
192. Bazuar në sqarimin e lartcekur, Gjykata thekson që bazuar në dispozitat e Ligjit për Personat Paraplegjik dhe Tetraplegjik, (i) nuk ka një garanci ligjore bazuar në të cilën lartësia e kompensimit është e ndërlidhur me nivelin e pagës minimale në Republikën e Kosovës; për më tepër që (ii) Qeveria ka diskrecionin e ndryshimit të lartësisë së kësaj pagese varësisht nga disponueshmëria e fondeve në rast të vështirësive fiskale nën kushtet e përcaktuara në këtë ligj. Në esencë, neni 4 i Ligjit të kontestuar, ndryshon vetëm mënyrën e saktësisë të lartësisë së kompensimit përkatës nga akti nënligjor me propozim të MPMS-së, në vendim të Qeverisë me propozim të Ministrisë përgjegjëse për Financa.
193. Në kontekstin e lartcekur, Gjykata thekson që personat paraplegjik dhe tetraplegjik dhe të cilët hyjnë në fushëveprimin e Ligjit për Personat Paraplegjik dhe Tetraplegjik, kanë një të drejtë ligjore për kompensim mujor. Ky fakt nuk është kontestues dhe nuk është afektuar me nenin 4 të Ligjit të kontestuar. Lartësia e këtij kompensimi nuk është saktësuar as me nenin 7 të Ligjit për Personat Paraplegjik dhe Tetraplegjik dhe as me nenin 4 të Ligjit të kontestuar. Në fakt dhe siç është sqaruar më sipër, përderisa neni 7 i Ligjit për Personat Paraplegjik dhe Tetraplegjik, i referohet pagës minimale, i njëjti nuk përcakton që kompensimet përkatëse duhet të jenë të paktën në nivelin e pagës minimale, por në një shkallë të caktuar të saj, për më tepër që neni 21 i të njëjtit ligj, përcakton diskrecionin e Qeverisë që këtë shumë të ndryshojnë nën kushte të caktuara. Rrjedhimisht, bazuar në dispozitat e Ligjit të aplikueshëm, nuk ka një garanci ligjore ndërlidhur me lartësinë e këtij kompensimi. Në rrethana të tilla, kontestuese është nëse e drejta në kompensim, lartësia e të cilit nuk është përcaktuar në ligjin e aplikueshëm, mund të ngritë “*priti legjitime*” në lidhje me të “*hyrat e ardhshme*” të personave paraplegjik dhe tetraplegjik për qëllime të garancive që ngërthen neni 46 i Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.
194. Siç është shtjelluar në parimet e përgjithshme si më sipër, Gjykata rikujton që bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së në interpretimin e nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, koncepti i “*pasurisë*”, në parim, përfshinë si “*pasuritë ekzistuese*” ashtu edhe pasuritë e pretenduara, në lidhje me të cilat, një parashtrues i kërkesës mund të argumentojë se ai ose ajo ka të paktën një “*pritshmëri legjitime*”. Në rrethanat e rastit konkret, nuk është kontestuese që nuk kemi të bëjmë me “*pasuritë ekzistuese*”, por me pasuri të së ardhmes ndërlidhur me të cilat ka një “*pritshmëri legjitime*”. Në mënyrë që një “*priti*” të jetë “*legjitime*”, ajo duhet të jetë e një natyre më konkrete se sa një shpresë e thjeshtë dhe të bazohet në një dispozitë ligjore ose një akt ligjor si vendimi gjyqësor, që ka të bëjë me interesin pasuror në fjalë. Në rrethanat e rastit konkret, marrë parasysh që nuk është kontestuese e drejta në kompensim mujor, por lartësia e këtij kompensimi

- dhe e cila nuk është e përcaktuar me Ligjin për Personat Paraplegjik dhe Tetraplegjik dhe as nuk ndryshohet dhe/ose zvogëlohet përmes nenit 4 të Ligjit të kontestuar, në vlerësimin e Gjykatës, nuk mund të ketë “*prirje legjitime*” lidhur me pasurinë, përkatësisht “*të hyrat e ardhshme*”, në kontekst të së drejtave pronësore.
195. Në rrethana të tilla, dhe marrë parasysh (i) kompetencën e Kuvendit për të përcaktuar politikatat sociale të Republikës në njërën anë; por edhe (ii) faktin në rrethanat e rastit konkret nuk është kontestuese e drejta e personave paraplegjik dhe tetraplegjik për beneficione dhe/ose kompensim mujor; dhe (iii) faktin që Ligji i kontestuar nuk e përcakton dhe as nuk e zvogëlon shumën e këtyre beneficioneve dhe/ose kompensimeve, Gjykata konstaton që neni 4 i Ligjit të kontestuar nuk është në kundërshtim me nenin 46 [Mbrotjtja e Pronës] të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 1 (Mbrotjtja e pronës) të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.
196. Thënë këtë dhe marrë parasysh (i) vlerat e Kushtetutës së Republikës ndërlidhur me drejtësinë sociale dhe të drejtat dhe liritë themelore; (ii) rëndësinë e kësaj kategorie të qytetarëve sipas Kushtetutës, por edhe praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së; (iii) nenin 51 [Mbrotjtja Shëndetësore dhe Sociale] të Kushtetutës dhe i cili ndër të tjera garanton sigurimin social themelor që ka të bëjë me papunësinë, sëmundjen, aftësitë e kufizuara dhe moshën e shtyrë në mënyrën e rregulluar me ligj; dhe (iv) faktin që margjina e vlerësimit të shteteve në kufizimin e të drejtave të kësaj kategorie, është substancialisht më e kufizuar dhe shtetet duhet të kenë arsye shumë serioze për të ndërhyrë në këto të drejta, përfshirë mundësinë e zvogëlimit të kompensimeve përkatëse, Gjykata thekson që zbritja eventuale e lartësisë së të “*hyrave të ardhshme*”, përfshirë në kontekst të “*pensioneve dhe beneficioneve sociale*”, të personave paraplegjik dhe tetraplegjik duhet të jetë gjithnjë proporcionale me qëllimin legjitim të ndjekur dhe në këtë kontekst, çdo zbritje eventuale e këtyre kompensimeve, mund të kontestohet dhe t’i nënshtrohet vlerësimit të ligjshmërisë dhe/ose kushtetutshmërisë, përkatësisht përputhshmërisë me të drejtat dhe liritë themelore.
197. Në fund dhe në kontekst të kategorisë së personave të verbër dhe atyre paraplegjik dhe tetraplegjik, Gjykata vë theks në Konventën e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara dhe të cilën Kuvendi i Republikës së Kosovës ka propozuar që të përfshijë në rendin kushtetues të Republikës së Kosovës, përkatësisht në listën e instrumenteve ndërkombëtare të saktësuara në nenin 22 të Kushtetutës dhe të cilat, kanë epërsi mbi ligjet e Republikës së Kosovës. Në këtë kontekst, Gjykata rikujton që më 2 gusht 2023, përmes Aktgjykimit në rastin KO207/22, ajo kishte vendosur lidhur me vlerësimin e përputhshmërisë me Kushtetutën e Republikës së Kosovës të amendamentit të propozuar kushtetues që listës së marrëveshjeve dhe instrumenteve ndërkombëtare drejtpërdrejtë të aplikueshme në Republikën e Kosovës, t’i shtohet edhe Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (shih, Aktgjykimin në rastin KO207/22, me parashtrues *Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës*, Aktgjykim i 3 gushtit 2023).
198. Përderisa, Kushtetuta e Republikës së Kosovës, ende nuk është amendamentuar për të përfshirë Konventën e lartcekur në rendin juridik të Republikës së Kosovës, ashtu siç është shtjelluar në Aktgjykimin e Gjykatës KO207/22, përfshirja e një Konvente të tillë në rendin kushtetues, ngërthen detyrime pozitive për të gjitha autoritetet publike në Republikën e Kosovës. Specifikisht, Gjykata rikujton përcaktimet e nenit 28 (Standardet e duhura të jetesës dhe mbrotjtjes sociale) të Konventës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara dhe obligimet e autoriteteve, respektivisht shteteve palë që të njohin të drejtën e personave me aftësi të kufizuara për një standard të përshtatshëm jetese për veten dhe familjet e tyre, duke përfshirë ushqimin, veshjen dhe strehimin e duhur, dhe për përmirësimin e vazhdueshëm të kushteve të jetesës, dhe detyrimin për të ndërmarrë hapat e duhur për

të mbrojtur dhe nxitur realizimin e këtyre të drejtave pa diskriminim në bazë të aftësisë së kufizuar.

3. Vlerësimi i kushtetutshmërisë së nenit 6 të Ligjit të kontestuar me nenin 51 [Mbrojtja Shëndetësore dhe Sociale] të Kushtetutës

A. Thelbi i pretendimeve dhe kundërargumentet e palëve

199. Gjykata rikujton që parashtruesit e kërkesës pretendojnë që neni 6 i Ligjit të kontestuar, dhe përmes të cilit Qeverisë i mundësohet, që në mungesë të propozimit të Këshillit Ekonomiko-Social, të përcaktojë pagën minimale në mënyrë të pavarur nga Këshilli Ekonomiko-Social, nuk është në përputhje me vlerat kushtetuese të drejtësisë sociale, ndër të tjera, sepse përkundër faktit që Këshilli Ekonomiko-Social dhe çështjet që ndërlidhen me përcaktimin e pagës minimale, nuk janë të saktësuara në Kushtetutë, drejtësia sociale si parim i rendit kushtetues, duhet të interpretohet sipas ONP-së dhe Konventës për Caktimin e Pagës Minimale, e cila saktëson që autoritetet kompetente, në marrëveshje ose pas konsultimit të plotë me organizatat përfaqësuese të punëdhënësve dhe punëtorëve, përcakton pagën minimale. Në esencë, pretendimet e parashtruesve të kërkesës, mbështeten edhe nga Avokati i Popullit.
200. Në anën tjetër, Ministria e Financave dhe Grupi Parlamentar i LVV-së, kundërargumentojnë, duke theksuar që (i) mënyra e caktimit të pagës minimale nuk është çështje kushtetuese; (ii) Republika e Kosovës nuk është anëtare e ONP-së, e as nuk i ka të ratifikuara konventat e saj; ndërsa që (iii) edhe po të aplikoheshin standardet që burojnë nga Konventa për Caktimin e Pagës Minimale, neni i kontestuar është në përputhshmëri me të njëjtën sepse, përcakton që Qeveria e cakton pagën minimale pas propozimit të Këshillit Ekonomiko-Social dhe vetëm në mungesë të këtij propozimi, Qeveria mund të vendos vet nivelin e pagës minimale.

B. Vlerësimi i Gjykatës

201. Gjykata fillimisht thekson që neni 57 (Paga minimale) i Ligjit të Punës, përcakton që Qeveria e Kosovës në fund të çdo viti kalendarik përcakton pagën minimale sipas propozimit të Këshillit Ekonomiko-Social. Më tej, Gjykata vëren që, bazuar në nenin e lartcekur, gjatë përcaktimit të pagës minimale duhet të merren parasysh faktorët si në vijim, (i) kostoja e shpenzimeve jetësore; (ii) përqindja e shkallës së papunësisë; (iii) gjendja e përgjithshme në tregun e punës; dhe (iv) shkalla e konkurrencës dhe produktivitetit në vend. Gjithashtu, neni i lartcekur, saktëson që paga minimale përcaktohet në bazë të orëve të punës, për periudhën një (1) vjeçare, e cila publikohet në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, ndërsa paga minimale mund të përcaktohet me marrëveshje në nivel kombëtar, në nivel dege dhe në nivel të ndërmarrjes, por që nuk duhet të jetë më e ulët se paga minimale e paraparë në paragrafin 1 të këtij neni, përkatësisht nivelit të pagës minimale të përcaktuar nga Qeveria sipas propozimit të Këshillit Ekonomiko-Social.
202. Gjykata rikujton që neni 6 i Ligjit të kontestuar, ndryshon dhe plotëson vetëm paragrafin 1 të nenit 57 të Ligjit të Punës, duke e mbajtur detyrimin e Qeverisë që të përcaktojë pagën minimale sipas propozimit të Këshillit Ekonomiko-Social, por duke shtuar mundësinë që vet Qeveria të përcaktojë pagën minimale, në rast se mungon një propozim i tillë.
203. Në kontekst të pretendimeve dhe kundërargumenteve të palëve ndërlidhur me kushtetutshmërinë e nenit të lartcekur, Gjykata fillimisht rikujton që bazuar në (i) nenin 7 [Vlerat] të Kushtetutës, rendi kushtetues i Republikës së Kosovës, ndër të tjera, bazohet në parimet e barazisë, respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut dhe

sundimit të ligjit, mosdiskriminimit, të drejtës së pronës dhe drejtësisë sociale; ndërsa bazuar në (ii) nenin 51 [Mbrojtja Shëndetësore dhe Sociale] të Kushtetutës, (a) kujdesi shëndetësor dhe sigurimi social rregullohen me ligj; dhe (b) sigurimi social themelor, që ka të bëjë me papunësinë, sëmundjen, aftësitë e kufizuara dhe moshën e shtyrë, rregullohet me ligj.

204. Nenet e lartcekura kushtetuese, mbrojtjen sociale, e delegojnë në nivel të rregullimit ligjor, gjithnjë nën kushtin e respektimit të vlerave themelore të Republikës së Kosovës, përfshirë drejtësinë sociale. Sipas sqarimeve të mësipërme, Gjykata thekson që çështjet që ndërlidhen me pagën minimale janë të rregulluara në nivel ligji, përkatësisht Ligjin e Punës, ndërsa më tej janë të saktësuara në nivel të aktit nënligjor, përkatësisht Udhëzimit Administrativ nr. 09/2017 për Caktimin e Pagës Minimale në Republikën e Kosovës.
205. Gjykata vëren që esenciale në rrethanat e rastit konkret është raporti në mes Qeverisë dhe Këshillit-Ekonomiko Social në përcaktimin e pagës minimale në Republikën e Kosovës. Sipas Ligjit të Punës, në përcaktimin e pagës minimale, Qeveria është e kushtëzuar në propozimin e Këshillit Ekonomiko-Social. Në kontekst të këtij të fundit, Gjykata vëren që bazuar në nenin 5 (Këshilli Ekonomiko-Social) të Ligjit nr. 04/L-008 për Këshillin Ekonomiko-Social, ky i fundit është organ i nivelit nacional, i cili udhëheq konsultimet dhe bënë propozime organeve kompetente për çështjet nga marrëdhënia e punës, mirëqenia sociale dhe çështjet e tjera që kanë të bëjnë me politikat ekonomike në Republikën e Kosovës. Këshilli, bazuar në nenin e lartcekur, përbëhet nga (i) pesë (5) përfaqësues të cilët caktohen nga organizatat e të punësuarve; (ii) pesë (5) përfaqësues të cilët caktohen nga organizatat e punëdhënësve; dhe (iii) pesë (5) përfaqësues të cilët caktohen nga Qeveria e Kosovës. Më tej dhe bazuar në nenin 17 (Marrja e vendimeve në KES) të ligjit të lartcekur, vendimet e Këshillit miratohen me dy të tretat (2/3) e votave të anëtarëve të përhershëm të Këshillit. Gjykata vëren që një përbërje e tillë, përfshirë mënyrën e tillë të vendimmarrjes që kërkon një shumicë të kualifikuar, ka për qëllim arritjen e një konsensusi të gjerë në mes të Qeverisë dhe organizatave të punëdhënësve dhe të punësuarve ndërlidhur me përcaktimin e nivelit të pagës minimale në Republikën e Kosovës.
206. Ndryshimet e propozuara përmes nenit 6 të Ligjit të kontestuar, afektojnë këtë kushtëzim, duke përcaktuar që përderisa Qeveria përcakton pagën minimale sipër propozimit të Këshillit Ekonomiko-Social, në mungesë të një propozimi të tillë, Ministri përkatës për Financa, pas informimit të Këshillit Ekonomiko-Social, mund të parashtojë një propozim të tillë në Qeverinë e Kosovës.
207. Bazuar në dispozitën e lartcekur, Gjykata vëren që Qeveria mund të përcaktojë në mënyrë vetanake nivelin e pagës minimale, vetëm atëherë kur Këshilli Ekonomiko-Social dështon të bëjë një propozim të tillë. Në këtë kontekst, Gjykata nuk mund të mos vërë theks në mënyrën e vendimmarrjes në Këshillin Ekonomiko-Social, në përbërjen e të cilit përfaqësuesit që caktohen nga Qeveria përbëjnë një të tretën (1/3) e Këshillit dhe në rast të kundërshtimit të tyre në favor të vendimmarrjes vetanake të Qeverisë, Këshilli Ekonomiko-Social do të mund të propozonte përcaktimin e pagës minimale Qeverisë, duke i pamundësuar Qeverisë që të vepron në mënyrë vetanake, vetëm atëherë kur përfaqësuesit të cilët caktohen nga organizatat e të punësuarve dhe ata të cilët caktohen nga organizatat e punëdhënësve, do të dakordoheshin ndërlidhur me nivelin e pagës minimale në Republikën e Kosovës. Megjithatë, qëndrimet e tyre shpesh herë mund të jenë kundërtëne për shkak të interesave të kundërta që mund të përfaqësojnë. Një situatë e tillë, vendos anëtarët e Këshillit Ekonomiko-Social që caktohen nga Qeveria në avantazh në raport me anëtarët e tjerë të Këshillit Ekonomiko-Social. Një raport i tillë i anëtarëve të Këshillit-Ekonomik Social, në kontekst të mundësisë së Qeverisë që vetë të

përcaktojë pagën minimale, jodetyrimisht favorizon qëllimin e arritjes së një konsensusi të përgjithshëm ndërlidhur me pagën minimale në Republikën e Kosovës.

208. Thënë këtë, Gjykata rithekson që përtej drejtësisë sociale si vlerë e Republikës së Kosovës, çështjet që ndërlidhen me mekanizmat që përcaktojnë pagën minimale janë të rregulluara në nivel ligji. Të njëjtin qëndrim e ndajnë edhe vet parashtruesit e kërkesës dhe palët e interesuara para Gjykatës. Në kontekstin e lartcekur, Gjykata thekson që miratimi i ligjeve është kompetencë e Kuvendit të Republikës së Kosovës, dhe që në rast që të njëjtat kontestohen para Gjykatës, nuk është në kompetencën e kësaj të fundit që të vlerësojë përzgjedhjen e politikës publike nga përfaqësuesit e popullit, por vetëm të vlerësojë nëse janë cenuar dispozitat e Kushtetutës. Siç është sqaruar më lart, kjo e fundit nuk ngërthen norma që e rregullojnë çështjen e mekanizmave të nevojshëm për përcaktimin e pagës minimale në Republikën e Kosovës.
209. Për më tepër, Gjykata vëren që, Republika e Kosovës nuk është anëtare e ONP-së, e as nuk i ka të ratifikuara konventat e saj. Rrjedhimisht, ato nuk janë pjesë e rendit juridik të brendshëm të Republikës së Kosovës. Megjithatë, Gjykata vëren se në hyrje të Ligjit të Punës, theksohet se “*duke pasur parasysh Konventat e Organizatës Ndërkombëtare të Punës [...] me qëllim të krijimit të një baze ligjore funksionale, gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme për marrëdhënien e punës*”. Kjo nënkupton se ligjvënësi gjatë hartimit të Ligjit të Punës ka inkorporuar dhe ka marrë parasysh standardet ndërkombëtare të përcaktuara në konventat e ONP-së, të cilat rregullojnë të drejtat dhe detyrimet që lindin nga marrëdhënia e punës.
210. Bazuar në si më sipër, Gjykata thekson se gjatë interpretimit nëse neni 6 i Ligjit të kontestuar cenon drejtësinë sociale, për aq sa janë relevante, do të referohet edhe në pikëpamjet e ONP-së dhe Konventat relevante të saj, përkatësisht Konventën e ONP-së për Caktimin e Pagës Minimale. Në këtë kontekst, Gjykata vëren se, sipas standardeve të ONP-së, përcaktimi i pagës minimale është një nga mekanizmat që shtetet duhet ta përdorin për të përmbushur drejtësinë sociale. Qëllimi i caktimit të pagës minimale duhet të jetë mbrojtja e punëtorëve të cilët kanë paga shumë të ulëta, dhe ofrimi i kushteve për një jetë të dinjitetshme. Konventa e ONP-së i detyron autoritetet shtetërore në çdo vend që të caktojnë grupet e punëtorëve që mbulohen nga paga minimale, pas marrëveshjes ose konsultimit të plotë me përfaqësuesit e punëtorëve dhe punëdhënësve. Pra, theksi vihet te konsultimi i plotë me të gjithë aktorët relevant.
211. Më saktësisht, Gjykata thekson që Konventa e ONP-së për Caktimin e Pagës Minimale, ndër të tjera, dhe për aq sa është relevante në rrethanat e rastit konkret, në nenin 1 të saj, përcakton që (i) çdo anëtar i ONP-së, i cili ratifikon këtë Konventë, merr përsipër të krijojë një sistem të pagave minimale, i cili mbulon të gjitha grupet e pagë-marrësve, kushtet e punësimit të të cilëve janë të tilla që ai mbulim do të ishte i përshtatshëm; dhe (ii) autoriteti kompetent në secilin vend duhet, në marrëveshje ose pas konsultimit të plotë me organizatat përfaqësuese të interesuara të punëdhënësve dhe të punëmarrësve, kur këto organizata ekzistojnë, të përcaktojë grupet e pagë-marrësve që duhet të mbulohen.
212. Për më tepër, neni 3 i Konventës së lartcekur, përcakton që elementet që duhet të merren parasysh në përcaktimin e nivelit të pagave minimale, për aq sa është e mundur dhe e përshtatshme në lidhje me praktikën dhe kushtet e vendit, përfshijnë (i) nevojat e punëtorëve dhe familjeve të tyre, duke marrë parasysh nivelin e përgjithshëm të pagave në vend, koston e jetesës, përfitimet e sigurimeve shoqërore dhe standardet relative të jetesës së grupeve të tjera shoqërore; dhe (ii) faktorët ekonomikë, duke përfshirë kërkesat e zhvillimit ekonomik, nivelet e produktivitetit dhe dëshirën për të arritur dhe mbajtur një nivel të lartë të punësimit.

213. Gjykata gjithashtu vëren që lidhur me mekanizmin përmes të cilit vendoset paga minimale, neni 4 i Konventës përcakton që (i) çdo anëtar që ratifikon këtë Konventë do të krijojë dhe/ose mirëmbajë një mekanizëm të përshtatshëm me kushtet dhe kërkesat e vendit me anë të të cilave pagat minimale për grupet e pagë-marrësve që mbulohen në pajtim me nenin 1 të Konventës, mund të caktohen dhe rregullohen herë pas herë; (ii) duhet të nxirren dispozita, në lidhje me krijimin, funksionimin dhe modifikimin e këtij mekanizmi, për konsultim të plotë me organizatat përfaqësuese të punëdhënësve dhe punëmarrësve në fjalë ose, kur nuk ekzistojnë organizata të tilla, me përfaqësues të punëdhënësve dhe punëmarrësve në fjalë; dhe (iii) kudo që është e përshtatshme për natyrën e mekanizmit për përcaktimin e pagave minimale, të nxirren gjithashtu dispozita për pjesëmarrjen e drejtpërdrejtë në funksionimin e tij të (a) përfaqësuesve të organizatave të punëdhënësve dhe punëmarrësve në fjalë ose, kur nuk ekzistojnë organizata të tilla, të përfaqësuesve e punëdhënësve dhe punëmarrësve të interesuar, mbi bazën e barazisë; dhe (b) personave kompetent për përfaqësimin e interesave të përgjithshme të vendit dhe të caktuar pas konsultimit të plotë me organizatat përfaqësuese të punëdhënësve dhe punëmarrësve në fjalë, kur ekzistojnë organizata të tilla dhe konsultimi i tillë është në përputhje me ligjin ose praktikën e vendit.
214. Gjykata vëren që bazuar në dispozitat e lartcekura të Konventës për Caktimin e Pagës Minimale, theksi është në konsultimin e plotë të organizatave që përfaqësojnë punëmarrësit dhe të punësuarit dhe sigurisht, arritjen e një konsensusi të plotë në përcaktimin e nivelit të pagës minimale, si një ndër mekanizmat që siguron drejtësinë sociale.
215. Bazuar në parimet e lartcekura, Gjykata vëren se, Ligji i punës deri më tash përcaktonte që Qeveria do të caktojë në fund të çdo viti kalendarik pagën minimale sipas propozimit të Këshillit Ekonomiko-Social. Ndërkaq, Ligji i kontestuar e ndryshon formulimin e tillë dhe i jep mundësinë Ministrisë së Financave që në mungesë të një propozimi të Këshillit Ekonomiko-Social për pagën minimale, të parashtrojë një propozim për Qeverinë. Me fjalë të tjera, Ligji i kontestuar njësoj si më herët parasheh që Qeveria e Kosovës përcakton pagën minimale sipas propozimit të Këshillit Ekonomiko-Social, mirëpo e lejon mundësinë që në rastet kur Këshilli Ekonomiko-Social nuk jep propozim, atëherë një gjë të tillë mund ta bëjë Ministria e Financave. Në këtë kontekst, Gjykata thekson që përderisa neni 6 i Ligjit të kontestuar, e shmangë kushtëzimin e propozimit të Këshillit Ekonomiko-Social, për përcaktimin e pagës minimale, i njëjti jo detyrimisht e afekton detyrimin e konsultimit të plotë, me organizatat që përfaqësojnë punëmarrësit dhe të punësuarit në kuadër të Këshillit Ekonomiko-Social, sepse ky i fundit gjithnjë ka rolin primarë në vendosjen përkitazi me propozimin e përcaktimit të pagës minimale në Republikën e Kosovës, dhe vetëm në rast të dështimit të arritjes së këtij konsensusi, kompetenca vendimmarrëse brenda një viti kalendarik, kalon në Qeverinë e Republikës së Kosovës. Për më tepër, Gjykata vëren se Ligji i kontestuar nuk i ndryshon kriteret të cilat duhet të merren parasysh gjatë caktimit të pagës minimale, siç përcaktohet nga Ligji i punës dhe standardet e Konventës së ONP-së.
216. Në rrethana të tilla, dhe duke marrë parasysh, që (i) Kushtetuta delegon çështjet që ndërliken me sigurimin social në nivel ligji; (ii) Konventa për Caktimin e Pagës Minimale nuk është e ratifikuar nga Republika e Kosovës; dhe (iii) që neni 6 i Ligjit të kontestuar, afekton kompetencën e Këshillit Ekonomiko-Social për propozimin e pagës minimale, vetëm në rast të dështimit të vendimmarrjes së tij brenda një viti kalendarik, dhe nuk e shmangë detyrimin e autoriteteve për t'u konsultuar me të gjithë aktorët relevantë, e as nuk e përjashton mundësinë e marrëveshjes së plotë ndërmjet anëtarëve të Këshillit Ekonomiko-Social për caktimin e pagës minimale, Gjykata vlerëson që neni i lartcekur nuk rezulton të cenojë dispozitat e Kushtetutës.

217. Për pasojë, Gjykata konstaton se neni 6 i Ligjit të kontestuar nuk është në kundërshtim me nenin 51 [Mbrojtja Shëndetësore dhe Sociale] të Kushtetutës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me paragrafin (5) të nenit 113 dhe paragrafin 2 të nenit 116 të Kushtetutës, nenet 20, 27 dhe 42 të Ligjit dhe në bazë të rregullave 48 (1) (a) dhe 72 të Rregullores së punës, më 19 qershor 2024:

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË, njëzëri, kërkesën të pranueshme;
- II. TË KONSTATOJË, njëzëri, që neni 2 (Ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit Nr. 04/L-261 për Veteranët e Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 05/L-141) i Ligjit nr. 08/L-142 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjeve që Përcaktojnë Shumën e Beneficionit në Lartësi të Pagës Minimale dhe Shkallët Tatimore në të Ardhurat Personale Vjetore, nuk është në kundërshtim me nenin 24 [Barazia para Ligjit] dhe nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës në lidhje me nenin 1 (Mbrojtja e pronës) të Protokollit nr. 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut;
- III. TË KONSTATOJË, me tetë (8) vota për dhe një (1) kundër, që neni 3 (Ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit Nr. 04/L - 092 për Personat e Verbër) i Ligjit nr. 08/L-142 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjeve që Përcaktojnë Shumën e Beneficionit në Lartësi të Pagës Minimale dhe Shkallët Tatimore në të Ardhurat Personale Vjetore, nuk është në kundërshtim me nenin 24 [Barazia para Ligjit] dhe nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës në lidhje me nenin 1 (Mbrojtja e pronës) të Protokollit nr. 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut;
- IV. TË KONSTATOJË, njëzëri, që neni 4 (Ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit Nr. 05/L - 067 për Statusin dhe të Drejtat e Personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik) i Ligjit nr. 08/L-142 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjeve që Përcaktojnë Shumën e Beneficionit në Lartësi të Pagës Minimale dhe Shkallët Tatimore në të Ardhurat Personale Vjetore, nuk është në kundërshtim me nenin 24 [Barazia para Ligjit] dhe nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës në lidhje me nenin 1 (Mbrojtja e pronës) të Protokollit nr. 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut;
- V. TË KONSTATOJË, me tetë (8) vota për dhe një (1) kundër, që neni 6 (Ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit nr. 03/L-212 të Punës) i Ligjit nr. 08/L-142 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjeve që Përcaktojnë Shumën e Beneficionit në Lartësi të Pagës Minimale dhe Shkallët Tatimore në të Ardhurat Personale Vjetore, nuk është në kundërshtim me nenin 51 [Mbrojtja Shëndetësore dhe Sociale] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës;

- VI. TË SHPALLË, që në bazë të nenit 43 (Afati) të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Ligji nr. 08/L-142 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjeve që Përcaktojnë Shumën e Beneficionit në Lartësi të Pagës Minimale dhe Shkallët Tatimore në të Ardhurat Personale Vjetore, i dërgohet Presidentes së Republikës së Kosovës për shpallje;
- VII. T'UA KUMTOJË këtë Aktgjykim palëve;
- VIII. TË PUBLIKOJË këtë Aktgjykim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me paragrafin 4 të nenit 20 të Ligjit.

Gjyqtarja raportuese

Remzije Istrefi-Peci



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Gresa Caka-Nimani